BEGZAT RRAHMANI

DITARI I NJË TË HUMBURI

K Ë R Ç O V Ë
2008

Biblioteka: JEHONA

Redaktor: Mr.Ilmi VELIU

Recensentë: Numan LIMANI
Salajdin QAZIMI

Lektor: Gëzime BAFTIRI

Ballina: Kujtim ZENDELI

Shtypshkronja: "Grafomak" - Kërçovë

29. 06. 1964
Zhubrinë

Kjo s'është në rregull. Prej klasës ku mësoja konkurruam shtatë nxënës krejt me nota të shkëlqyera,kurse në listën e atyre që e kemi dhënë provimin kalues ndodhem vetëm unë. Nuk besoj se shokët e mi si kanë ditur detyrat nga lënda e matematikës,por dyshoj edhe te ato të maqedonishtes. Nëse si kanë ditur shokët e mi të klasës,ku janë ata të Zajazit,Garanës,Tuhinit apo të Jagollit?! Unë vet e di se disa prej shokëve të klasës kanë qenë ndoshta më të mirë se unë,por edhe prej shkollave të tjera,nëse nuk ka pasur më të mirë kanë qenë të rangut tim. Ndoshta profesorët maqedonë duan me një lule të shijohet aroma e "VËLLAZËRIM-BASHKIMIT" në këtë Jugosllavi Titoiste.

Unë do të jem rehat gjatë pushimeve të verës dhe do të pres shtatorin,por brenga e shokëve të mi edhe mua do të më mundojë sa herë që të më kujtohet lista e varur në korridorin e gjimnazit të qytetit. Do të më dhimbsen shokët se gjatë pushimeve do të duhej të bëjnë dy punë;ato të fushës dhe të përgatiten për provimin pranues për njërën nga shkollat e mesme të republikës apo edhe të ndonjë republike tjetër...

10 .09.1964
Zhubrinë

Tash jam edhe më i humbur se ditën e provimit pranues. Në klasë s'kam asnjë shok të tetëvjeçares ku kam

mësuar,por as të tetëvjeçareve të tjera. Në klasë jam unë i vetmi shqiptar. Ndihem si dhia ndër dhen. Kujdestare të klasës kemi profesoreshën e gjeografisë,një grua të një eprori ushtarak dhe janë nga dy kombe të ndryshëm,kurse kujt feje i takojnë dinë ata vetë. Në pamje dhe në veshje është shik dhe shumë e bukur,elegante por në sjellje dhe shpirt shumë e shëmtuar dhe katile dhe krejt atë shëmti dhe katilëllëk e tregon vetëm ndaj meje,se me të tjerët sillet shumë mirë. Unë nuk mërzitem shumë,as që ia vë veshin,pasi shumë shpejt do të humbëm edhe unë si shokët e mi. Si prej kësaj shkolle ashtu edhe prej këtij vendi të nëmur. Edhe atje do të jetë gjuha e huaj bile edhe më huaj,më e egër dhe më e zezë se kjo e profesoreshës së gjeografisë,por kjo dhe të tjerët s'do të munden të kënaqen me vuajtjet dhe maltretimet e mija...

15.09.1964
Zhubrinë

Shiu kishte rënë tërë natës dhe akoma vazhdonte të bie me atë intensitet. Unë u nisa me kohë dhe udhëtoja si përditë,por në çdo dhjetë minuta shikoja se i humbsha disa hapa të rrugës. Në dy kilometrat e fundit edhe pse i rraskapitur fillova edhe të turrem,por u vonova afër tre minuta,kur më isha te shkallët e shkollës së mesme të qytetit. Disa hapa përpara meje profesori i fizikës e kapi bravën e derës dhe ma mbylli derën me një sjellje të pa hijshme. Unë si u mendova pak mora guxim që të trokitja në derë dhe të hyja në klasë,ashtu siç kishin bërë dhe shumë shokë të klasës,por ata ishin ata që ishin dhe kishin tjera privilegje. Profesori ishte ulur në karrigen e vet dhe shënonte orën e mësimit. Ai aspak se ngriti kokën dhe unë qëndroja në afërsi të derës duke pritur të sharat,por i përgatitur,që të ulesha në vendin tim,apo të dilja

përjashta. Ai studenti i përjetshëm i fizikës dikur e ngriti kokën dhe me një ton çnjerëzor bërtiti:

-A u kam thënë se pas meje të mos hapej dera?! Unë si fshiva pikat e ujit,që s'di a ishin djersët,apo pika shiu,por e di se më rrokulliseshin nëpër ballë dhe faqe, si mora frymë thellë e kapa bravën,por nuk e hapa derën dhe s'di si shtanga duke shikuar shokët e klasës,por jo të kërkoj ndihmën e tyre,dorën në zemër mu dhimbsën kur i pashë se edhe ata më shikonin po me të njëjtën dhembje dhe habi për një të pa mundur. Afër dy minuta mbretëroi një qetësi,derisa profesori mu afrua më kapi për koke dhe më tha :

-Ty të flas,dhe në atë moment e hoqi dorën që më i ishte lagur nga djersët e mija. Dhe prapë më bërtiti,por tash edhe më fort:

-Ty të flas,dhe prej dorës tjetër e mori shkumësin dhe më hoqi dy vija kryqi në ballë. Duke i shikuar shokët e klasës tha:

-Avullon si ndonjë kalë i lodhur së tepërmi. Atëherë unë i thash:

-Kam ngarendur,që të arrij në kohë,por ja u vonova pak. Atëherë trokiti dera dhe hynë edhe dy shokë klase,por atyre nuk u tha asnjë fjalë. Mua më pyeti prej kujt katundi vija?! Unë tregova se për çdo ditë udhëtoj nga dhjetë kilometra nga fshati Zhubrinë. Atëherë si me habi dhe ironi tha:

-Ti qenke ai shqiptari vetëm,që dëshiron të shkollohesh, më vjen keq se qenke lodhur shumë dhe prapë qeshi me ironi duke u dhënë shenjë dy të tjerëve që të shkonin në vendet e tyre,pastaj edhe mua,por më porositi që kurrë më të mos vonohem. Unë e nxora shaminë e xhepit që të fshija djersët dhe u ula në vendin tim.

Pasi shpjegoi mësimin mu afrua dhe më pyeti a e kisha kuptuar. Unë i thash se formulat i mbaja në mend, por fjalët jo,por do ta lexoja disa herë në shtëpi dhe krejt do të jetë

në rregull dhe më pyeti ashtu si në kuis disa pyetje për mësimin e parafundit. Unë iu përgjigja,atëherë profesori i fizikës u tha nxënësve maqedon:

-Këto janë të aftë se janë nga vendlindja e Joakim Kërçoskit. Unë nuk di si dhe pse reagova aq shpejt duke i thënë:

-Më mirë ti thoni Joakim Kërçova. Profesori u nxeh por në atë moment ra zilja dhe në klasë filloi të bëhej zhurmë. Shoku i bankës më tha:

-Mos i kthe fjalë profesorit,fizika është lëndë e rëndë ti edhe gjuhën se dinë mirë. Unë i thash:

- Gjuha mësohet,por edhe fizika,kurse profesori duhej të jetë për të gjithë i njëjtë,a vërejtët se maqedonasve s'u tha asnjë fjalë! Ai doli përjashta kurse unë vendova kokën në mes të dy duarve dhe pritja orën e dytë të asaj dite.

Orën e tretë kishim matematik dhe prej sjelljes së profesorit u binda se kishin biseduar me profesorin e fizikës,por sjellja e këtij ishte pak më ndryshe dhe ngeli mjaft i kënaqur prej përgjigjes sime duke e zhvilluar detyrën e dhënë në dërrasë të zezë.

* * *

Në ora pesëmbëdhjetë isha në shtëpi dhe nëna ma dha letrën të cilën ia kishte dhënë postieri dhe ishte nga babai i cili punonte prej vitesh në Hekuranën e Smederevës të Serbisë.

Babai më shkruante se më kishin pranuar në gjimnazin e Smedervës dhe se duhej të merrja fletëçregjistrim dhe sa më parë të nisesha për në qytetin ku babai kishte kaluar një pjesë të mirë të jetës së vet.

* * *

Të nesërmen orën e parë kisha me kujdestaren e klasë. Ajo si përherë e zhvilloi mësimin dhe i ngeli aq kohë sa për të bërë një përsëritje të shkurtër. Unë pak përpara se të binte zilja ngrita dorë dhe i thash:

-Profesoreshë a do të mundeni të më jepni fletëçregjistrimi dhe dokumentet tjera?! Ajo u habit prej kërkesës sime. Më shikoi me habi,po ashtu më shikuan edhe shokët. Ajo me atë stilin e vet me inat më pyeti:

-Ku do të shkosh;në Shkup,Prishtinë,apo në Shqipëri?! Unë ashtu i qetë i thash:

-Askund prej këtyre që ju përmendët,do të isha i lumtur që të shkoja në njërin nga këto qytete por,për fat të keq do të shkoj në Smederevë atje ku baba im punon qysh si i ri. Është tha e drejtë e jote,por nuk do të bësh mirë. Unë thash se duhej të veproj sipas dëshirës së babait. Kur doli për dere më tha që edhe unë të shkoja pas saj te drejtori dhe sekretari i shkollës.

Edhe ata nuk u sollën mirë. Më bënin do pyetje idiotësie. Unë nuk reagoja,kurse ata edhe më shumë revoltoheshin...

* * *

Ditën e shtunë në ora njëmbëdhjetë nëna dhe motra më përcollën deri te stacioni i trenit që ishte vetëm disa metra larg oborrit të shkollës ku pak muaj më parë kisha mbaruar tetëvjeçaren.

Pas disa minutash që kishim arritur ne treni dha shenjë se vinte me shpejtësi të breshkës,kurse unë isha afruar te dritarja e klasës dhe vëreja bankat,karriget dhe dërrasën e zezë që disa herë e kisha mbushur me germa dhe numra, vështirësitë e jetës për moshën time,po ashtu më shkuan sytë te banka dhe karrigia ku një vit më parë kishte qenë ulur

vajza,që pa mbaruar viti shkollor së bashku me tërë familjen e saj mori rrugën e pa kthimit të Anadollit.

Unë udhëtoja me zhurmën shurdhuese të trenit,kurse nëna dhe motra me lotët që u rrokulliseshin faqeve teposhtë,si rrugica gjarpëruese nëpër fushën e gjerë të Sërbicës,që unë e kisha ecur plot katër vjet me radhë nëpër acar e borë,por edhe nëpër zhegun e verës plotë përcëllimë,dhe prej atij shtatori ia lash si amanet për katër vjet me radhë ti shkeli motrës sime të dashur.

Klasa e trenit të vogël ishte e mbushur përgjysmë me udhëtar,por në çdo stacion më shumë hipnin se sa zbritnin prej trenit. Unë si i ri s'njihja asnjë prej udhëtarëve,prandaj edhe lexoja mësimin e fundit nga lënda e historisë,por prej çante kisha të nxjerr edhe librin e latinishtes. Personi që ishte përballë meje ishte një njeri zotëri i veshur shumë bukur bile kishte edhe kollare dikur pa dashtë vërejta se më shikonte herë pas here ashtu tinëzisht. Si kaluan disa orë udhëtimi ai maqedonisht më tha:

-Në fillim kur hipët mendova se jeni një kurbetçi i ri,por tash u binda se jeni nxënës,por edhe shumë fjalë të tjera ofenduese. Unë ashtu i qetë i thash:

-Mirë paskeni menduar,por ndoshta shumë herë u gënjejnë mendimet. Ju më duket se akoma shkoni me ato parullat e ABETARES së dikurshme:"Hasani do të lëvrojë tokën,kurse Zorani do të punojë nëpër fabrika apo zyra". Më duket se ju nuk dini,apo ashtu bëheni sikur nuk dini se në punë të rënda pranohen të punojnë ata që i kanë lëshuar brisk fytyrës. Si do qoftë unë shkoj rrugës sime pas dijenisë. Bashkudhëtari kërrusi kokën,kurse unë vazhdova me leximin.

* * *

Në Gostivar arritëm pas tetë orë udhëtime edhe meqenëse nuk i ka më shumë se tridhjetë e pesë kilometra. Aty duhej të prisja afër një orë dhe të hip te treni që do të më çonte deri te stacioni i parafundit,ku do të më priste babai me fytyrë të buzëqeshur,kurs nënës dhe motrës akoma do tu rrokullisen lotët nëpër faqe...

22. 09. 1964
Shkup-Beograd

Fiks në ora njëzetetre u futa në kupenë e trenit të madh dhe u ula në vendin e rezervuar disa orë më parë. Pas meje hyri edhe një njeri në moshë më përshëndeti dhe u ul në vendin e vet. Pak përpara se nisej treni më tregoi se udhëtonte,për në Beograd,por prej aty do të vazhdonte për në Kroaci. Po ashtu më tregoi se ishte prej një fshati të rrethit të Gostivarit.

Si kaluam disa orë udhëtimi kuptova se në Kroaci kishte gati tërë familjen,që prej disa vitesh kishin hapur disa ëmbëltore. Po ashtu plaku si ish partizan ishte shumë i revoltuar në shokun Tito,që përveç disa dekoratave s'kishte asnjë gradë,por as një vend pune,kurse shokët e luftës maqedon,serb,malazez,kroat,slloven,ndoshta edhe rumun dhe shumë të tjerë kishin arritur grada deri në gjeneralë. Po ashtu më tregoi se disa herë kishte pasur takim me Titon dhe se ai i kishte premtuar shumë,por deri në atë moment s' kishte realizuar asnjë premtim bile edhe atë pak pension ushtarak,që e kishte marrë disa vite përpara atij viti ia kishin ndërprerë organet. Unë si fëmijë si kuptoja shumë fjalë që plaku i thoshte dhe dorën në zemër,deri në atë moment unë s'kisha dëgjuar që ndonjë njeri të foli aq keq për Jugosllavinë e veçanërisht për shokun Tito.

23.09.1964
Beograd

Dy personat që hipën së bashku me ne në Shkup zbritën në Nish dhe në kupe ngelëm unë dhe plaku dhe si u nis treni prej Nishi ne u shtrimë si kush në anën e vet dhe bëmë një sy gjumë.

Aty nga ora shtatë e mëngjesit arritëm në Beograd. Kur u përshëndetëm,plaku më tha:

-Djalë përherë të ngarendsh për dijeni,por kur pas politikës. Do të shkollohesh në gjuhën serbe dhe do të kesh shumë shokë serb,por unë ta lejë me amanet që atyre kurrë të mos u besosh...???!!! Plakut iu falënderova për shoqërinë gjatë udhëtimit,por edhe për këshillat dhe u drejtova në drejtim të stacionit të autobusëve.

Pak përpara se të preja biletën për në Smederevë takova Xheladin Tafallarin një bashkëfshatar timin që prej kohësh punonte në Beograd. Si u përshëndetëm dhe kuptoi ardhjen time në Beograd u afrua te sporteli dhe preu biletën për në ora katërmbëdhjetë edhe atë pa lejen time dhe me paratë e veta. Si doli prej rendit e mori valixhen dhe më tha që të shkoja pas tij. Nuk ecëm as pesëdhjetë metra hyri në një byrektore të një shqiptari të rrethit të Tetovës,sa u ulëm bëri porosinë dhe filloi të pyes për familjen,por edhe tërë fshatarët që si kishte parë afër gjysmë viti.

Valixhen e lamë te byrektorja dhe u ngjitëm një rruge përpjetë dhe pastaj hipëm në tramvajin,që për mua ishte hera e parë të hip dhe shikoj tramvaj. Si udhëtuam disa minuta zbritëm dhe u lëshuam një rrugice teposhtë të shtruar me kalldrëm,ku aty afër ndodhej një barakë me disa dhoma të mëdha punëtorësh. Në njërën prej tyre banonte Xheladin

Tafallari së bashku me disa bashkëfshatar të mi,kurse në dhomën tjetër që ishte e ngjitur me të banonte edhe xhaka Çil djali i xha Bitit,që një kohë të gjatë ka punuar në të njëjtën organizatë pune"KOMGRAP".

Aty hëngra edhe drekën në mensën e punëtorëve së bashku me bashkëfshatarët e mi,por edhe shumë kërçovarë të tjerë. Ato më njoftuan me jetën dhe punën e tyre në kryeqendrën e Jugosllavisë.

Fiks në ora trembëdhjetë u nisëm në drejtim të stacionit të autobusëve,por tash jo veç unë dhe Xheladini,por të tërë bashkëfshatarët e mi dhe disa kërçovarë të tjerë. Pak përpara se të hipja në autobus u përshëndeta me të gjithë,por ata më premtuan se shpesh do të shiheshim në Smederevë ndonjë të diele,kur ata s'do të punojnë.

Unë vazhdova në drejtim të Smederevës,për tu arsimuar,kurse bashkëvendësit e mi u kthyen në banesën kolektive,që të pushonin për ditën e nesërme që i priste puna më rëndë në kryeqendrën e Jugosllavisë titiste. Gjatë ati udhëtimi disa herë mu kujtuan fjalët e plakut të zhgënjyer nga Titoja dhe regjimi i tij komunist,veçanërisht bashkëpunëtorit të tij si dorë e djathtë SATRAPIT Rankoviq që i kishte bërë dhe i bënte dëme të mëdha kombit tim...

24.09.1964
Smederevë

Pas një ore udhëtimi arrita në qytetin e babës ku vite me radhë kishte punuar dhe punonte në Fonderinë e Hekuranës,prej ku siguronte kafshatën e gojës si për vete ashtu edhe për tërë familjen,por edhe për shkollimin tonë. Prej së largu i pash oxhakët e Hekuranës,që villnin pa ndal shtëllunga tymi vdekjeprurës.

Kur zbrita prej autobusit në kokë dhe trup ndjeva një lodhje dhe marramendje,që kurrë në jetën time se kisha ndier,por as atë shtrëngim kraharori. Aq më shumë u keqësova prej asaj tollovie njerëzish,që s'njoha asnjërin dhe ndihesha si dhia ndër dhen apo më mirë të them si i "HUMBURI NDËR TË HUMBUR".

Duke pyetur arrita te rruga dhe pastaj duke i ndjekur numrat me radhë arrita deri te ai numër dhe ajo shtëpi që do të banoja disa vite me radhë. Prej rrugës kryesore duhej të kaloj nëpërmes dy shtëpive të bukura dhe pas tyre duhej të ecja edhe nja njëqind hapa për të arritur te shtëpia përdhese me një dhomë,përafërsisht katër metra me katër,e mbuluar pak me llamarinë e tjetra pjesë e çatisë me tjegulla më shumë të thyera se sa të tëra.

Brenda kishte dy krevat të hekurt nga koha e kralit,në mes një koftor llamarine dhe në njërin skaj një grumbull hime sharre,për ndezje të koftorit,verës për të zier,kurse dimrit për të zier dhe për tu ngrohur,pasi në këtë shtëpi akoma s'kishte arritur rryma elektrike. Në tjetrën anë të dhomës ndodhej një tavolinë e punuar nga dora e babait dhe një karrige ku mundeshin të ulen dy veta. Mbi tavolinë në mur ishte varur llamba e vajgurit,që një pjesë ishte mirë e tymosur,që mua më kujtoi kohën e Naimit apo të Migjenit shëndetlig.

Baba arriti aty nga ora gjashtëmbdhjetë, kishte punuar në turnin e natës dhe kishte vazhduar edhe në turnin e parë,dhe ishte shumë i gëzuar se do të merrte atë muaj afër dy rroga. Të nesërmen do të shkonte në turnin e parë,por do të vazhdonte edhe turnin e dytë se në fonderi për çdo pesë muaj bëjnë do riparime.

Kur më pa përpara derës të ulur te karrigia dërrasë,ai shpejtonte të afrohej sa më parë te unë,kurse unë u ngrita dhe u turra në drejtim të tij. U përqafuam dhe ashtu ndenjëm një kohë,si prindi me fëmijën e dëgjova kur më tha:

-Arrite bir i babës. Po i thash babë,por ai më s'mundi të foli nëpër faqe i rrokulliseshin plot lot gëzimi. Kur hymë në dhomë pak ishte pastruar nga era e lagështisë dhe erës së himes nga çami i bardhë apo pishës së zezë,kurse mua më shkuan sytë te lagështia e murit që arrinte largësinë afër përgjysmë. Babai e ndezi koftorin dhe ngrohi groshën që e kishte zier një ditë më parë,preu ca copa buke dhe mi vendoi përpara duke më thënë:

-Ha biri babës. Unë fillova të haj me një oreks të pa parë,por vapa që u bë nga koftori disi ma ndalte në fyt kafshatën e bukës. Ne më kur ishim nga fundi i ngrënies në derë trokitën dy persona që unë nuk i njihja. Baba ua çeli derën,i përshëndeti dhe u tha se ja më në fund erdhi djali. Ata u afruan unë u çova nga karrigia dhe i përshëndeta. Baba i ngriti pjatat kurse unë e pastrova tavolinën.

Ato bisedonin për punën që bënin në fonderi dhe për të hollat që do të merrnin atë muaj,kurse unë fillova të lexoj një temë nga fizika,por ajo nuk zgjati shumë,pasi në dhomë filloi të bie terri. Baba e ndezi llambën,por ajo dritë s'mjaftonte për ti parë germat dhe formulat e fizikës. Pa dashtë mendja më vajti te amaneti i plakut,duke menduar se qyteti që unë duhej të merrja diturinë ndodhej disa kilometra afër banimit të shokut Tito dhe babai im akoma s'paska rrymë elektrike në dhomën e banimit,kurse sa e sa herë vet Titoja ka folur për të drejtat dhe kushtet e punëtorit.

Tërë natën s'fjeta nga kundërmimi i erërave,por edhe për ditën e parë në shoqërinë e re të gjimnazit,në atë vend të pa njohur për mua dhe...

25.09.1964
Smederevë

Baba në ora pesë e kishte zier qumështin dhe hante ca kafshore buke,që të ketë fuqi për punën e ditës edhe atë më të rëndën në fonderinë e Smederevës. Pak para se të shkonte në punë shumë me kujdes më porositi,që fiks në ora shtatë fillon mësimi,kurse unë duhej të isha pak më përpara te zyra e sekretarit të shkollës. Por më tregoi se edhe qumështin e kisha gati. Unë edhe ashtu nuk kisha fjetur tërë natës,pak prej asaj që e kisha ndërruar vendin e fjetjes,pak prej kushteve,por ndoshta më tepër për dëshirën që kisha të arsimohesha,dhe të mos bëja punët më të rënda të shtetit siç i bënin njerëzit e kombit tim. Dhe tërë natës mendoja për duart e plasaritura të babait,por edhe të atyre dy burrave që erdhën kur ne hanim drekën,që për mua ishte ushqimi i parë në atë vend të mallkuar për punëtorët e kombit t' im. Po ashtu tërë natës përpara më dilte fytyra e buzëqeshur e babait,që pas sa kohësh në afërsi të vet kishte njërin fëmijë nga pjella e vet.

Shtatë pa dhjetë minuta isha përpara zyrës së sekretarit të shkollës. Korridori i gjatë që ndodhej përpara zyrës vlonte nga nxënësit dhe arsimtarëve që vinin me të ngut dhe futeshin nëpër klasa dhe zyrën e arsimtarëve. Pak përpara orës shtatë erdhi një njeri jo shumë në moshë i veshur mirë,me çantë në dorë dhe me një fytyrë të mbyllur. Mua mi hodhi sytë dhe e nxori çelësin prej xhepit të palltos e vendoi në bravë duke mos hequr shikimin nga unë e hapi derën hyri brenda dhe e mbylli si i revoltuar. Unë prita afër pesë minuta dhe trokita në derë,nuk e dëgjova tha ose jo hynë,por unë e çela derën dhe hyra ai as që e ngriti kokën,se diçka shkarraviste. Dikur e çoi kokën dhe më tha urdhëro. Mua siç më kishte porositur

babai,i thash se unë jam nga Maqedonia dhe dua që ti vazhdoj mësimet në shkollën tuaj. Ai me një buzëqeshje ironike më tha:

-Ti qenke ai zogu nga larg,për të marr dijen tonë. U ngrit dhe më dha shenjë që të shkoja pas tij. Hymë në klasën e katërt që ishte nga zyra e sekretarit. I tha diçka profesoreshës,por unë se kuptova. Kur arriti te dera unë ia dhashë dokumentet që i kisha në dorë ai mi rrëmbeu dhe doli për dere. Profesoresha ishte një grua në moshë u çua në këmbë u afrua te unë më dha dorë dhe më tha:

-Mirë se erdhe në shkollën tonë unë jam profesoreshë e matematikës dhe kujdestare e kësaj klase,por prej sot edhe e jotja. Dhe u kthye nga nxënësit dhe u tregoi se prej asaj dite në mesin e tyre do të jem edhe unë një shqiptar nxënës nga Maqedonia. Më tha të ulesha në bankën e parë ku ishte vetëm një djalë.

Orën e dytë kishim gjuhë serbe,që e ligjëronte një burrë mesatar me moshë,por i deformuar në trup dhe fytyrë dhe shikimi i tij të tmerronte,jo vetëm mua por edhe të tjerët. Profesori sa hyri na shikoi me atë pamjen e tij tmerruese dhe u ul në vendin e vet dhe filloi të regjistronte orën. Unë pasi isha te banka e parë shikoja se si shkruante dhe si i dridhej dora,mua mu dhimbs,për moshën e vet nuk duhej të ishte në atë derexhe. Dikur e çoi kokën dhe më shikoi ndoshta jo me qëllim,por unë isha te banka e parë dhe e kisha përballë. Ai sikur u habit se deri në atë moment s' më kishte parë ishte ora e parë me te. Më pyeti:

-Nxënës i ri?! Po i thash,por dikush prej pas tha:

-Është nga Maqedonia,shqiptar. Profesori tha:

-Nuk ka shqiptar në Jugosllavi e as në Maqedoni,por ka Shiptarë.

Në klasë reaguan të dy nxënësit që me prindërit e tyre kishin jetuar gjatë kohë në Kosovë dhe e dinin shumë mirë gjuhën shqipe. Njëri u çua në këmbë dhe filloi ti sqarojë

profesorit se duhej ta shqiptonte edhe germën “Q”ose të thoshte” ALBANCI”. Profesori duke qeshur me ironi tha:

-Unë më mirë se ju e dijë historinë e tyre,unë s’ thash asnjë fjalë duke e shikuar atë fytyrë të mallkuar nga vet Zoti,duke u penduar për atë që ndjeva në shpirt e zemër pak më parë kur regjistronte orën në ditar dhe u habita për sqarimin e shokëve të klasës.

* * *

Shoku i bankës më pranoi shumë mirë dhe shumë herë mundohej të më sqaronte nga mësimet dhe më thoshte që të mos mërzitem nga sjellja e profesorëve apo të shokëve të klasës. Po ashtu edhe Peroviqi dhe Mandiqi që e dinin gjuhën shqipe më thoshin që të mos mërzitem,por ata të dy disi e urrenin shokun e bankës,ku më vonë u binda se ai ishte shumë i aftë dhe se ishte djalë i Sekretarit të Komitetit Qendror të qytetit.

20.10.1964
Smederevë

Pas dy treshave në matematik dhe gjuhë frënge në ditar te emri im u shënua edhe nota e dobët njësh edhe atë në gjuhën serbokroate. Unë ndoshta nuk meritoja më shumë se njësh dhe nuk do të mërzitesha sikur profesori të shkruante në ditar edhe njëshat tjerë të ushtrimit me shkrim,por ato njësha të nxënësve serb i la ashtu duke u thënë që të mundoheshin në hartim ti përmirësonin. Kurse mua si ma shkroi njëshin më tha:

-Përmbajtja ishte e mirë dhe kishte kuptim se unë kuptoj edhe maqedonisht edhe gjuhën tënde,por këtu i thonë Serbi,i thash se do të mundohem edhe unë kur do të bëjmë hartim dhe dita ditës e përvetësojë gjuhën serbe. Profesori nuk e la me aq,por më tha:

-Ju Shiptarët,jo Shqiptarët (që të më fyej sa më shumë) tha jeni DEBILA,atëherë unë i habitur dhe i befasuar i thash:

-Profesor nëse jam unë debil,por edhe dikush nga serbët,mundet të jetë,por nuk do të thotë se janë të krejt shqiptarët dhe serbët. Atëherë ti tha mendon se edhe unë jam debil,unë heshta,por profesori më tha të dilja përjashta më shkroi mungesë por edhe vërejtje me shkrim në ditar. Disa shokë të klasës,por edhe ai bankës dhe Mandiqi me Peroviqin reaguan,por unë nuk e zgjata më shumë dola prej klasës. U mbështeta për murit te dritarja përball derës dhe rrija duke u menduar për atë që ndodhi. Nuk shkuan as pesë minuta profesori doli prej klase më shikoi dhe u largua në drejtim të sallës së arsimtarëve. Shoku i bankës erdhi te unë më kapi për krahu dhe më tha që të hyja në klasë,por unë thash jo deri sa të mbarojë ora e gjuhës serbe. Në atë moment në drejtim të klasës vinte profesori së bashku me drejtorin,e pas tyre sekretari dhe kujdestarja e klasës. Kujdestarja më kapi për dore dhe më mori në klasë dhe më tha që të ulesha në vendin tim. Drejtori më pyeti çfarë kisha bërë. Unë u ktheva nga shokët dhe shoqet dhe i luta që ti nxirrnin mbi banka fletët e ushtrimit me shkrim dhe i thash drejtorit që të shikonte se vetëm mua më shkroi profesori notën e dobët në ditar. Ai mori ditarin dhe më tha; pastaj ç' ndodhi?! unë i thash se më fyeu mua dhe tërë kombin tim se jemi debila edhe meqenëse unë nuk e kuptoj mirë këtë fjalë dhe e thash atë fjalë që ua ka thënë profesori. Kryetarja e klasës Liljana Çoliqi u çua në këmbë dhe me një revoltë tha:

-Profesori shumë herë e ka ofenduar shokun e klasës por edhe neve,kurse sot ia qiti fundin. Ndoshta do të thoshte

edhe më shumë,por derën e hapi profesori i fizikës. Drejtori ia dhe regjistrin profesorit dhe u dha shenjë që të lironin klasën që ne të vazhdonim me orën e fizikës. Mua s'di si dhe pse më rridhnin ashtu lotët nëpër faqe,profesori i fizikës më shikoi dhe filloi të shënonte orën dhe pa mos e çuar kokën tha:

-Në këtë botë krejt është e mundur e veçanërisht në shtetin tonë. E kisha ndërmend të pyes,por shikoj se shumica prej jush s'jeni të disponuar,prandaj do të shpjegoj mësimin në vijim.

Pas disa ditësh edhe në fizikë dhe gjuhë latine mora nota pozitive. Profesori i edukatës fizike më thirri dhe më tha që atë ditë pas orëve të mësimit të paraqitesha te Kryesia e klubit futbollist të qytetit ku do të ishte edhe ai.

Unë bëja aq sa mundja,kurse profesori i gjuhës serbe bënte atë të vetën,por më të keqen e bënte lagështia e dhomës ku kaloja kohën më të gjatë,dhe shumë mirë i ndihmonte edhe ajri i pa pastër i hekranës ku baba punonte vite me radhë...

* * *

24.02.1965
Beograd

Edhe sonte si netët tjera ndodhemi në të njëjtin vend dhe prapë e morëm FIKS VAKSINËN. Zorani, Gilja siç i themi edhe sonte s'është me ne. Ai dy orë përpara nesh u nis për në Beograd dhe na tha se pas treningut në stadiumin e "CRVENA ZVEZDËS" do të vinte,që të kalonim mbrëmjen së bashku. Ndoshta ai më i ik takimit me ne,ashtu siç më tha profesori i fizkulturës dhe trajneri im se unë në kohën e fundit

s' jam i disiplinuar dhe ndoshta kam marrë edhe rrugë të gabuar. Mos vallë Gilja ka treguar diçka?! Si do qoftë unë duhet të konsultohem me Dr. Vërhovacin për shëndetin tim e veçanërisht me marrjen e këtyre vaksinave,por edhe në lidhje me lagështinë e banesës. Por nuk di a do të jem aq i fortë me ndërprerjen e tyre? Edhe shoku i bankës Iliçiqi e ka ndryshuar sjelljen,por edhe në mësime s'është siç ka qenë. Atë ditë kur te ai drekuam s' bashku me babanë e tij ai më pyeste për humbjen tonë,por unë i ikja përgjigjes. Unë nuk e di prej ku kishte dëgjuar ai se unë tri herë s'kam qenë në trening. Ndoshta për ne të futbollit bisedohet edhe në mbledhje partiake.

Unë edhe me shëndet nuk ndihem mirë,por edhe në shkollë disa nga shokët më thirrin me atë fjalën e profesorit të gjuhës serbe,por këto germën "P" e zëvendësojnë me germën "F" dhe shumë herë mërzitem dua ti grushtoj,por deri tani jam përmbajtur.

Dje gabova kur i refuzova shokët për të shkuar në fshatin Lozovik te shoku,që ditë më parë i vdiq e ëma,ata nuk reaguan keq e dinin se unë duhej të shkoj në trening,por unë nuk shkova as në trening,prandaj edhe mundet të më krahasojnë me sjelljen e keqe të disa profesorëve që shokun që më s'ka as nënë e as baba e thirrin; "Shitës qumështi".

* * *

Dr. Vërhovaci dukej se ka biseduar me babën dhe i paska thënë që të kujdeset për shoqërinë time,ashtu siç më tha edhe baba i Iliçiqit. Dhe prapë i kishte thënë që të bëja analizat e gjakut.

Në mbrëmje kërkova leje nga babai që të shkoja në ditëlindjen e një shoqeje të klasës e cila ishte vajza e profesorit të artit figurativ. Baba nuk më tha asnjë fjalë,por

pohoi me kokë dhe më dha ca para për të blerë ndonjë dhuratë. Unë njëherë s'desha ti merrja,por u përmbajta dhe nuk i tregova babës se kisha pare.

Kaluam shumë mirë edhe atë deri në momentin,kur mua diçka mu rrotullua në kokë dhe kisha rënë në dysheme. Profesori me ca shokë më kishte çuar në spital,por unë më isha në vetëdije dhe s'ishte diçka serioze.

Kur shkova në banesë babai kishte shkuar në turnin e tretë dhe ndoshta me dhjetëra herë e kishte lagur këmishën që të freskohej prej temperaturës së lartë ku shkrihej dhe derdhej nëpër kallëpe hekuri...

Mars 1965
Avallë

Prej para dy javësh shoku i klasës futbollisti Gile u transferua në Beograd,ku do të vazhdojë edhe shkollimin. Sonte e thirrëm në të njëjtin lokal ku merrnim së bashku FIKS VAKSINAT,por ai nuk erdhi. Me ne u veprua si disa herë më parë. Unë duke e parë atë vajzën me pendlën e palloit pas në prapanicë si rrotullohet,por edhe me të tjerët vallëzimet e pakontrolluar,në mend më rrotullohej se më nuk duhej ardhur në këtë vend,podrum të mallkuar.

Edhe shoqja ku disa herë kisha fjetur më rekomandon që të largohem nga ato fëmijë të komunistëve të ndytë.

S'di pse sonte tërë natën përpara më del ai mjeshtri plak me shokun e tij,që dikur në Kragujevc partizanët e Titos ia kanë vrarë djalin e pastaj kanë thënë dhe thonë se i kanë pushkatuar gjermanët. Atje në Maqedoni kur nuk dëgjonim fjalë kaq të këqija për Titon dhe njerëzit e tij,kurse këtu në

kryeqendër dhe në Smederevë vetëm disa kilometra larg banimit të Titos flitet me të madhe keq e më keq për të.

S'kam dashur të besoj për atë që dëgjoja,por fjalët e ati plakut për djalin e vrarë në gjimnazin e Kragujevcit s'mund ti hedhim si trillime. Ai prej atëherë është larguar prej ati qyteti dhe paska lënë edhe varrin e djalit vetëm të mos i shikojë vrasësit,që siç thotë i dinë me emër dhe mbiemër,por s'guxon të thotë asnjë fjalë.

Kur u zgjova ora ishte nëntë,duke hëngër mëngjesin shoqja më tregoi se ajo shoqja e saj kishte pyetur për mua;kush jam dhe nga vij. Ajo diçka dinte për mua e diçka jo,por unë i tregova pikë e për pe. Ajo qeshi duke më thënë:

-Ti qenke SHIFTAR. Po i thash dhe krenohem,që jam,ajo më tha se ka ditur prej ditës së parë kur jemi takuar. Si do që të jetë dhe të jemi ne duhet të largohemi nga kjo shoqëri tha dhe ma mbushi edhe njëherë gotën me qumësht. Më shikoi me kujdes dhe preras më tha:

-Unë sot nuk do të vij në Avallë. Unë i habitur e shikova u mendova pak dhe i thash:

-Por pse nuk thatë kur u ndamë me shokët,por tash më thoni mua. Atyre nuk u thash,por të them ty dhe kurrë më s'do të vij në atë podrum të mallkuar,por edhe njëherë të them ty që edhe ti më kurrën e kurrës të mos shkelësh në atë vend. Unë i habitur prej atyre fjalëve që dëgjova, thash:

-Unë sot do të shkoj në Avallë e për herë tjetër s'di.

* * *

Nga pirgu i lartë u lëshua shqiponja me krahët e saja korb të zeza,kurse nga goja i dilte një flakë e kuqe gjak. U ndal ca metra lart nga unë dhe më shikonte me habi. Shokët e shikonin,ashtu siç e shikoja edhe unë. Dikush tha:

-Shiftar kjo erdhi pas teje. Shqiponja në atë moment zbrazi barkun dhe përpara tyre ra një glasë bukur e madhe.

Shqiponja duke më shikuar u ra krahëve dhe vazhdoi rrugën në drejtim të jugut. Mua në vesh më erdhi një zë,që nuk e kuptova,por u largova në një skaj dhe në trup ndjeva një dridhje dhe shqetësim. E kapa kokën me dorë bërrylat i vendova mbi gjunjë dhe i mbylla sytë. Përpara më dilnin shumë fytyra,në mesin e tyre profesori i gjuhës serbe,por më së tepërmi fytyrat e njoma duke marrë FIKS VAKSINAT. S' mundja të qetësohem deri sa nuk e mbolla në letër shqetësimin dhe nuk u betova se më kurrë nuk do të shkel në atë vend të mallkuar. Atëherë shqiponja edhe njëherë erdhi në afërsi te unë bëri një rreth dhe u largua për të kryer obligimet e ditës.

FIKS – VAKSINA

S' mund të jem i lumtur
Në këtë gjimnaz pa emër
AVALLA çdo ditë mundohet
Të ma shkrij trurin
Fëmijët e pasur
Pinë cigare "XHOJINT"
-DISPONIMI-
Ca kanë edhe "QILLAMA"
Në podrumin e argëtimit
FIKS VAKSINAT
Përfitim me ofendime
Jeta bëhet çdo ditë
Më e zezë se terri
Zani i shpëtimit më vjen
Nga JUGU në gjuhën time.

1965-AVALLË
Beograd

Te stacioni i trenit kur babës i rridhnin rrëke lotësh Dr. Vrhovaci i tha:

-Do të ngelësh i vetmuar,por do të shpëtojmë një jetë të njomë. Pak përpara se të nisej treni profesori i gjeografisë më dhuroi librin "TOKA DHE NJERËZIT". Përqafimi lamtumirës i babës më zinte frymën,por s'kishte rrugë tjetër. Shokët dhe shoqet e klasës,por edhe shumë të tjerë shokë e shoqe dhe trajneri i klubit lëviznin duart për të më përshëndetur,kurse treni për çdo sekondë shtonte shpejtësinë në drejtim të jugut...

Fotografia e klasës së dytë të fotografuar në kala të Kërçovës.

Të fotografuar pas dyzet vitesh përpara gjimnazit të Kërçovës, por tash si:profesorë,mjekë,juristë,inxhinierë,ekonomistë dhe poetë.

* * *

Në vjeshtën e vitit në vijim,maqedonët kishin vendosur që në Kërçovë arsimimin e nxënësve shqiptarëve ta çrrënjosin njëherë e përgjithmonë. Por nuk kishin menduar se kur nuk do t'ia arrin atij qëllimi aq të pistë dhe çnjerëzor,por ishin të lumtur,se pas dy vitesh arritën ti mbyllin paralelet në gjuhën shqipe edhe pse vetëm tri lëndë ligjëroheshin shqip e të tjerat në gjuhën maqedone.

Ne nxënësit e vitit të tretë u drejtuam nëpër gjimnazet e Republikës. Unë me tre shokë dhe një shoqe u drejtuam në gjimnazin e Gostivarit dhe hallet tona profesorët shqiptar i kuptuan ashtu siç u ka hije pedagogëve. Por kjo nuk ndodhi me drejtorin maqedon të gjimnazit dhe organet e komunës. Qysh prej ditës së tretë lindën problemet dhe ne assesi të regjistrohemi në regjistrin e nxënësve. Vet drejtori disa herë na tha se për ne nuk ka vend në atë gjimnaz, dhe se do të duhej të kthehemi në Kërçovë,prapë në duart e xhelatëve maqedon,që kishin bërë kërdi,prej afër njëqind nxënësve në vitin e parë në vitin e dytë kishin kaluar vetëm shtatëmbëdhjetë dhe një unë tetëmbëdhjetë,kurse për në vitin e tretë kaluam vetën gjashtë nxënës, por ne vazhdonim të vijojmë mësimet,por të pa regjistruar,në ditar si shokët tjerë.

Ditën e premte prapë në klasë erdhi drejtori dhe na tha preras:

-Nëse ditën e hënë nuk sillni vërtetim se komuna e Kërçovës do të paguaj për ju harxhimet do të largoheni nga shkolla nëse duhej edhe me dhunë.

Unë ditën e hënë u drejtova në zyrën e referentit për arsim në Kërçovë. Si trokita hyra brenda e përshëndeta,por ai assesi ta çonte kokën,me siguri ai e dinte prezencën time në atë zyrë. Dikur më tha:

-Ç' doni???!!! Si ia sqarova hallin tim dhe tonin ai me një arrogancë të paparë më shau NËNËN SHQIPTARE,për ne së paska pare dhe sa më parë tha që të lëshoja zyrën.

Tërë natën s'fjeta duke menduar se ku të vazhdoja dhe të vazhdonim mësimet e vitit të tretë. Qysh në fillim të orës së parë isha në zyrën e drejtorit që ti merrja sihariqin se njerëzit e tij në Kërçovë nuk duan të dëgjojnë për hallet tona si shqiptarë. Por pas meje në zyrë hyri edhe profesori i nderuar i gjuhës frënge,një burrë shtat lartë përherë me nxënësit i buzëqeshur dhe plot energji. Unë sa i tregova drejtorit për sjelljen e referentit në Kërçovë. Profesori i nderuar mu drejtua me fjalë shumë të ashpra:

-Kërçovar vendi yt nuk është këtu,që ti këtij ti raportosh,ti drejt e në klasë. Por unë i humbur,i trembur dhe... thash :

-Profesor!!!por ai s' më la që më tepër të hapja gojën,më kapi për krahu dhe më shtyri në drejtim të derës,dhe po me atë ton të ashpër bile edhe më tepër dëgjova se i tha drejtorit:

-Mjaft i malltretove nxënësit...,ata kanë një hallë,që të shkollohen...dhe nuk u interesojnë hallet tuaja për pagesa e ngatërresa që bëni ju me nxënësit tonë shqiptarë. Kurse unë fillova të zbritja shkallëve teposhtë duke mu zënë fryma nga astma dhe nga ai shqetësim i asaj dite shtatori kur moshatarët e mi ishin shumë të lumtur. Duke u mbajtur për parmakëve të shkallëve,veshët e mi prapë i dëgjuan fjalët e profesorit:

-"MJAFT I MALLTRETUAT NXËNËSIT SHQIPËTARË"...dhe s'di pse në trup ndjeva një lehtësim dhe një forcë,që të vazhdoja për në klasë...

Të nesërmen emrat e tonë u regjistruan në regjistër dhe ajo barrë na u hoq prej trupi dhe koke,por mua më kapi një frikë prej atyre fjalëve që profesori i nderuar ia tha drejtorit dhe po të thuheshin ato fjalë në Kërçovë qysh prej ati momenti profesori do ti fitonte nja dhjetë vjet burg edhe atë prej vet komunistëve shqiptarë,që aq shumë e urrenin gjuhën

dhe arsimimin shqip,duke u arsyetuar me një “VËLLAZËRIM BASHKIM” të fëlliqtë,e kjo urrejtje më tepër ishte te ai që,na doli në ballkonin e banesës së vet dhe në gjuhën maqedone na shau, na fyhu dhe na tha të largoheshim,kurse në atë post ishte zgjedhur me votat e prindërve,vëllezërve dhe motrave tona...???!!!

09. 03. 1972
Kërçovë

Cingërima e ziles tregoi se mbaroi edhe ora e tretë e asaj dite,por edhe unë kisha mbaruar me shpjegimin e mësimit dhe kisha bërë edhe përsëritjen e asaj teme në pika të shkurtra me nxënësit dhe prisja me padurim të laja duart prej pluhurit të shkumësit. Me regjistrin në dorë arrita i pari në sallën e arsimtarëve,pasi klasa ku kisha mbajtur mësimin si kishte më shumë se pesë,apo gjashtë metra largësi. Sa e hapa derën në një tavolinë e pashë arsimtarin e gjuhës shqipe,që dikur e kisha pasur edhe arsimtar,i kishte venduar bërrylat mbi tavolinë dhe me gishtat e gjatë dhe të hollë e kishte mbështjellë kokën dhe aspak si bëri përshtypje se unë e hapa derën e sallës,por as edhe të tjerët pas meje. Unë shkova te çezma i lava duart dhe kur u ktheva prapë më shkuan sytë te arsimtari i nderuar. U brengosa duke menduar se do të kishte një kokë dhembje të pa durueshme. U afrova dhe i thash:

-Shoku arsimtar,po të doni unë kam hapa për kokë dhembje! Ai vetëm pak e lëvizi kokën më shikoi dhe më tha:

-Ju faleminderit koleg,por unë nuk kam kokë dhembje,por mendohem se pas kësaj ore kam hartimin e tretë të këtij viti dhe i kam tri tema dhe mendohem t'ua jap të tria,dhe nxënësit të zgjedhin njërin nga ato,apo vetëm njërën për të gjithë klasën. Dhe e hapi fletoren dhe mi tregoi të tria temat. Unë si i lexova me vëmendje desha diçka të them,por më ndërpreu një nga kolegët që kërkonte regjistrin e klasës që unë kisha pasur mësim dhe akoma se kisha venduar në vendin e caktuar,si kërkova falje për gabimin u nisa në drejtim të tij,që të ia jepja regjistrin,por ai me një shpejtësi erdhi dhe e mori regjistrin. Unë u ktheva te arsimtari dhe fillova prapë ti

lexoja temat e planifikuara dhe s ‘di si mu kujtua një temë dhe i thash kolegut:

-Por sikur unë të ju propozoja edhe një temë dhe nxënësit të zgjidhnin njërën prej të katërtave?! Ai më tha:

- Me kënaqësi do ta pranoja temën e propozuar,Ju vetë thoni. Atëherë unë e thash temën,që aty për aty mu kujtua:

-“A DO TË NA SJELLI LULE KJO PRANVERË”.

Profesori i nderuar më shikoi dhe më luti që të ia diktoja si temë të katërt,dhe më tha:

-Të lumtë koleg dhe të faleminderit. Unë e shikova dhe u drejtova në drejtim që të merrja regjistrin e ngelur dhe sa më shpejt të shkoja në klasë ku më prisnin nxënësit për të zhvilluar mësimin nga lënda e fizikës.

16. 03. 1972
Kërçovë

Në ora shtatë isha në sallë të arsimtarëve,por profesori i nderuar kishte arrit përpara dhe më priste me një ushtrimore në dorë duke më përgëzuar se disa nga nxënësit kishin marrë si temë atë që e propozova unë,por njërën nga ata ma kishte lënë mua që unë ta lexoja dhe të bëja notimin. Unë i thash se do ta lexoj me kënaqësi,por kurrë nuk do të bëjë notimin,pasi unë nuk jam kompetent për lëndën që se ligjëroj dhe s’kam bile edhe aq njohuri. Tema ishte vërtetë ajo që e kisha propozuar ditë më parë unë,por vërtetë s’ishte e notuar,profesori kishte bërë vetëm disa korrigjime drejtshkrimore.

“ Ishte dita e diel,kur dielli ishte ngjitur lart disa hosten,dhe me rrezet e veta ngrohte natyrën e sa po filluar të gjelbëronte,por në UJMIR dhe ÇELVJOLLCË,bora akoma s’ishte shkrirë. Unë me të motrën dhe disa shokë dhe shoqe u

ngjitëm kodrës përpjetë. Aty te zabeli i xha Dervishit nën ferrat e kulumbrisë ndiem një mermë vjollce. Motra ime me një shoqe u afruan dhe mblodhën një tufë lule,edhe ne mblodhëm disa lloje të luleve dhe vajzat i lidhën shumë bukur në buqete. Kur u kthyem në fshat njëra nga shoqet na tha që të shkonim drejt e në shtëpinë e mësueses të pensionuar,prej kohësh. Ne të gjithë e pëlqyem propozimin dhe të tërë u gjendëm përpara derës së shtëpisë së mësueses. Sa i ramë ziles derën e hapi i shoqi i mësueses,po ashtu dikur mësues i yni. Si e hapi derën deri sa u mbështet për muri dhe na tha:

-Urdhëroni nxënës të dashur edhe mësuesja është në dhomë. Ne të gjithë hymë drejt e në dhomën e saj se kjo nuk ishte hera e parë,por sot ishim disi më shumë. E përshëndetëm,edhe ajo na përshëndeti motrën time dhe një shoqe të saj i thirri në emër,që të afroheshin dhe të uleshin në prehrin e saj. Edhe mësuesja si ne pak më parë e shijoi aromën e luleve,ne i mbanim në dorë. Unë i dhashë shenjë një shoqes që ajo me disa fjalë të ia uronte mësueses TETË MARSIN,dhe Yllka me atë stilin e saj si aktore i tha disa fjalë,mësuesja i shtriri duart dhe tha:

- Të lumtë Yllka e mësueses,po afrohuni te mësuesja tu puthi. Derisa mësuesja na puthte në dhomë hyri mësuesi me disa sheqerka në dorë,unë me tufën e luleve në dorë i dola përpara dhe i thash:

-Mësues edhe për Juve kemi mbledhur pak lule,por të na falni se sikur pak jemi vonuar,por dje nuk ishin disa nga shokët,prandaj edhe vendosëm që sot të vinim të gjithë. Mësuesi si mori lulet u falënderua dhe më puthi,po ashtu i puthi edhe të tjerët. Nëpër faqet e mësueses rrokulliseshin ca sumbulla lotësh dhe i tha të shoqit:

-EDHE KJO PRANVERË NA SOLLI LULE,kurse mësuesi i tha:

-Po zonjë,por nuk duhet të rrokullisësh përherë lot nëpër faqe se ashtu dikur i humbe sytë,tash ndoshta të

keqësohen. Ne u shikuam në mes veti ndenjëm edhe pak dhe kërkuam leje,por me premtim se do ti vizitonim edhe herë të tjera.

Unë u binda në atë që kisha dëgjuar nga prindërit se mësuesja i ka humbur sytë në vitin njëmijë e nëntëqind e pesëdhjetë e pesën,kur për afër një javë prej klasës së sajë për në Turqi kanë shkuar afër gjysma e klasës. Mësuesja ka qarë tërë muajin dhe prej atëherë e ka humbur shqisën e të parit...”

Unë si e lexova hartimin shpesh ndija TROKUN E KALIT TË ZI duke shkuar rrugës përskaj zabelit të xha Dervishit për te Kodra e Kishës ku atje në skaj te lëndinat ndodhej GORRICA dhe më kujtohej HARTIMI I PA MBARUAR i shoqes së klasën,që mori rrugë e gjatë dhe pa kthim,për në fshatrat e Anadollit,apo ndonjë lagje të Stambollit.

* * *

24. 06. 1972
Zhubrinë

Sot ishte konsultimi i fundit me shokun dhe më s’kam nevojë për informata të tjera. Nesër duhej dhënë pasaportën për vazhdim,pasi për dhjetë ditë i kalon afati.

10. 07. 1972
Stamboll

Taksin e pagova pak si shtrenjtë,por ndryshe nuk do të mundja të gjendesha,në këtë qytet kaq të madh dhe kur s'di asnjë fjalë turke. Kryesorja jam në atë rrugë dhe prej numrit të kërkuar jam larg vetëm pesëmbëdhjetë numra më afër s'mundej,pasi ky është ti themi hotel më i afërt dhe ndoshta edhe i vetmi në këtë lagje.

Kohën e para ditës e kalova në çajtoren që ndodhet përballë numrit të kërkuar dhe sa herë hapet porta shikohej mirë pasi edhe xhami është i madh,por edhe i pastër.

Edhe pas dite ndodhem në të njëjtën çajtore,por edhe në të njëjtin tavolinë,por edhe në të njëjtën karrige. Ashtu siç i kisha informatat,aty nga ora gjashtëmbëdhjetë u hapë porta dhe prej saj doli një burrë,që para dite e kisha parë aty në afërsi ku unë isha ulur me një djalë duke pirë çaj. Pastaj edhe një grua me një fëmijë lurek. Bëra pagesën dhe dola që të shikoja kush do të ishte ajo grua. Si ecën nja njëqind hapa u ndalën te turma e njerëzve,ku pas disa minutash erdhi autobusi dhe gruaja me lurek hipi,kurse burri si i tha diçka u kthye në drejtimin e çajtores. Unë pa mos u hamendur hipa në autobus,që ishte gjysmë i mbushur dhe u ula përballë asaj gruaje. Prej vapës që bënte ajo e hoqi pak shaminë dhe iu duk e tërë fytyra,pak e rrudhur,por bukuria e dikurshme akoma ishte në fytyrën e saj. Unë e hapa fletoren,shkarravita diçka dhe pastaj me një ton të ulët thash:

Sot do ta mbarojmë hartimin e filluar atëherë kur u përcollëm prej klase direkt te treni që villte tym të zi. Të bënë të fala mësuesja e verbëruar për ju,GORRICËN e kishin prerë,por prej trungut të saj të fortë kishin dalë shumë filiza.

Atëherë gruaja e ktheu kokën andej prej ku i vinin fjalët,por edhe unë e ktheva kokën nga ajo dhe na u përputhën shikimet. Ndoshta do të thoshte diçka,por fëmija që e mbante në prehër lëvizi dhe dha një shenjë shqetësimi. Ajo e lëkundi dhe i tha:

- Fli zemër në prehrin e nënës zemërplasur dhe shpirtrob,fati ashtu e deshi,më vjen keq për mësuesen,prej kur kam dëgjuar edhe unë kam derdhur shumë lot,kam derdhur edhe lot të tjerë...Unë u çova duke i uruar të mira në jetë... Edhe ajo më uroi rrugë të mbarë dhe mbarësi në jetë,duke më porositur që të përshëndes dhe ta puth mësuesen e dashur dhe të ulem dhe të rri pak nën hijen e filizave të GORRICËS së prerë në fushën e fshatit të saj të lindjes dhe... Unë u afrova te vozitësi i autobusit dhe i dhashë shenjë,që të ndalej që unë të zbrisja,ai i habitur diçka tha,por unë s'kuptova gjë,zbrita i shqetësuar dhe i HUMBUR diku në Anadollin ku tret gjaku im...

12. 07. 1972
Stamboll

Anija çante valët e detit të tërbuar,dama me borsalinë prej kashte sodiste hapësirën,kurse albatrosët fluturonin të shqetësuar mbi kokat tona,kurse unë shkruaja poezinë:

MATANË DARDANELEVE

Matanë Dardaneleve
Të bëhet trupi shkrumb
Për ëndrrat fëmijërore
Në zemrën e shkatërruar
Ngushëllon vetveten me fëmijën
Që kur lindi qau S H Q I P
Herë pas herë një shpresë
Me dridhje trupi si purtekë
Për vizitë-SHTËPISË PA NJERËZ-
Lot për DITARIN plotë pesëshe
Për rrugën te KODRA E KISHËS
Që u trembëm nga troku i kalit azgan
Të dijë fëmija për vendlindjen e nënës
Të qajmë atje larg-
MATANË DARDANELEVE?!

26. 06. 1974
Zhubrinë

Provimin e Vizatim Teknik e kalova me shtatë. Profesor Engjëll Rodiqi më tha se kam mundur edhe më shumë,unë i thash se do të mundohem për në vjeshtë në provimin e Ndërtimtarisë. Ai qeshi dhe më uroi pushime të këndshme,por edhe unë ashtu i urova profesorit të nderuar. Dhe pas një ore prej Prishtine u nisa për në Shkup dhe pastaj në Zhubrinën time të dashur,në shkollë ku punoja i kisha dorëzuar të gjithë raportet.

Baba i pensionuar nuk më angazhon shumë me punë të fushës,por unë kam qejf të shkoj në mal,prandaj i ruaj edhe lopët,përgatis provimet shkruaj,lexojë literaturë të ndryshme dhe bëjë plane për pushimet e verës në det. Sot duke lexuar më kishte zënë një gjumë i ëmbël dhe i thellë. Ajo laroshja që shumë herë më bënte probleme,sot si kishte hetuar që unë isha në gjumë ngadalë me siguri duke i mashtruar edhe lopët tjera ishin lëshuar teposhtë dhe drejt e në arën e xha Rexhës. Për fat xha Rexha kishte ndodhur aty afër dhe lopët nuk kishin bërë shumë dëm. Duke mos ditur se të kujt janë i merr dhe dërgon në drejtim të fshatit. Aty te ura e fshatit ku përherë pinë ujë i kishte parë lopët baba,por kishte parë edhe xha Rexhën. Ashtu i trembur dhe mërzitur e pyet a i kanë bërë shumë zullum dhe se krejt zullumin do të ia paguaj. Xha Rexha kur kupton se lopët janë të tija dhe se unë i paskam ruajtur atë ditë në mal i thotë babës:

-Po si nuk i lash ta hanin tërë bimën dhe i afrohet babës dhe i thotë me ton edhe më të lartë;mos e qortosh djalin

se n ...n... Xha Rexha është një burrë mesatarë,një bujk i mirë,por në majë të gjuhës e ka bërtitjen dhe sharjet,siç thotë edhe tezja,gruaja e tij ai gjëmon por kurrë nuk shtinë rrufeja,sa të afrohet të shan edhe menjëherë ik në drejtim tjetër.

* * *

Një ditë kur u ktheva bashkë me lopët dhe kalin mbi tavolinë të kuzhinës pash një zarf me shumë pulla. Kur u afrova të shkruar pash emrin tim,ishte nga Vjena e largët. E hapa,por s'kuptova asnjë fjalë,ishte e shkruar në gjuhën angleze.

Të nesërmen u nisa për në Kërçovë te Ahmed Mora, profesor i gjuhës angleze. E lexuam dhe po atë dita iu përgjigja. Dhe prej ati momenti ndryshoi plani i pushimeve verore. Si lutje prej babës për punët e fushës kisha të ujitja dy herë misrin e mbjell dhe kur të doja mundesha të shkoj në pushim. S'di pse kur i shikoja gjethet e misrit të venitur gjatë ditës kur bënte shumë vapë,në trup ndija një lodhje,dhembje dhe sulm astmatik.

Në mal ishte freskët,por dhe bar të mjaftueshëm kishte për bagëtitë. Unë përveç që i ruaja bagëtitë edhe lexoja për provimet e ngelur,por bëja edhe planin e udhëtimit të gjatë dhe shpejtoja me përpunimin e dytë të romanit "ANIJA KOZMIKE",pasi kisha marrë një përgjigje jo pozitive nga Redaktori i Botimeve në Prishtinë,por unë nuk hekë dorë aq lehtë nga krijimtaria ime. Ndoshta dikur do të ndryshojnë mendimet dhe censurat,për njerëzit jashtë "ELITËS" shkatërruese për krijimtarinë shqiptare,në këtë shtet artificial si edhe vet kryetari enigmatik TITO.

10. 07. 1974
Zhubrinë

Në mbrëmje i tregova babës se të nesërmen në gjashtëmbëdhjetë e tridhjetë minuta me tren do të nisem në rrugë,ai më tha për në Ulqin,unë i thash se do të nisem,por akoma nuk kam vendosur për ku. Duke qeshur i thash,ndoshta në Vllajakën (Rumuni) tënde,ku dikur si i ri ka punuar edhe ai qeshi duke më dëshiruar rrugë të mbarë.

Para ditën e kalova duke u përgatitur dhe në ora katërmbëdhjetë së pari u përshëndeta me motrën,pastaj me babën dhe në fund me nënën. Motra duke më vërejt me një buzëqeshje për rrugë të mbarë më tha:

-Thëntë Zoti ky të jetë vit i fundit,që në pushime shkon vetëm. Unë qesha baba dhe nëna përnjëherë thanë:

-Motra ka të drejtë moshatarët tuaj fëmijët i kanë në shkollë. Baba mu afrua dhe në xhep më futi ca para duke më thënë:

-Të të gjinden për rrugës. Unë mora valixhen dhe u nisa për atje ku ndalej autobusi,që ka afër dy kilometër. Gjatë rrugës dy herë e ndërrova valixhen prej njërës dorë te tjetra,kurse Laroja si përherë më shikonte me habi. Kur arrita te hija e lisit te mulliri i xha Halimit u ndala pak dhe nuk di si më shkoi dora te xhepi,u habita kur pash se baba më kishte dhënë një shumë parash,pak më tepër se dy rroga të arsimtarit edhe atë në valutë. Desha të kthehem ti lejë paratë në shtëpi,por i thash vetvetes se nuk duhej ti harxhoj,kurrgjë s' më pengojnë që i kam më tepër.

14. 07. 1974
Vjenë

Edhe sot si dje duhej të shkoj në atë shtëpi ku portreti i HITLERIT është me një dimensione bukur të mëdha i var në murin e sallonit të rregulluar në mënyrën më bashkëkohore. Aty biseduam për bregdetin e bukur të Adriatikut,për verandën e bukur të hotelit"TARA" ku përpara një muaji vallëzonim së bashku me nxënësit e mijë mjaftë të disiplinuar të sjellshëm dhe super të shkëlqyeshëm në mësime.

Deri te ajo shtëpi sot më shoqëroi shoku Halim Miftari një bashkëfshatar i imi dhe prej aty shkoi në punë,ndërrimi i dytë. Edhe kjo ditë kaloi shumë mirë me biseda të temave të ndryshme. Ku për çudi në hartën e tyre përveç Kërçovës ekzistonte edhe Zajazi. Në shtëpi ndejmë afër një orë e pastaj shkuam te vila e tyre afër njëzet kilometra në jug të Vjenës,që ndodhej në mes të pemëve dhe afër një hektar vresht.

Në ora njëzetedy e tridhjetë minuta ra zilja e shtëpisë,sa e hapëm derën i pash shokun Halim dhe shokun Neshat Hajdinin,po ashtu një bashkëfshatar i imi. I luti për një kafe,por ata nuk pranuan duke thënë njëherë tjetër. U përshëndetëm duke më thënë:

-Nesër në kohën e caktuar,që të vizitonim Parkun e Praterit,katedralet dhe...,por unë i thash edhe Muzeun ku ndodhet shpata e Skënderbeut,përgjigja ishte; pa tjetër.

Më lutën të hanim darkë,por unë i refuzova,pasi kisha hëngër me një familje HITLERIANE,por nuk munda të refuzoj edhe pijet.

17. 07. 1974
Bratislavë

Personi i familjes së Hitlerit,në punë do të ishte njëzetekatër orë me gjithë kujdestarinë,pasi shumica e mjekëve nga të punësuarit ishin në pushim vjetor. Prandaj unë këtë ditë e shfrytëzova për të shkuar në qytetin e parë të Çekosllovakisë,Bratislavën.

Në kufi të Çekosllovakisë,së pari na kontrolluan pasaportat,pastaj këmbyem kruna dhe më në fund erdhi një femër,që bënte doganimin. Unë kisha vetëm çantën në te një fjalor,një roman dhe një ombrellë. Ajo u ndal te unë dhe filloi të më pyes:

-Ç'do të shes dhe ç'do të blejë në Bratislavë?! Unë i thash:

-Për të shitur s'kam ç'të shes,kurse për të blerë po, ajo më shikoi me habi dhe më tha:

-Ç'do të blini?! Unë ashtu serioz:

-Një vajzë të bukur si ti,por jo police. Se e urrej uniformën,në vendin tim ia kemi parë sherrin. Ajo e shtriu dorën dhe ma mori pasaportën,që e mbaja në dorë. Duke qeshur në gjuhën frënge tha:

-Tito,njeri i mirë. Unë i thash:

-Si ai që është i varë në murin e mikes. Ma dha pasaportën duke më uruar një ditë të këndshme në shtetin e saj. Unë e mora çantën dhe dola prej në kupe,pasi ishim afër stacionit. Deri në qendër të qytetit shkova me autobus. Sa zbrita hyra në një restorant për të hëngër bukë,por edhe të pija një kafe. Personeli ishte shumë mikpritës,por ushqimet dhe kafeja,jo aq kualitativ. Tërë para ditën vizitova shumë shitore

dhe kafene,por nuk më lanë ndonjë përshtypje,përveç... Duke u larguar nga qyteti në drejtim të stacionit të trenit,vizitova Muzeun e Leninit dhe një librari mjaftë mirë të pajisur me libra,që më lanë shumë përshtypje.

Në ora shtatëmbëdhjetë e tridhjetë minuta u nisa për në Vjenë,por sot drejt e në banesën e shokut Neshat. Ai ishte kthyer nga pune dhe më priste,që të dilnim në qytet,ku në një kafene duhej të takoheshim me shoku Halim.

Në ora njëzetedy unë u futa në një shitore, librari ku shiteshin edhe aparate për të fotografuar, njëri prej tyre më pëlqeu shumë,që më shtyri edhe ta blejë.

18. 07. 1974
Vjenë

Në banesë u takuam aty nga ora dhjetë për të vizituar edhe disa vende turistike në qytet,e pastaj me një kolege pune,që e zotëronte shumë mirë një gjuhë sllave shkuan në një vend turistik,larg nga Vjena afër tridhjetë kilometra. Tërë ditën e kaluam së bashku,ku shumë herë vinim në kundërshtim me politikën Jugosllave ndaj shqiptarëve e veçanërisht ndaj Kosovës.

19. 07. 1974
Hungari

Së bashku me shokun Neshat u çuam në ora pesë të mëngjesit dhe pa humbur kohë u nisëm në drejtim të stacionit të trenit West Banof. Aty u përshëndetëm,ai shkoi në punë,kurse unë i hipa trenit për në Budapest. Udhëtimi ishte

komod në klasën e parë dhe jo shumë pasagjerë. Në tren piva kafen e mëngjesit,por edhe hëngra një ushqim të paketuar,që nuk ishte sipas shijes sime. Pas disa orësh udhëtimi arritëm në Budapest,e lash valixhen në gardërobë të stacionit dhe u nisa në një drejtim pa lidhje. Budapesti qytet i vjetër,por i rregulluar dhe i pastër,por jo edhe i furnizuar,si shitoret e Vjenës.

Drekën e hëngra në restorantin që ndodhej në qendër të qytetit,por përpara se të bëja porosinë kamerieri më tha se aty janë ushqimet e shtrenjta. Unë kërkova menynë dhe porosita gullash,sallatë dhe një birrë,sa mbarova me ushqimin porosita edhe një kafe dhe i thash që të paguaja dhe fillova të mbush një fjalë kryq,që më kishte ngelur përgjysmë. Kamerieri erdhi ma solli llogarinë unë ia dhashë forintat dhe i thash:

-Ky ushqim është dy herë më lirë se në bregdetin Kroat apo Malazez, ose nëpër restorantet e Austrisë,bile edhe në tërë Jugosllavinë dhe kuptohet i dhashë edhe bakshish për të pirë një kafe. Ai qeshi dhe mu falënderua në gjuhën frënge. S'di pse ky qytet,por edhe vendi në përgjithësi për kaq kohë të shkurtër mu bë i bezdisshëm dhe i pa dëshiruar. Përpara sysh i kam gratë punëtore të hekurudhës,që ngrinin pragjet dhe shinat. Ata gjatë udhëtimit prej në kufi të Hungarisë i takuam disa herë,nëpër hekurudhën e gjatë,s'di a ishin të punësuara apo ndoshta ishin të burgosura...?!

U futa në rend të marrë valixhen prej në gardërobë,ia dhashë tiketën i punësuari e shikoi dhe shkoi ta merrte. Edhe unë edhe të tjerët udhëtarë pritnim,ai shkonte herë në njërën herë në anën tjetrën,por assesi ta gjente valixhen time. Koha e trenit për tu nisur afrohej,thirri edhe një tjetër ia dha tiketën dhe vazhdoi punën me të tjerët. Ai më thirri brenda dhe më tha që të prisja ai hyri nëpër një derë me siguri në zyrën e tyre dhe a nxori valixhen duke qeshur,unë i nervozuar i thash në gjuhën shqipe:

-Unë jam terrorist i gjetët bombat,apo brekët e palara,edhe ai qeshi dhe tha diçka në gjuhën e tij. Treni në çdo moment duhej të nisej,për në Bukuresht. Unë sa u drejtova për te sporteli që të preja biletën,konduktori mu afrua dhe më tha:

-Bukuresht,unë pohova me kokë dhe vetë e mori valixhen dhe u nis në drejtim të trenit. Hipa konduktori më dha shenjë që të rrija aty ku isha dhe zbriti. Nuk shkoi as një minutë treni u nis. Ai vinte prej anës tjetër të vagonit sa më pa dhe më dha shenjë që të shkoja pas tij. Në atë vagon kishte një grup fëmijësh me siguri nxënësi,që shkonin në pushime në bregdetin Rumun. Më dha shenjë që të futesha aty ku ishin katër femra,që më vonë kuptova se ishin arsimtare të atij grupi. Nxora prej valixhes fjalëkryqin,u mbusha me frymë e vendova valixhen dhe u ula,për të vazhduar aty ku kisha mbetur. Në kokë mu paraqit ajo katrahurë e pak më përparshme. Duke filluar të mendoja,mos më kërkonte para të dyfishta për biletën,apo të thërriste policinë. Dola prej kupesë,pash andej,por konduktori me siguri bënte punën e vet,kurse nxënësit shkonin prej njërës kupe në tjetrën. Dy vajza erdhën në kupenë tonë ku ishin arsimtaret dhe u konsultuan diçka,ku edhe unë kuptova për profesionin e tyre dhe disi u rehatova.

Dikur filluam të bisedojmë herë në gjuhën frënge herë në gjuhën serbe,që njëra nga ata e dinte, pak më tepër dhe na afroi profesioni i ynë prej arsimtari. Unë e hoqa katrahurën prej koke dhe vazhdova bisedën me katër arsimtaret e kombit,që për aq kohë të shkurtër më la një përshtypje jo të mirë. Nuk shkoi shumë kohë erdhi konduktori dhe më pyeti,a jem mirë,unë i thash se ndihem shumë mirë në mesin e katër arsimtareve. Ai doli prej kupesë,por edhe unë pas tij duke e pyet sa duhej të paguaj dhe të më jepte biletën.

Ai qeshi dhe më tha shumë. Unë desha ta pastronim punën e biletës,por në atë moment doli njëra nga arsimtaret bisedoi me konduktorin dhe mu kthe mua në gjuhën serbe:

-S'ka problem,do të udhëtoni në shoqëri me ne. Unë thash faleminderit dhe ajo hyri në kupenë e parë që ishte afër nesh. Unë fillova të shikoj për xhamit të trenit dritat e shumta,që ngelnin pas nesh dhe në atë moment fishkëlleu treni.

Me arsimtaren,që e dinte gjuhën serbe u miqësuam pak më tepër sepse më shumë komunikonim. Atë e kisha edhe përkthyese kur bisedoja me koleget e saja,por edhe me konduktorin,që shumë herë na vizitonte. Aty pas orës njëzetetre i qerasa nga një kafe të katër arsimtaret,por edhe konduktorit më vonë i thash të pinte një kafe prej meje,ai prapë qeshi dhe u falënderua. Arsimtarja kishte studiuar dhe akoma studionte gjuhët ballkanike dhe kishte mjaft njohuri edhe për gjuhën shqip,që edhe shumë fjalë dinte. Edhe ajo kishte të shkruara shumë poezi,por edhe të botuara nëpër revista të ndryshme. Edhe unë ia tregova ditarin që mbaja për ato ditë udhëtimi,por edhe disa botime.

Në kufi policët ma morën pasaportën dhe shkuan. Pak para se të hymë në territorin Rumun konduktori ma solli dhe më tha se krejt është në rregull,por e paske të mbushur me vula të shumë shtetesh. Unë prapë i thash për biletën,por ai tha se nuk duhej të mërzitesha se e pagova me kafenë. Mua më kishin ngelur dyzet forinta dhe i thash merri,se do të më duhem edhe pak do të duhej të kem para të Rumanisë.

Shumë herë nëpër fjalëkryqet duhej ta dija qytetin e bukur të Rumanisë,Aradin dhe isha me nijet që të ndalesha,por kur arritëm ishte natë dhe shoqëria ishte e mirë,prandaj edhe vazhdova për në Bukuresht,por aty nxora biletën,që nuk më kushtoi shumë.

Konduktori si bëni krejt kontrollimet erdhi në kupenë tonë dhe mu drejtua mua,po të deshëm vagoni tjetër është për fjetje,për shumë pak para mundeni të pushoni disa orë...

21. 07. 1974
Bukuresht

Kur arritëm në Bukuresht rrezet e diellit nxehnin dhe treni tjetër për tu nisur për në Konstancë kisha afër pesë orë të plota. Eca lart e poshtë nëpër rrugët e Bukureshtit nëpër të cilat dikur baba,daja por dhe shumë të tjerë kërçovarë siguronin kafshatën e bukës,për vete dhe familjet e tyre. S' di si më shkuan sytë lart dhe pash me germa të mëdha ku shkruante: Hotel "NORD",u afrova dhe hyra brenda,porosita një kafe dhe u ula në një tavolinë afër banakut të kafenesë dhe si shumë herë edhe këtu e nxora fjalëkryqin dhe fillova të mbush katrorët që kishin ngelur të zbrazët. Kamerierja ma solli kafenë dhe u afrua të shikonte diçka te fjalëkryqi. Shikoi gjatë e dikur unë i thash:

-Ti nuk kupton se është në gjuhën shqipe,ajo me siguri e kuptoi fjalën shqip dhe mu kthye me një buzëqeshje:

-Albane,unë iu përgjigja:po,prapë në gjuhën shqipe. Ajo vazhdoi në gjuhën e vet:

-Komshiu i im është tha shqiptar,Xhelko Maksutovicki. Për fat të keq unë nuk kisha dëgjuar për atë njeri. Ajo prapë më tha se është profesor. Atëherë unë në gjuhën frënge i thash:

-Baba dhe daja im dikur kanë punuar në Bukuresht,po të keni kohë të lirë uleni dhe pini një kafe prej meje. Ajo e zotëronte shumë mirë gjuhën frënge. U ul dhe tha

se me kënaqësi do ta pinte një kafe prej meje dhe shkoi,por për disa minuta erdhi me gjithë kafenë. Ia nisëm bisedës aq sa unë e dija frëngjishten. Kamerierja ishte një studente e vitit të fundit në histori,por prej gjendjes jo të mirë financiare gjatë pushimeve të verës siç më tha punon ku të gjejë një vend pune,vetëm e vetëm të siguronte pak lei për studime. Biseda do të vazhdonte,por një grup turistësh hyri në hotel dhe ajo u çua se puna është punë.

Prej kësaj që kam parë gjer tani jam bindur se Titoja me shtetin e vet Jugosllavinë,sa është në lindje aq është edhe në perëndim.

Biletën e trenit për në Konstancë e sigurova me kohë dhe nuk më kushtoi shumë,por vetëm njëqindenjëzetepesë lei,që për atë distancë në vendin tim do të kushtonte dy herë bile edhe më tepër. Edhe ushqimi në kryeqytetin Rumun nuk është i shtrenjtë. Shitoret janë të furnizuara një lloj si në kryeqendrën Hungareze. Unë edhe meqenëse vizitova shumë shitore askund nuk bleva asnjë plaçkë. Shitëset ishin të sjellshme dhe me çdo kusht insistonin,që të blejë diçka e veçanërisht kur kuptonin se jam i huaj.

Udhëtimi prej Bukureshtit deri në Konstancë nuk duhej të mbante aq shumë kohë,por një defekt që kishte ndodhur diku me shinat e zgjati kohën e udhëtimit për më tepër se tri orë. Bufeja e trenit nuk ishte aq mirë e furnizuar,por kafen e zinin në atë mënyrën e tyre prej fukarai. Pak përpara se të arrinim në Konstancë njëri nga konduktorët mu afrua dhe më tha:

-A do të duhej bileta? Unë u habita për pyetje,por ai vazhdoi:

-Nëse nuk u duhej ma jep mua. Unë e nxora prej xhepi dhe ia dhashë,ai më shikonte dhe pas pak nxori prej xhepi njëzetepesë lei dhe mi dha. E pyeta pse? Ai qeshi dhe u largua duke u falënderua për biletën që ia dhashë.

Isha mjaft i lodhur dhe rraskapitur,sa e gjeta banesën rashë dhe deri të nesërmen në ora tetë kisha fjetur si qengj,siç thotë populli.

22. 07. 1974
Konstancë

Mëngjesin e hëngra aty afër banesës,një byrek me djathë dhe një jogurt. Piva edhe kafenë e parë në qytetin e Konstancës,që shumë herë kishim biseduar me shokë nëpër tubime të ndryshëm. Kafenë ma pagoi pronari i banesës ku isha vendosur,që rastësisht më pa për xhamit të byrektores dhe në banesë u kthyem së bashku. Pronari ishte një burrë mesatar i punësuar në një ndërmarrje bujqësore,shumë mirë e fliste gjuhën bullgare dhe kuptoheshim,pasi unë i di disa gjuhë sllave. Sa arritëm në oborr më tha të ulesha në tavolinën e vjetër prej dërrasave jo të gdhendura mirë. Ai hyri në shtëpi i la artikujt e blerë dhe doli me një shishe raki dhe disa gota në dorë. Pa mos më pyet i mbushi,unë e shikova dhe i thash se është shumë herët. Në atë moment doli prej dhomës përdhese një burrë me pantallona të shkurtra dhe pa këmishë. Na përshëndeti dhe pa mos u lutur shumë e mori gotën time dhe ia gjeti fundin. Ato bisedonin në gjuhën e tyre unë dëgjoja edhe pse nuk kuptoja asnjë fjalë. Nisa të çohem,por ai burri më foli diçka,që nuk e kuptova,por pronari më tha se gruaje e tij e paska venduar kafen dhe s’është mirë ta refuzosh siç ma refuzove rakinë. U ula dhe thash ti thotë shokut se do ta pijë me gjithë qejf. Ne sa mbaruam fjalët prej derës së afërt doli një grua goxha zonjë. Na përshëndeti,mua më dha dorë dhe e pyeti pronarin prej cilit vendi jam. Ai i tregoi se jam nga

Jugosllavia,por se jam shqiptar. Ajo më buzëqeshi ma afroi kafen dhe u ul në afërsi të burrit.

Në ora njëmbëdhjetë dola në plazh,që nuk e kisha shumë larg nga banesa. Pronari më tha se edhe ai me të shoqen do të dilte në plazh,pasi disa ditë kishte marrë pushim dhe do të më takonte,por të kisha kujdes. Rrezet e diellit nxehnin,por unë nuk kisha pengesa se isha rrezitur në mal duke ruajt bagëtinë,por edhe duke ujitur misrin. Si eca pak lart e poshtë e shtrova peshqirin mbi rërën e nxehtë që herë e mbaja në dorë herë e vendoja mbi njërin krahë. U shtriva,por prej rrezeve të forta u djersita shumë shpejt. I hoqa syzet dhe kapelën prej koke dhe u drejtova drejt detit të kaltër me valët sikur të lodhura. Sa mu lagën këmbët trupi mu mbush plotë mornica. Me njëherë mu kujtuan valët dhe uji i vakët i Detit Adriatik në Ulqinin piktoresk,por edhe në shumë vende të tjera. Mora ujë me dorë dhe e laga trupin,por mornicat më tepër shtoheshin. Unë ecja përpara dhe thellohesha në valët e detit,që vinin njëra pas tjetrës,por edhe trupi adaptohej në temperaturën e ujit të pastër,që ishte hera e parë të lahem në Detin e Zi të jetës time. Si bëra pak not dola se më mungonte kondicioni i ujit. U shtriva mbi peshqir dhe fillova të mbush fjalëkryqet e ngelur të EUREKËS,pasi ato në gjuhën shqipe ishin të tëra të mbushura.

Drekën e hëngra në një restorant në afërsi të plazhit,por duke hëngër ndihesha i lodhur dhe më nuk u ktheva në plazh,por shkova që të pushojë në krevatin jo aq komod sepse trupi i lodhur nuk kërkon shumë komoditet. Me siguri do të kisha fjetur edhe më shumë,por zhurma e atyre që banonin në atë banesë,pasi ishin kthyer prej plazhit ma nxori gjumin.

Mbrëmjen e kalova së bashku me atë shoqen që na bëri kafe dhe të shoqin e saj në një restorant,që kishte një verandë të bukur vallëzimi.

25. 07. 1974
Konstancë

Dje dola më herët që të këmbeja ca para. Rastësisht në afërsi të xhamisë dëgjova ca të rinj që flitnin shqip dhe në dorë mbanin para të ndryshme,por ruheshin nga policët. Po ashtu nja tre katër persona që flitnin serbisht,që dëshironin të këmbenin para bisedonin se ato të rinj i këmbenin shumë më mirë se në bankë. Unë u afrova të rinjve që flitnin shqip dhe i pyeta a merrnin marka të Gjermanisë,njëri më shikoi dhe më tha:

-Ti je shqiptar?! Unë u përgjigja se po. Atëherë po ti paguajmë më mirë. Unë i qita njëqind marka gjermane,njëri më pyeti krejt,i thash se po. Mi dha të hollat,unë iu falënderova dhe u nisa në drejtim të kundërt për në banesë. Njëri nga serbët më pyeti:

-Mos ndërrove para,unë thash se po,por ai më pyeti çfarë valute edhe me çfarë vlere unë si i numërova ia tregova saktësisht shumën. Ato në mes veti thanë se mua mi kanë paguar më mirë. U ndalëm pak të bisedonim dhe njëri më tha po të kem kohë mundemi të pimë nga një kafe. Unë u thash s’ka problem,unë jam vetë dhe s’kam asnjë obligim. Hymë në restorantin e parë dhe porositëm nga një kafe. Aty u njoftuam më mirë dhe më thanë se ishin nga një qytet i vogël që ndodhet në afërsi të Novi Sadit.

Më grupin e Novi Sadit e kalova tërë ditën në plazh,por edhe në mbrëmje ishim deri vonë,nëpër hotelet e Konstancës. Dorën në zemër unë harxhova ato paratë e tepërta që mi dhanë në afërsi të xhamisë këmbyesit shqiptarë,që me siguri pasi ti harxhojë këta prapë do të këmbej te ato. Edhe

para ditën e sotme e kaluam së bashku me ta,në mbrëmje ato do të udhëtonin për në Jugosllavi.

Ato më treguan se në afërsi të Konstancës ndodhet MAMAJA një vend shumë i bukur,prandaj unë vendosa që mbrëmjen e kësaj dite ta kaloj në hotelin që ata ma përshkruan shumë bukur.

Aty nga ora njëzetenjë dola te rruga ku ndalej autobusi urban,ku prisnin edhe shumë të rinj të tjerë. Sa erdh autobusi u bë një tollovi,por unë hipa dhe u ndala nga mesi i autobusit. Rruga ishte shumë e ngarkuar,ne nuk pamë se ç' ndodhi,por kur shoferi autobusit frenoi,u përplasëm njëri me tjetrin. Ashtu të friksuar,por dikush edhe me dhimbje,filluam të kërkonim falje njëri tjetrit. Mua një i ri që pak më parë u përplasëm njëri me tjetrin,më foli diçka në gjuhën rumune,por unë nuk e kuptova,por isha i bindur se më kërkoi falje,që edhe unë e bëra të njëjtën,por në gjuhën frënge. Ai më shikoi dhe me habi më tha:

-Ti je francezë?!

-Jo,i thash, unë jam shqiptar. Ai prapë me habi më shikoi dhe tha:

-S'është e mundur shok! por tash në gjuhën shqipe.

Unë i thash se vërtetë jam shqiptar. Ai më pyeti:

-Nga Shqipëria,Tirana apo Korça. Unë i thash:

-Jo unë jam nga Jugosllavia, republika e Maqedonisë, Kërçova një qytet në afërsi të Ohrit. Dhe në atë moment arritëm në Mamaja,që s'është shumë larg nga Konstanca. Zbritëm prej autobusit dhe u ndalëm të bisedonim,por bisedën na e ndërpreu një shok i tij,turk dhe si i tregoi atij se unë jam shqiptar,ai ma shtrini dorën dhe më tha se quhej ORHAN,unë ia tregova emrin tim,pastaj duke ia dhënë dorën atij shokut,që fliste shqip i thash:

-Ju më njoftuat me shokun e juaj,por as ti mua as unë ty s'ta dijë emrin dhe ia tregova emrin tim edhe atij,kurse ai më tha:

-Unë quhem LAZËR,kurse mbiemrin e kam GJAN. Si u kuptuam pse vinim në Mamaja,ai si bisedoi pak me shokun e vet turk,mu kthye mua dhe më tha:

-Sonte je mysafir i yni. Unë i thash me kënaqësi dhe u nisëm në drejtim të hotelit të bukur për vallëzim"KASUCE". Për fat tonin një tavolinë ishte e lirë në afërsi të çinarit të madh e të trash,që ne të tre s'do të mundeshim ta mbërthenim dhe prej rrënjëve të tij gurgullonin rrëke uji. Porositëm një shishe verë dhe ca meze. Koha na kalonte shumë bukur nën tingujt e muzikës dhe vallëzimeve të lloj-llojit pa pushim të asaj mbrëmje të pa përshkruar veçanërisht,që unë në Rumani takova shqiptar,që edhe qëllimi ishte mu ai. Në hotel ngelëm gjer pas mesnatës,kur edhe ishin autobusët e fundit.

Lazërit i thash kur të arrinim në afërsi të stadiumit të më tregojë se aty në afërsi e kam banesën,ai pohoi me kokë,por me një buzëqeshje dhe filloi të bisedojë me shokun e vet të fëmijërisë,turkun. Kur arritëm,turku vazhdoi kurse mua më tha,që të zbritnim. Unë sa e pash rrugën mu kujtua banesa dhe i thash se jemi afër,por ai më tha se do të vinte edhe ai te banesa e ime dhe vazhduam. Sa i bëmë katër pesë hapa ai më tha:

-Shok ti do të vish në shtëpinë time edhe gjyshja do të gëzohet. Unë i thash se është shumë vonë dhe nuk di si do të reagojë pronari. Ai më tha se me pronarin do të bisedonte dhe nuk ka pse të ketë mosmarrëveshje. Unë iu falënderova duke i thënë se do t'ia paguaj atë natë por edhe disa net të tjera po të ketë nevojë. Në sa hymë në oborr pronari doli prej dhome dhe na përshëndeti. Unë fillova të lajë fytyrën te çezma e oborrit ato ia filluan bisedës. Kur u afrova pronari më tha në gjuhën bullgare:

-S'ka problem unë nxora të holla të paguaj plus për dy net,por ai mori aq sa duhej. E morra valixhen dhe u nisëm duke iu falënderuar,por ai më tha:

-Kur të keni kohë urdhëroni në kafe. Ne vazhduam rrugën dhe ecëm afër dhjetë minuta dhe arritëm në qendër të Konstancës. Sa kthyem në të djathtë në një shtëpi ishte venduar një pllakat që tregonte emrin e rrugës ku shkruante"GEORGE ENESCU" dhe menjëherë shtëpia e parë ishte e prindërve të Lazërit. Sa hymë në oborr dera e shtëpisë u hap,dhe Lazëri bërtiti:

-Gjyshe kemi mik nga vilajeti i yt. Ne hymë brenda gjyshja më mori grykë dhe hyri në pjesën e kuzhinës ku i mbanin zahiretë dhe shporetin. Nuk shkuan as pesë minuta doli me një sini,ku kishte një shishe verë,dy gota,tre a katër copa buke,ullishte pak djathë dhe dy vezë të ziera. Lazari i mbushi gotat,kurse gjyshja tha:

-Unë do tu pjek edhe nga një kafe. Ne filluam të hanim. Gjyshja na i solli edhe kafetë dhe filloi të më pyeste;për familjen dhe nga isha,unë i tregova krejt për familjen,por edhe ajo më tregoi se kishte lindur në Korçë dhe si fëmijë tre katër vjeçe kishte erdh në Konstancë dhe kur s'ishte kthyer më në vendin e lindjes. Ne duke biseduar në atë kohë të pas mesnatës,mua filluan të më dëgjojnë veshët një melodi të bukur shqipe. Dorën në zemër nuk u besoja,bile nuk besoja se jam i zgjuar! Lazëri shikoi gjyshen,por edhe gjyshja Lazërin. Gjyshja filloi një bisedë,por e ndërpreu hapja e derës harmonikë,që ndodhej përballë meje. Dera sa u hap,përpara nesh u paraqit një ZONJË PRIMADONË e veshur me një fustan të bardhë. U afrua përpara meje dhe më tha:

-Zotëri si ishte muzika???!!!Unë pak i shqetësuar bile pak edhe i trembur i thash:

-Ju lumtë, shumë bukur ZONJË,që përherë të parë e përdora fjalën zonjë,pasi në vendet komuniste përdoren fjalët shok dhe shoqe. Dhe heshta,ajo herë më shikonte mua herë Lazërin herë gjyshen. Si shkuan disa minuta u ngrit Lazëri dhe iu afrua me fjalë të bukura:

-Mëmë të lutem është shumë vonë dhe jeni tepër e lodhur,ejani dhe bini të pushoni,nesër do të vazhdoni...ajo duke kërkuar falje na tha natën e mirë dhe me Lazërin hynë në dhomën e saj,ku unë e pash PIANON e bukur të madhe,një relikt i rrallë. Lazëri u kthye e mbylli derën harmonikë dhe më tha:

-Është mëma ime,profesoreshë e muzikës,por ka disa vjet që vuan nga nervat dhe prej atëherë ekzekuton vetëm muzikë shqipe. I mbushi edhe njëherë gotat i cakërruam,por unë i mërzitur për atë që pash,gjyshja erdhi prej dhomës tjetër duke na thënë:

-Krevatet janë gati kur të doni mundeni të bini që të pushoni. Ne duke i thënë natën e mirë u futëm në dhomën tjetër për të fjetur.

26. 07. 1974
Konstancë

Ora ishte tetë e diçka,kur në derën e dhomës që flinim trokiti gjyshja e Lazërit. Me një sjellje të jashtëzakonshme na tha se ushqimi i mëngjesit ishte gati dhe doli në kuzhinë ku gjyshja ishte ulur në skaj të tavolinës dhe na priste që të hanim së bashku. Unë si u ngrita i përshëndeta dhe dola në oborr,që bënte freskët,diellin e kishin mbuluar do re të zeza,e mua nuk di si më vajti mendja te Deti i Zi,prandaj edhe retë ishin aq të zeza. Kur u ktheva në kuzhinë Lazëri ishte ulur dhe në dorë kishte një copë lakrori,duke më thënë:

-Gjyshja i bënë të mirë i ka mësuar prej nënës së vet,si në vendin e lindjes. Gjyshja si më shikoi mua tha:

-Kurrë se ka parë gjyshja Korçën e dashur,që aq me mall dhe dashuri më fliste nëna,por rrallë herë edhe baba ndjesë pastë. Edhe i shoqi më fliste,ai e mbante mirë në

kujtesë,Korçën kur kishte ardhur këtu në Konstancë kishte qenë afër dhjetë vjeç. Atëherë Lazëri tha:

-Sa Skënderbeu kur e kanë marrë turqit. Atëherë në bisedë u ndërlidh edhe nëna e Lazërit,që e mbante kokë me dorë,mua më dhimbsej sepse mendoja se ka dhimbje të pa durueshme. Ajo me një kujdes duke na shikuar tha:

-Skënderbeu pas shumë vitesh është kthyer në atdhe kurse gjyshi yt kurrë. Si vajti në Amerikë edhe prej atje s'u kthye,a unë isha nuse e re dhe mirë e mbaj në mend kur mori një sënduk druri e mbushi me do plaçka dhe e përcollëm deri të porti dhe aty pritëm;shumë nuse,gra,plaka,fëmijë,por edhe shumë të tjerë deri sa anija u zhduk në detin e pa fund.

Lakrori vërtetë ishte i shijshëm,por bisedat kafshatat disi mi ndalnin në fyt,duke menduar për fatin e njëjtë të shqiptarëve pa marrë parasysh se ku jetojnë. Ne sa hëngrëm bukë erdhi Orhani dhe të tërë pimë kafenë e mëngjesit.

Dolëm prej shtëpisë dhe morëm drejtimin e portit,të shikoja prej ku vinin shqiptarët,por më së shumti prej ku shkojnë. Rrugës Orhani i tregoi Lazërit se i kishte ardhur dje në mbrëmje thirrja për të shkuar në Bukuresht,që të bënte praktikën. Lazëri u habit duke i thënë:

-Por pse mua akoma s' më ka arritur?! Ai iu përgjigj:

-Ndoshta të vjen sot dhe nesër ikim bashkë.

Të porti takuam një komshi të Lazërit, që priste të takohej me një shok të djalit,kadet i cili duhej të udhëtonte për në Odesë të Bashkimit Sovjetik dhe atje do të takohej me djalin e tij,që edhe ai afër një muaj bënte praktikën në Marinën Ruse.

Kur u kthyem në shtëpi vërtetë i kishte arritur thirrja Lazërit dhe të nesërmen duhej të udhëtonte për në Bukuresht,që duhej të bënte praktikën afër një muaj. U mërzit,jo se duhej të shkonte,por siç më tha pse isha unë dhe kishte dëshirë ato ditë,që unë do të rrija në Konstancë të ishte

edhe ai dhe Orhani. Prej asaj katrahure e nxori gjyshja duke i thënë:

-Nuk ka ardhur vetëm thirrja jote,por ka ardhur edhe pensioni im nga Amerika e largët dhe ia dha njëqind dollarë,që të pinim kafe në mbrëmje në restorantin më të mirë të Konstancës dhe na thirri të provonim specialitetet prej peshku.

Në mbrëmje na u bashkëngjit edhe xhaxhi Pandeli ai komshiu,që e takuam në port dhe tërë kohën e kaluam në verandën e bukur të restorantit në afërsi të detit. Xhaxhi Pandeli kur kuptoi se të nesërmen Orhani dhe Lazëri do të udhëtonin për në Bukuresht u tha se për mua do të kujdeset ai dhe prej atë natë unë do të shkojë në shtëpinë e tij. Lazëri i tha se unë do të rrija ku isha dhe se s' prishte punë mungesa e tij. Unë kur kuptova se ai në shtëpi është i vetëm dhe ndodhej në pushim vjetor,Lazërit i thash se mendimi i xhaxhit Pandeli ishte me vend,mendimin tim e përkrahu edhe Orhani.

Ora ishte fiks njëzetetre kur i treguam gjyshes për vendimin tonë. Ajo u prek mjaft,por unë i thash se për çdo ditë do ta vizitoj,atë e pohoi edhe xhaxhi Pandeli. Unë nxora prej xhepi ca lej dhe deviza,por gjyshja u prek edhe më shumë Lazëri më kapi për krahu dhe më tha:

-Unë nuk të morra se na mungojnë paratë,por se na mungon vendlindja dhe njerëzit e gjyshes,që shumë herë ia kam parë sytë me lot. Atëherë unë thash:

-Ajo na mungon edhe neve dhe për vendlindjen e gjyshes me qindra shqiptarë ndodhen nëpër burgjet e Jugosllavisë ne s'guxojmë të përmendim emrin Shqipëri. U habitë dhe më tha :

-Juve s'u vinë as gazeta prej Shqipërie?!i thash jo. Lazëri hyri në dhomën e nënës së vet dhe ma nxori numrin më të ri të "ZËRIT TË POPULLIT",që ishte rasti parë të shikoja një gazetë të Shqipërisë. Xhaxhi Pandeli i tha se i ruan disa

gazeta dhe do të mi japi ti lexoj. U përshëndetëm duke i uruar sukses në studimet e më tutjemë...

Deri vonë biseduam me të zotin e shtëpisë,që për aq kohë të shkurtër ndërrova tri banesa. Dikur pimë edhe nga një gotë verë dhe më tha se do të flija në dhomën dhe krevatin e djalit të vetëm dhe se mundem të rri sa të dua..

27. 07. 1974
Mangalia

Xhaxhi Pandeli ishte çuar më herët se unë,kishte dalë në qytet dhe kishte blerë disa simite,për ushqimin e mëngjesit. Unë kur dola prej dhome ai lexonte një gazetë,por në tavolinë i kishte venduar disa numra të "ZËRIT TË POPULLIT",desha ta përshëndes i pari,por ai sa u çol dera tha:

-Mirëmëngjesi shok i nderuar,a keni pushuar mirë? Unë iu përgjigja po. Ai e la gazetën dhe u çua duke më pyet:

-Do të pimë kafe apo e lejmë pas buke. Unë duke qeshur i thash:

-Në punë kam një shok,babën e ka hoxhë dhe përherë kur e pyesin;a doni kafe? Ai u përgjigjet:

-Po por pas buke. E ndezi një furnelë goxha të vjetër,por shërbente.

Duke hëngër i tregova se përpara se ik për në Bulgari duhej të takohem me një të njohur në Mangali dhe atë pas orës katërmbëdhjetë se deri atëherë është në punë për çdo ditë. Xhaxhi Pandele,pa mos u mendua shumë më tha:

-Sot është ditë e mirë dhe nisemi që tash do të ndalemi disa orë në EFORIE NORD dhe aty nga ora trembëdhjetë do të shkojmë në Mangali. Propozimi ishte në rregull.

Plazhi ishte shumë i bukur,por uji mjaft i ftohtë. Ecëm pak lart e poshtë plazhit dhe kur mendonim të uleshim që të

rrezitemi,dikush e thirri xhaxhin Pandele. Ai ktheu kokën andej prej nga erdhi zëri dhe si e pa kush ishte më tha që të afroheshim. Ne sa u afruam një burrë mesatar u çua në këmbë i dha dorë duke e pyetur në gjuhën shqipe:

-Kush është ky shok?! Xhaxhi Pandele duke qeshur i tha:

-Mirë fole shqip që të mos kuptojë,por shoku është si ne shqiptar. Ai duke kërkuar falje i tha një djali që të na shtronte një batanije,që të uleshim kurse xhaxhi Pandele më tha se ishte vëllai i gruas së vet të ndjerë. Gruaje e tij na shërbeu me disa llokume,e pyeti për djalin dhe pastaj i tregoi se me te kishte biseduar përpara dy ditësh. Por edhe xhaxhi Pandele i tha se kishte biseduar dhe i kishte dërguar diçka pas një shokut të vet.

Dielli na nxehu mirë dhe me propozimin e djalit të mikut të xhaxhi Pandele u drejtuam në drejtim të detit,pak të valëzuar. Ato hynë bile edhe shumë thellë,kurse unë nuk munda ta përballojë ujin e ftohtë. U laga pak dhe dola që ti prisja në rërën e ngrohtë.

Në ora katërmbëdhjetë ishim në Mangali dhe sa zbritëm prej autobusit u drejtuam në drejtim të postës,ku punonte personi,që duhej ta takoj unë,që disa ditë më parë kishim udhëtuar nga Bukureshti. E thirrëm në telefon,pasi përpara pesë minutash kishte hipur në katin e tretë të postës ku e kishte edhe banesën. Për disa minuta zbriti dhe të tre u nisëm në plazh,që të shfrytëzonim kohën e bukur,por edhe të shikoja plazhin dhe bukuritë e tij.

Kur arritëm në Konstancë ora ishte pa pak njëzetenjë dhe kishim edhe aq kohë sa të përgatiteshim dhe të shkonim në darkë te miku i shokut Pandeli,por unë isha i brengosur,pse në mëngjes nuk shkuam te gjyshja. Xhaxhi Pandele më tha se do të kalonim andej dhe do ta përshëndetnim dhe të nesërmen do të shkonim në kafe. Ne sa u afruan te shtëpia e Lazërit na pa nëna e tij që ishte ulur në një kolltuk të vjetër prej thuprash

dhe luhatej. U çua dhe na doli përpara duke na thirr për darkë. Ne i treguam dhe ajo tha mirë,si ta keni punën,por ne kemi qejf se mikun e kemi tamam si Lazërin. Xhaxhi Pandele i tha që ti tregonte gjyshes,pasi në atë moment nuk ndodhej në shtëpi.

Miku i xhaxhi Pandeles kishte një shtëpi goxha të madhe dhe të rregulluar mirë. Ne sa u ulëm ai kapi telefonin dhe thirri në tre numra. Kurse e shoqja na i mbushi gotat dhe doli që të piqte kafet. Ne sa i cakërruam gota ra zilja dhe në dhomë hynë një burrë një grua dhe dy fëmijë. Ata sa u ulën prapë ra zilja dhe salloni i gjatë i gjerë dhe bukur i rregulluar u mbush përplot me njerëz. Gotat sa mbusheshin edhe zbrazeshin. Edhe darka ishte shumë mirë e përgatitur. Atmosferën herë-herë e nxehte njëri nga të pranishmit me këngë të vjetra KORÇARE,që unë me të vërtetë humbsha dhe befasohesha duke mos i besuar vetvetes se ndodhem në atë vend të largët në mesin e shqiptarëve dhe më bënin aq respekt. Unë disa herë i cakërrova gotat me atë personin që këndonte aq bukur, por edhe me të tjerët,por me atë gotën e zbraznim menjëherë. Pronari i shtëpisë më tha:

-Mos u habit se kolegu im mjek këndon aq bukur,se është kushëriri i nënës së Lazërit,shokut tënd,këta e kanë pir këngën. Ai duke qeshur tha:

-Por edhe nervat dhe ia nisi një serenate korçare. Në atë moment iu afrua gruaja dhe ne të gjithë u duartrokitëm. Si e mbaruan këngën mjeku tha:

-Kjo i përket fesë tjetër,por është gruaja ime dhe i ra kraharorit,ajo qeshi dhe e kapi për qafe.

Të mos ishte e nesërmja ditë pune,kush e dinë se deri kur do të vazhdonim në atë atmosferë aq të hareshme. Kur u ndamë u premtova se më kënaqësi i pranova thirrjet e tyre.

30. 07. 1974
Konstancë

Kafen e mëngjesit e pimë në oborrin e gjyshes;unë,xhaxhi Pandele gjyshja dhe nëna e Lazërit. Gjyshja më tha se dje kishin biseduar me Lazërin në telefon dhe fjalët e para,që kishin bërë kishin qenë pyetjet për mua se si ndihem në Konstancën e bukur dhe si ndihem në shoqërinë e re,pasi mosha nuk përputhet. Po ashtu më tha se me shëndet ka qenë mirë,por shumë i angazhuar në punë.

Nëna e Lazërit më pyeti si kishim kaluar mbrëmë te kushëriri i saj mjeku?! Ai tha është i mirë në zemër,por shumë shpejt hidhërohet dhe shumë kohë nuk donë të rri në shoqëri,më shumë kohën e kalon në lexim të literaturës profesionale.

Mua më kishin ngelur edhe tri orë kohë dhe duhej të nisesha me një grup të rinjsh,për në Bulgari. Prandaj iu luta nënës së Lazërit,që edhe njëherë të dëgjoja ekzekutimin e një melodi të bukur shqipe. Ajo me kënaqësi si sorkadhe u fut në dhomën e saj dhe për afër pesë minuta i hapi perdet e dritareve,por tash më e veshur me fustanin e saj borë të bardhë.

Ndarja ishte prekëse dhe e dhimbshme...

Unë dhe xhaxhi Pandele shkuam të vizitoj xhaminë e qytetit,që ishte për tu habitur se një vajzë kur ka qenë vetëm katër a pesë vjet ka filluar ta thurte qilimin që mbulonte tërë sipërfaqen e xhamisë,por edhe ai ciceroni në moshë aq të re i zotëronte shumë bukur disa gjuhë të botës,por edhe gjuhën shqipe. Hipa edhe në minaren e xhamisë që nuk ishte shumë e lart por shumë bukur shikohej një pjesë e Konstancës,që duke ecur në këmbë nuk mundej ta shikosh.

Xhaxhi Pandele më shoqëroi deri te stacioni i autobusëve,ku i tërë grupi priste minutat e fundit që të vinte autobusi dhe të niseshim në drejtim të kufirit Rumun-Bullgar. Xhaxhi Pandele më bleu edhe një byrek te byrektorja që ishte në afërsi të stacionit,ku të punësuarit ishin gati të tërë shqiptarë e në mesin e tyre edhe një shqiptar mysliman.

Si hipëm në autobus dhe udhëtuam disa minuta,që mos ftohej byreku fillova ta hajë,por letra që ishte i mbështjellë byreku ishte e yndyrshme,prandaj e hapa valixhen,që të merrja peshqirin,por brenda pash disa numra të ZËRIT TË POPULLIT,që i kishte futur xhaxhi Pandele,me të vërtetë kujdesi i tij më gëzoi shumë.

Udhëtimi nuk zgjati shumë dhe arritëm në kufi. Doganieri i cili hipi të na i kontrollonte pasaportat ishte një djalë i ri i moshës së Lazërit. Sa ia dhashë unë pasaportën ai e hapi e lexoi emrin më shikoi dhe më tha:

-Shqiptar nga Jugosllavia ashtu pastër në gjuhën shqipe. Iu përgjigja po shqiptar. Prej kurrë jam unë këtu në punë Ju jeni i vetmi shqiptar,që kalon kufirin dhe vazhdoi të bënte punën e vet. Sa bëri kontrollin u konsultua me një doganier tjetër dhe na thanë që të zbritnim. Kur zbritëm kufiri ishte i hapur dhe na dhanë shenjë se mundeshim të kalonim,mua doganieri shqiptar më dëshiroi udhëtim dhe pushim të këndshëm në “RËRAT E ARTA”.

Edhe bullgarët na pritën mirë dha sa i bënë kontrollimet na treguan se autobusi që ishte i parkuar aty afër ishte për ne dhe na kishte pritur afër një orë. Rruga ishte mjaft e ngushte dhe e prishur,herë i afrohej shumë detit herë largohej,që të bënte përshtypje të një toke të shkretë. Fshatrat të vogël,me shtëpi përdhese dhe mjaft të vjetra. Në disa fshatra pashë xhami dhe kisha të rrënuara,dëm i madh për atë shëmti bregdeti,që herë-herë,kur i afroheshim të freskonte pamja e detit azur.

Në Varnë arritëm shumë vonë. Unë hyra në agjenci për të kërkuar banesë,por dy vajzat e reja që punonin më thanë se ishte shumë vështirë në atë kohë të gjendej banesë,por do të kërkonin me anë të telefonit dhe filluan të kërkonin në regjistrat e tyre,që i kishin përpara. Unë u ula në njërën nga karriget që ishin aty dhe prisja,që sa më parë të shkojë të pushoj se isha shumë i lodhur prej udhëtimit nëpër atë rrugë gjarpërore. Pritja vazhdoi deri në orët e hershme të ditës së nesërme,kur një plakë u paraqit në derën e agjencisë dhe njëra nga vajzat më tha se plaka ka një krevat të lirë dhe po të doja mundesha të shkoj me të. Unë që kisha dremitur pak në karrigen e agjencisë as që më shkonte mendja të pyesja për çmimin dhe kushtet e banesës. E morra valixhen dhe u nisëm së bashku me plakën për në banesën e saj,që më kishte filluar të dukej dhe tek-tuk shiheshin njerës duke vrapuar për në punë të tyre,kurse pastruesit e rrugëve bënin punën e vet të përditshme.

31. 07. 1974
Varna

Kur u zgjova ora ishte dhjetë. Dola në oborr dhe u ula në një karrige që ishte nën hijen e një bliri mjaftë të moçëm. E vendova kokën në mes duarve dhe fillova të mendoj për Konstancën e bukur dhe ato njerëz të mrekullueshëm,që shumë shpejt u shoqëruam,por edhe për DITARIN,që se kisha prekur disa ditë me radhë. Prej mendimeve të pa fund më nxori një bullgar banues si unë nga një qytet në veri të Bullgarisë me emrin Ruse. Ai më përshëndeti dhe i tha një gruaje që të vendonte kafe edhe për mua. Unë si iu falënderova dhe i thash se do ta pijë me shumë oreks,u çova

dhe dola në rrugë ku përballë shtëpisë ku banoja kishte një shitore të vogël. Bleva një pako kafeje,zhilet për rroje një sapun dhe një kilogram sheqer. Kur u ktheva kafja ishte mbi tavolinë. Njëra nga gratë më afroi cigare,por unë i thash se nuk e pijë duhanin. Ajo tha diçka në gjuhën e vet,por unë se kuptova. Unë duke e pirë kafen ua lash paketën e kafes dhe kilogramin e sheqerit në tavolinë duke u thënë se është prej meje dhe e pyeta atë bullgarin a kishte aty afër ndonjë byrektore,apo diçka tjetër për ushqimin e mëngjesit. Ai filloi diçka të thotë,por nusja e shtëpisë doli prej një dhome me disa kilogram peshk të freskët dhe na tha se atë ditë jemi të thirrur te ajo për drekë dhe erdhi te unë të përshëndetet se deri atëherë s'ishim parë.

Unë me bullgarin i morëm plaçkat dhe u nisëm për në plazh,që s'ishte shumë larg,kurse të tjerët do të vinin pak më vonë,që unë akoma si njihja se kush me cilin ishin. Plazhi ishte i pastër dhe i rregulluar shumë mirë,por uji edhe në Varnë ishte i ftohtë si në Konstancë e jo si në bregdetin Adriatik.

Në banesë u kthyem aty nga ora gjashtëmbëdhjetë dhe u kënaqëm me peshkun e përgatitur në mënyrë të shkëlqyer. Unë dhe bullgari blemë disa litra verë. Pas darke apo dreke s'di si ti them unë rashë dhe kisha fjetur gjer në ora njëzetë e tridhjetë minuta.

Në tavernën e restorantit me shikim nga deti ndenjëm deri orës njëzetekatër në një ambient shumë të hareshëm. Aty më tregoi bullgari se të nesërmen do të largohej për në Ruse dhe me të qeshur më tha se të tërë shoqërinë ma lenë mua të kujdesëm,por edhe gruan e vet,që do të ngelte aty edhe tri ditë të tjera. Unë dorën në zemër as që e njihja mirë se cila ishte dhe a kisha shkëmbyer disa fjalë për aq kohë të shkurtër. Ajo qeshi duke thënë se sa do të kujdesesha unë për atë aq edhe ajo për mua dhe se është hera e parë për atë që ka parë dhe biseduar me një djalë shqiptar.

Pagesën e bëri bullgari,që nuk kushtoi shumë dhe u çuam se kishim një copë rruge deri në banesë,duke më thënë e shoqja e bullgarit se kafen që desha t'ua jap unë në restorant do ta piqte ajo në banesë,prej kafesë që e kisha blerë unë në mëngjes.

1. 08. 1974
Varna

Kur më doli gjumi ora ishte afër nëntë. U rrojta se s'isha rruar qysh ditët e fundit që isha në Konstancë. Kur dola në oborr gruaja e bullgarit më tha se kishte shkuar i shoqi,por na kanë erdh të tjerë,prindërit e asaj polonezes nga Krakovi,që vallëzonit mbrëmë,Madeja Zofisë. Unë u ula në një karrige,ajo hyri në dhomë që të bënte kafen e mëngjesit.

Unë gjer sa pritja kafen e mora një numër të Zërit të Popullit,nga ato që si kisha shfletuar që mi kishte futur në valixhe xhaxhi Pandeli dhe e hapa rastësisht te faqja ku xhaxhi ENVER ishte i fotografuar me një sheshir të madh tamam si kaubojt e Teksasit. U zhyta në lexim sa që nuk e kisha vërejt kur ma kishin sjellë kafen. Kur isha nga mesi i artikullit prej një dhome doli një njeri tamam zotëri. Më përshëndeti unë e shikova dhe e përshëndeta,pas tij doli një grua,po ashtu tamam damë perëndimi. U njoftuam,por më mirë më sqaroi në gjuhën bullgare Zofia,vajza e tyre një studente në Universitetin e Krakovit. Baba i saj u ul afër meje dhe sytë menjëherë i shkuan te fotografia e Xhaxhit ENVER. Pa mos u mendua dhe pa droje tha:

-Mirë ua bëri Rusëve,por prapë ngeli aty ku ishte,nuk bëri asnjë hap nga perëndimi. A keni qenë Ju në Shqipëri?! Unë i thash:

-Jo ne nuk guxojmë as të përmendim Shqipërinë,këto gazeta më ranë në dorë në Rumani,në Konstancë. Atëherë,preras më tha:

-Duhej të keni kujdes,se shkon edhe koka. Unë tha punoj në Komitetin e Partisë në Krakov,por dije se nuk jam aspak i kënaqur edhe pse jetojë mirë,ja kam edhe veturë perëndimi,kam edhe rrogë të majme,vajzën e kam studente. Ne në Poloni punojmë si të zitë,kurse rusët dhe gjermanët hanë dhe pinë si derra.

Biseda shkonte mirë edhe pse unë disa herë dyshoja,në fjalët e polakut dhe dëshiroja,që të ndërpritet biseda se u folën fjalë shumë politike dhe...Nga politika e pistë komuniste na nxori Zofia kur përpara nesh na i solli gotat e çajit dhe më tha se i kishte folur mjaft babait për mua,ndoshta do të më thoshte edhe fjalë të tjera,por prej te dera e dhomës së tyre nëna e saj më tha:

-Çaj special prej Polonie për rregullimin e temperaturës trupore. Unë iu falënderova,por dorën në zemër doja,që sa më parë të largohem dhe më kurrë mos takohem me atë njeri,që më bindi se ishte një komunist i madh me punën që bënë dhe po aq antikomunist me fjalët që mi tha. Pas çajit kur unë doja të ik,dama na solli edhe ushqimin e mëngjesit. Duke hëngër më vajti mendja te pasaporta dhe u ngrita duke u thënë se duhej të marr do hapa që i pi pas buke. Shkova në dhomë,pasaporta ishte në vendin ku e kisha venduar në palën e një këmishe. Po ashtu më vajti mendja,pse as në Rumani e as në Bullgari nuk bëhej paraqitja e turistëve si në bregdetin Adriatik. I mora hapat,që me të vërtetë i pija pas buke,për Astmën që më shoqëronte vite me radhë dhe u ktheva të vazhdoja me ushqimin,por edhe bisedën politike.

Plazhin e bëmë së bashku,biseda ishte e lirë dhe e larmishme. Unë më isha zhytur me fjalë në politikë,por edhe me vepër pasi polaku më takoi duke lexuar “Zërin e Popullit” por edhe polaku tha shumë fjalë antishtetërore. Pritja të më

kërkojë adresën,të mos ia epja dhe sa më shpejt të zhdukesha. Ai e njihte më mirë politikën Jugosllave se sa unë. Disa herë më foli për Kosovën dhe demonstratat e gjashtëdhjetetetës në Maqedoni. Unë i tregova se kam studiuar në Prishtinë. Edhe ai dikur pranoi se ato biseda ai kurrë s'do ti bënte me një serb,maqedon,bullgar,por jo edhe me shokun më të ngushtë të kombit të vet polak.

4. 08. 1974
Albena

Dje kaluam mirë në plazhin e RËRAVE TË ARTA. Në bisedë me babanë e Zofisë i tregova se para disa ditësh në plazh të Varnës kam biseduar me një bashkëvendës timin,shokun Hamit Mehmedin,inxhinier i punësuar në Kosovë,se ka një qytet me emrin Albena dhe se për çdo vit organizon një KARNEVAL dhe se nuk është shumë larg nga Varna. Ai më tha se nuk ka problem kur të donim mundemi të shkojmë,ta vizitojmë qytetin dhe pastaj do të vizitojmë edhe një manastir,që ndodhet në afërsi të Albenës. Mua vizita e manastirit më habiti për atë njeri me post të lart si komunist. Ai e vërejti habinë time dhe më tha:

-Unë jam nga Krakovi ne kemi priftërinj me grada të larta kishtare edhe PAPA është nga vendlindja ime. Unë nuk e zgjata më shumë,se u binda se do të plotësohej dëshira ime për të vizituar Albenën.

Babai i Zofisë ishte ngritur më herët e kishte larë dhe pastruar mirë veturën dhe aty nga ora tetë hyri në dhomën time,më pyeti si kam fjetur dhe më tha se nga ana e tij ishte çdo gjë gati dhe se priste që të përgatitemi dhe të nisemi në rrugë.

Nëpër rrugët e Albenës akoma shiheshin reklamat,dhe shumë fëmijë që ecnin me maska dhe gjurmë të tjera të Karnavalit. Ne si u lodhëm duke ecur u ulëm në tarracën e një restoranti të pushonim,por edhe të shuanim etjen e ditës me plotë rreze të arta dielli,siç thoshte babai i Zofisë. Aty bëmë disa fotografi,por vetëm me aparatin tim se akoma nuk kisha besim në një funksionar komunist,por edhe pasaportën e mbaja me vete.

U nisëm nëpër një rrugë të një mali mjaft të dendur dhe shkëmbinj të thepisur,që te unë sa që largoheshim nga qyteti aq më tepër shtohej dyshimi te funksionari polak. Dikur u ndalëm dhe babai i Zofisë më tha që të dilnim se aty në afërsi ndodhet një KATAKOMB. Zbritëm dhe sa dolëm prej veture,prej anës së poshtme pamë një grup vizitorësh,që kishin vizituar Katakombin. U afruam edhe ne,por mos kujdesi i shtetit dhe dhëmbi i kohës e kishte bërë të veten.

Vazhduam edhe pak me veturën dhe pastaj në këmbë, nëpër një rrugë aspak të përshtatshme nëpër do shkallë të hekurta deri sa u afruam që të vizitonim Manastirin e ALLABAXHINOVIT,krejt i futur në shkëmbin e thepisur. Unë pasi kisha fotografuar disa herë,e kisha bërë aparatin gati dhe shikoja me kujdes,atë polakun komunist,por edhe si fetar çka do të bënte kur do të hynte në manastir. Kur u afruam afër derës së hyrjes ai u KRYQËZUA,unë e fotografova,me qëllim që të kisha një dokument edhe unë kundër atij, ai priti gruan dhe vajzën e vet Zofinë dhe u tha që edhe ata të KRYQZOHESHIN. Aty disi u binda se polakët nuk janë adhurues të flaktë të KOMUNIZMIT,por forca është forcë,kurse unë prapë bëra edhe një fotografi në rast se do të më duhej dikur për dëshmi.

Unë besimin në komunistët e kisha humbur disa vit më parë,kur baba dhe disa fshatar më tregonin se krejt të zezat nëpër fshatrat i bënin ato dhe pastaj thoshin se i kanë bërë BALLISTËT. Siç thotë xha Biti; KOMUNISTËT të vrasin

natën e të qajnë ditën dhe sherrin ta bëjnë duke hëngër dhe pirë. Aty takova edhe turq e rom të cilëve shteti Bullgar ua kishte ndërruar emrat dhe mbiemrat dhe ishin shumë të revoltuar.

Përpara se do të shkonim të hanim darkë vizituam Muzeun "AKVARIUM", të Varnës,që më la shumë përshtypje. Darkën e hëngrëm në një restorant në qendër të qytetit me muzikë,këngë,valle dhe vallëzim deri në mëngjes.

8. 08. 1974
Varna

Sot është dita e fundit e pushimit në detin bullgar,por edhe me shoqërinë e rastit të kësaj vere,që i pata të shumta. Gabriella dhe Nikollai shkuan që herët në mëngjes,unë do të shkoj në mbrëmje me tren deri në Sofje,pasi nuk kishte bileta aeroplani. Polonezi me familjen do të rri edhe nja dy tri ditë,siç më tha do të varet prej kohës,por më shumë prej shoqërisë,se kush do të vijë të banojë pas nesh në këtë banesë.

Tërë ditën e kaluam në plazh edhe meqenëse unë nuk ndihesha mirë prej të ftohurit,që e përfitova ditët e fundit. Edha hapat kundër të ftohurit s'ndihmojnë,e as pikat për në hundë,gripi është grip dhe e bënë të veten aq sa e ka kohën. Babai i Zofisë disa herë më ka thënë,por edhe sot i tha fjalët:

-Kurrë mos tu besosh komunistëve,e sidomos KOMUNISTËVE ORTODOKS-SLLAV. Ato ta bëjnë sherrin duke hëngër e duke pirë bile edhe për asgjë. Edhe ky mi përsëriti fjalët e dikurshme të xha Bitit,që ishte bindur kur ka punuar në Beograd. Kini kujdes me gazetat shqiptare. Unë iu falënderova për këshillat.

Drekën e hëngrëm së bashku te restoranti"ZOGU I ART". Ndenjëm afër dy orë,në një ambient shumë miqësor

dhe komod. Duke u kërkuar falje u thash se unë do të dal,që të blejë ndonjë dhuratë për motrën dhe prindërit dhe do të pushoj gjer në orën njëzet,por nëse nuk zgjohem,ju lus që të më zgjoni se do të më iki treni. U dakorduan,unë u çova ata ngelën aty,që pas pak kohe të vazhdonin me plazhin.

Eca nëpër dyqanet e Varnës afër një orë dhe bleva disa parfume. Kur arrita në banesë Zofia lexonte romanin,që e kishte filluar përpara disa ditësh dhe përpara saj kishte një pako të vogël,të mbështjellë shumë bukur. Sa më pa qeshi dhe ma dha pakon,unë iu falënderova dhe hyra në dhomë. I vendova në valixhe gjërat e blera dhe hyra të bëja banjë.

Në ora njëzetenjë e tridhjetë minuta ishim te stacioni i trenit. Unë vajta të pres biletën,kurse familja polake u ul te restoranti i stacionit. Çmimi i biletës ishte shumë i lirë,por kur më hetuan se jam i huaj,më kërkuan vërtetim që kam këmbyer deviza për leva. Unë ata nuk i ruaja,por aty i këmbeve edhe njëzet marka dhe krejt ishte në rregull. Kërkova vend në vagonin e fjetjes,por më thanë se atë do ta kërkoj prej konduktorit. U ktheva te restoranti ku më priste familja polake,që tërë kohës kishin një sjellje mjaft korrekte ndaj meje,por kuptohej edhe unë ndaj tyre. Si pimë kafetë u përshëndetëm si miq të vjetër dhe unë u afrova te treni që edhe pak do të nisej,kurse babai i Zofisë përherë të fundit më porositi të kem kujdes me gazetat,e veçanërisht me atë ku është fotografia e SHOKUT ENVER HOXHA,armikut numër një të TITOS.

Në kupenë e klasës së parë isha unë,një kubanes dhe tri kubane,por një kupe afër nesh ishte krejtësisht i lirë dhe konduktori na tha se po të dëshironim mundemi ta shfrytëzojmë,por do të duhej diçka të paguanim,që ne u pajtuam me kërkesën e konduktorit. Të gjithë e zotonin gjuhën bullgare,se disa vite me radhë kishin bërë praktikën nëpër agjencitë e Bullgarisë. Bisedonim për shumë tema të ndryshme,por edhe ata ishin shumë të rezervuar dhe të

kujdesshëm,siç jemi edhe ne të vendeve komuniste. Udhëtimi zgjati deri në mëngjes,kur u përshëndetëm dhe u ndamë secili në rrugë të vet,për tu takuar ndonjëherë tjetër...?!

9. 08. 1974
Sofje

Te stacioni i Jugosllavisë më thanë se për tri ditët e fundit nuk ka bileta autobusi. Aty kishte edhe tre maqedonas nga Shkupi,që kërkonin bileta,por më kot bileta shitësi na e mbylli sportelin dhe filloi të pijë kafenë,duke mos e lodhur kokën për hallin tonë. Unë i thash taksistit,që më pruri nga stacioni i trenit,të na çonte deri në Shkup,por ai më tha se s'mundej pasi nuk do ta lëshonin në kufi. Me të njëjtin taksist u ktheva te stacioni i trenit,por tash te ai në jug.

E preva biletën për në ora dymbëdhjetë e dyzetë minuta. E lash valixhen në gardërobë dhe dola nëpër rrugët e Sofjes,që ajo pjesë më dukej tamam si një fshat i shkapërderdhur. U ula në një restorant,që të pushoj trupin e lodhur nga udhëtimet e gjata,por edhe nga gripi,që ditët e fundit më lodhi së tepërmi.

Pak përpara se nisej treni arrita e mora valixhen prej gardërobës dhe hipa në trenin që për pak kohë do të nisej në drejtim të Nishit. E hapa valixhen i nxora gazetat e shtetit tim SHQIPTAR,që kurrë se kisha vizituar dhe shumë herë e ëndërroja,u hodha edhe një sy faqe më faqe dhe si lexova edhe njëherë të gjitha titujt e hapa dritaren me lotët,që më rrokulliseshin nëpër faqe i hodha duke nëmur ata që na ndanë në disa shtete dhe për një fjalë goje,një gazetë apo libër nga SHQIPËRIA kalonin shumë vite nëpër kazamatet e Jugosllavisë së SATRAPIT Tito.

Plaku i ulur përballë meje i vetmi në të njëjtin kupe,më shikonte me një habi të pa përshkruar. Dikur më foli në gjuhën turke,por unë i thash se s'kuptoj,jam shqiptar nga Jugosllavia. Ai më shikoi edhe pak dhe në gjuhën time më tha:

-Biri im edhe unë kam qenë nga Jugosllavia,Kosova ime e dashur,por prej regjimit Titist,kam shkuar në Turqi,qysh prej pesëdhjetepestës dhe tash kthehem të takohem me të afërmit e mijë në Kosovën time. Të vizitoj varrin e vëllait që më ka vdekur prej para pesë vitesh,por edhe shumë të tjerë,por me siguri kanë lindur disa herë më shumë. Tash lotët e mijë ishin tharë nëpër faqe,por lotët e plakut arrinin deri te mjekra e tij e dendur dhe prej ngjyrave të saja shikohej se ishte shumë e munduar. Më pyeti pse i hodha gazetat dhe u mërzita aq shumë. I tregova fill e për pe,për historinë e gazetave. Atëherë plakut nëpër faqe iu rrokullisën edhe një lumë lotësh dhe filloi të më tregojë,për xhandarët serb si i kanë bërë baskun dhe i kanë gjetur flamurin e dashur,një revole dhe disa libra. Vëllai i tij ka shkuar në burg,kurse atij,për pare një mik serb për disa ditë ia ka bërë dokumentet për në Turqi. Bisedën na e ndërpreu konduktori,që për të dytën herë hyri për të kontrolluar biletat dhe na solli edhe tri udhëtare që udhëtonin deri në afërsi të kufirit.

Doganierët bullgarë bënë punën e tyre dhe na dëshiruan rrugë të mbarë,kurse ato serb në fillim u sollën mirë,por kur panë në pasaportën time aq shumë vule disi u hutuan dhe më kërkuan valixhet. Unë thash se kam vetëm një valixhe se nuk kam qenë në kurbet,por në pushimin veror. E zbrita valixhen dhe e hapa,njëri më pyeti çfarë kam,i thash se tesha të pa lara dhe fillova ti nxirrja,por ai me një ton prej idioti më tha edhe më ashpër:

-Shpejto dhe nxirri të gjitha,a nuk kemi ne det,por të harxhosh aq shumë para në vende të huaja?! Unë vazhdova të nxjerr tesha e pa lara dhe më vajti mendja te ai polaku

komunist,mos ka dërdëllitur diçka! Kurse njëri nga policët e hapi një fletore dhe kërkonte me siguri emrin tim të shënuar në listën e zezë. Më shikoi mua edhe një herë dhe i tha kolegut të vet:

-Lere rehat është i ri ka harxhuar paratë e veta,për qejfin e vet. Ma hodhi si me inat pasaportën dhe e mbylli derën. Plaku pa mos e ngritur kokën tha:

-Qenë kanë qenë dhe qenë kanë ngelur. Ishalla nuk u shkon edhe shumë gjatë...

Kur arritëm në Nish treni i cili duhej të vinte prej Beogradi për në Shkup sa s'kishte arritur dhe plaku tha se do të vazhdonte udhëtimin me mua deri në Shkup e pastaj për në Prishtinë. Aty e bleva biletën e fundit të udhëtimit maratonik të ati pushimi veror,dhe ndoshta do të ishte i fundit dhe motrës dhe prindërve do tu plotësohej dëshira për martesën time,që më kishte lërë shumë kujtime të mira,por edhe të këqija,që për atë kohë duhej të adaptohesha me disa kombe të botës,duke menduar për njërin nga filmat,me plotë kujtime dhe panorama të bukura në Konstancën piktoreske dhe shqiptarët e mijë të dashur të tri feve mjeshtri bullgar ma humbi apo ma fshehu me qëllim,ose ishte urdhër i dikujt nuk e di në Varrnën e bukur...

22. 03. 1975
Kërçovë

Zilja për mbarimin e orës ra fiks në ora nëndë e dyzetepesë minuta. E hapa derën e klasës dhe u drejova në drejtim të shkallëve që të leja regjistrin,por në atë moment e pashë një koleg dhe ia dhash atij regjistrin dhe u lëshova shkallëve teposht për të arritë sa më parë te udhëkryqi,për të hipur në autobusin në drejtim të Shkupit. Me siguri pas kilometrit të parë i mbylla sytë dhe fillova të meditoj për momentet e jetës së kaluar. Mu kujtua se si baba,por edhe nëna me motrën disa herë më thonë,që të martohem. Disa herë përpara më doli ai shoku i klasës me djalin duke ecur nëpër rrugët e fshatit. S'di pse mu kujtuan edhe fjalët e atij plakut të fshatit,që disa herë më ka pyetur; "Ku kërkoj NUSE që ai të më ndihmojë,edhe pse unë disa herë i kam thënë,se do të martohem kur të vie koha,por me siguri se nuk pres të më martojë plaku i katundit,apo...".

Si mora të dyja ineksijonet kundër alergjisë së pluhurit të shtëpisë dhe polenit,siç i kisha marrë muajë me rradhë,dola në koridor shikova djathtas-majtas dhe s' si mu kujtua të bëja një bisedë me profesorin e nderuar të klinikës. Aty për aty vendosa që të shkoj te zyra e tij. Kur kisha edhe tre a katër hapa profesori e hapi derën dhe me të ngut e vëndoi çelsin te brava e derës,por edhe mua më shikoi,unë si e përshëndeta i thash se desha të bisedoja me te,por nëse ai ka kohë ti ndaj nja pesë minuta. Profesori më tha se me kënaqësi,por pas njëzet minutash,pasi ka një konsultim me disa studentë. I thash se unë kam kohë dhe do ta pres përpara kabinetit të tij.

Si hapi derën më dha dha shenjë që të hyja. Ai u ul mori frymë thellë dhe lëshoi një rrënkim të dhimshëm. Si më shikoi edhe njëherë më tha që të ulesha te karrigëja që ndodhej përballë tij. Pastaj e thirri motrën medicinale dhe i kërkoi disa tableta,të cilat i piu përpara meje. Si pushoi edhe dy a tri minuta pa mos më shikuar më tha:

-Urdhëroni tregoni për hallet që keni?! I thash se jam pacient i tij dhe kolegëve të tij. Shurt më tha:

-E dij. I thash se vuaj nga Astma e dhe për te më tha se e din. I thash se jam shqiptar,edhe për këte shkurt më tha:

-Edhe ate e di. Por se më jam në moshë dhe shokët e mi të klasës janë martuar dhe shumica kanë edhe fëmijë,se edhe unë duhej të bëjë rendet e jetës. Profesori i nderuar,qeshi dhe tha:

-Edhe ata që thatë i di dhe është normale që edhe ju si krejt ne të bëni rendet e jetës. Unë si mora frymë thellë i thash:

-Profesor ç'do të bëjë Astma me fëmijët e mi,po të mi japi Zoti?! Në atë moment profesori më shikoi u mendua pak dhe më tha:

-Këtë pyetje se kam pritur,por si do qoftë unë të falenderohem,për guximin dhe respektin ndaj meje. Shikoni tha:unë jam gati me titull më të lart shkencor. Për trashigimin e Astmës nga ti, te fëmijët e tu unë nuk mundem të them,as po e as jo. Unë vet vuaj edhe nga Astma e jote,por edhe nga disa smundje të tjera. Në këtë kohë nëse dikush nuk vun nga një sëmundje,ose është fenomen i kohës,ose është totall budall. Unë për veten time dij se s' jam as njëri e as tjetri,por besoj se edhe ju nuk jeni as fenomen i kësaj kohe e as totall budall. Unë prap të falenderohem për besimin,por edhe për këtë bisedë disa minutëshe. Pasi më pyetët për këshillë,unë do të them,ate që ju do të keni nevojë për tërë jetën. Ajo është që të keni njeri afër,që do të mundet tu japi ndihmën e parë edhe ate

në çdo kohë. Nga unë kaq...Unë si iu falenderova u nisa drejt ardhmërisë...

* * *

4 . 11 . 1975
Zhubrinë

Vonë në mbrëmje Zhubrinës iu shtua edhe një banorë,nuse,por jo si ata përpara sajë me vetura dhe qerre kuajsh,apo qesh të stolisura,por as edhe si nuset e para sajë të veshura me fustane nusërie,dimi,apo këmisha nusërie të vejura në tullar,me plotë stolira,me këngë,valle bile edhe tupana. Kjo ishte një nuse e veshur si çdo ditë kur nëna e përcillte,me pantallona,pallto me një çantë të vjetëruar,dhuratë nga njëra nga motrat e saja të martuara në punë ku punonte në ambullantën e një fshati në afërsi të qytetit të lindjes, Tetovës.

Në dhomë isha unë,gruaja ime,nusja që familjarët e mi e pritnin një kohë bukur të gjatë,motra dhe nusja e vëllaut të madh. Dikush i tregon babës që me disa shokë kishte pirë një lëng te shitorja e fshatit,dhe pa frymë erdhi në shtëpi dhe drejt e në dhomën tonë,kurse pas tij edhe nëna,që në guzhinë kishte filluar të bënte diçka për të hëngër. Sa hapi derën më shikoi dhe u lëshua në drejtim të nuses,duke ia shtri dorën i tha:

-Mirë se erdhët moj mij bijë në shtëpinë tonë. Dhe u step duke më shikuar mua, më dha shenjë që ta dalë me te përjashta. Më përqafoi puthi dhe uroi gjithë të mirat,në jetë.

Pas disa ditësh në fshat u harxhua aq alkoohol sa ndoshta nuk ishte harxhuar për një vit të tërë,bile konsumuan edhe disa që kurrë raki s’kishin futur në gojë gjatë jetës së tyre. Edhe urimet vazhduan së pari nga nxënësit ku isha kujdestar klase e pastaj edhe të tjerët,që zgjati disa ditë me rradhë...

Unë fillova të mbush albumin e rinj,duke i hekur disa nga albumi i vjetër,që prushi i kaftorit në mes të dhomës dha një flakë,që për pak do të pëlciste.

18. 07. 1990
Kërçovë

Disa vite me radhë së bashku me gruan dhe fëmijët,pushimet verore i kemi kaluar në bregdetin e Malit të Zi,por edhe të Kroacisë. Disa muaj më parë i thash gruas se këtë vit mendoj që pushimet verore ti kalojmë në bregdetin e Greqisë edhe atë në plazhin e qytetit të Pargës dhe të Prevezës. Ajo pohoi me kokë se është dakord,kurse fëmijët akoma janë të vegjël dhe nuk bëjnë probleme.

Disa ditë më parë e kishim caktuar datën e nisjes,pasi një ditë më parë gruaja e merrte pushimin vjetor,por edhe mua vllahu im Esati ku punoja me honorar si pensionist i parakohshëm më kishte thënë se pushimin mundesha ta marr kur të doja. Si ia sqarova vëllahut drejtimin e udhëtimit,ai më tha se relacioni është tepër i gjatë,kurse fëmijët akoma janë të vegjël,veçanërisht më tha për Yllëzën,që akoma është bebe,por unë kisha vendosur. Ai më tha se gjer në kufi me Greqinë,Florinë do të më çonte ai me veturë,kurse unë prej aty i thash do të merrja taksin,ose me autobus,gjer në Pargë.

* * *

Në ora tetë ishim në kufi me Greqinë,ne sa u afruam një veturë me targa të Shkupit u kthye dhe na tha se po të mos kishim nga njëmijë marka gjermane për person nuk ka shans të kalonim kufirin. Unë kisha mjaft para,por aq sa kërkonin grekët jo. Sidoqoftë unë i thash vëllait se do të afrohem,por ai

të më pret deri sa unë të kaloj kufirin ose kthehem prapë. Ai ra dakord dhe unë me fëmijët,gruan dhe valixhet në dorë u afruam te doganieri dhe ia dhashë pasaportat,ai shikoi dhe më pyeti për para,unë i thash se kam për njëzet ditë,por po ti harxhoj do të kthehem më parë edhe dhjetë ditë pushin në bregdetin e tyre të bukur janë të mjaftueshme,ai qeshi i vulosi pasaportat dhe më uroi rrugë të mbarë,me një shqipe mjaftë melodike. Unë iu falënderova duke i thënë se do të shkoj atje ku flitet shqip.

S'di a prej diellit që nxehte,apo prej suksesit që pata u bëra qull në djersë. Dola atje prej ku mundesha ta shikoj vëllahun dhe i dhashë shenjë me dorë se krejt ishte në rregull.

Taksi që priste ishte i qytetit të Kozanit,sa i thash se shkoj në drejtim të Pargës,ai më dha shenjë se është i lirë dhe i hapi dyert dhe bagazhin,për të venduar valixhet. Rrugës më tregoi se udhëtimi do të më kushtonte më lirë se sa me autobus,se prej Kozani e deri në kufi ka sjellë do gjerman dhe e kanë paguar shumë mirë. Dhe do të vozis pak më shpejt që të arrijmë autobusin,që shkon direkt nga Kozani për në Parga.

Sa ia bëra pagesën taksistit hyra në rend që të marrë biletat e autobusit,që kishte edhe shumë pak kohë dhe duhej të nisej. Gruaja i kishte venduar valixhet dhe me fëmijët më pritnin afër derës së autobusit. Ne sa bëheshim gati të hipim taksisti erdhi me një qeskë najloni,plot me ushqime dhe pije freskuese. Unë nxora para,por ai tha se janë prej tij,iu falënderova dhe ia ktheva një koka kolë,se unë derisa kisha prerë biletat gruaja kishte blerë disa pije dhe do të na nxeheshin në autobus. Edhe ai u falënderua dhe edhe njëherë na uroi pushime të këndshme në bregdetin e tyre.

Kur arritëm në Pargë dielli edhe pak do të perëndonte,kurse prej plazhe ktheheshin vizitorët e shumtë. Për të gjetur banesë nuk humbëm shumë kohë, pronarja na tha se ishim shumë afër plazhit të VALTOSIT. Bëmë banjë dhe gruaja vendoi të hanim prej asaj që kishte ngelur prej rrugës

dhe fëmijët sa hëngrën i mori një gjumë mjaft i ëmbël,kurse unë dola nëpër rrugët e Pargës së bukur ,por edhe të shikoja plazhin për ditën e nesërme...

19. 07. 1990
Parga

Si unë me gruan,po ashtu edhe tri vajzat tona kishim fjetur tërë natën dhe në mëngjesin e kësaj dite ishim mjaft të freskët dhe plot kondicion,për të dalë në plazh edhe atë sa më parë. Unë qysh në mbrëmje e kisha hulumtuar terrenin,unë deri sa bleve ushqimin e mëngjesit,gruaja me fëmijët kishin hipur lart dhe pritnin,që të arrijë unë dhe të lëshoheshim shkallëve të plazhit të VALTOSIT. Aty afër shkallëve te shitorja kolonial kishin hyrë të tria vajzat dhe kishin blerë AEROKREMIN,që e adhurojnë së tepërmi. Ata duke biseduar u afrohet pronarja e shitores një plakë shumë pedante dhe u flet në gjuhën e jonë SHQIPE. Dy vajzat e mëdha habiten,kurse Yllëza e vogël i kishte thënë; NANA. Me të tria vajzat plaka doli përjashta dhe na u afrua neve. Na përshëndeti dhe na pyeti mos jemi nga SHQIPËRIA?! Unë i thash jo,jemi nga Maqedonia. Na thirri në kafe,por ne i thamë se sa kishim pirë,që ishte e vërtetë. Atëherë na tha rrugë të mbarë,kafen do ta pimë kur të ktheheni dhe u nis nga shkallët duke e mbajtur Yllëzën për dore. Te shkallët u përshëndetëm dhe filluam të zbresim,por të tria vajzat shumë herë e kthyen kokën që të shikonin plakën atje lart te shkallët,kurse Yllëza edhe disa herë tha:nana, nana...

Në skaj të plazhit kishte një dru me një hije të trashë dhe aty afër restoranti,që përherë kishte ujë të ftohtë akull. I lamë plaçkat shkuam te deti i lamë e shpërlamë duart ecëm

pak lart e poshtë dhe u afruam,që të hanim mëngjesin. Koha ishte shumë e bukur dhe deti me pak valë. Duke hëngër Gëzimja vajza më e madhja më pyeti:

-Babi si e quajnë këtë plazh ku jemi ne. Unë prej në mbrëmje e dija,por prej fjalëve të pronares së shitores u vërtetova saktësisht dhe i thash Gëzimes se quhet VALTOS,ajo as një as dy,por tha:

-Mirë babi ne këtë vend do ta quajmë VALËT TONA,ndoshta dikur ashtu është quajtur.

Ja shikoni si vinë VALËT TONA...?! Ndoshta babi ti për këtë arsye e ke pagëzuar këtë libër me vjersha"VALËT E GURRËS",dhe e drejtoi gishtin nga valixhja ku ishte libri. Unë qesha,por u habita nga mendimi aq filozofik i një fëmije.

Sa hëngrëm mëngjesin të tria vajzat u çuan dhe u drejtuan në drejtim të detit me ujin aq të pastër dhe të ngrohtë. Mami me Gëzimen dhe Teutën u futën pak më thellë,kurse unë me Yllëzën aty më në skaj ku mundohesha ta mësoja not. Teuta na u afrua dhe tha:

-YLLËZA NOTON SI PATË.

Sa dolëm prej detit u rrezitëm pak dhe hymë nën hijen e lisit,siç e pagëzuam, drurin e moçëm. Unë i frymëzuar prej fjalëve të Teutës e mora lapsin dhe fillova të shkruaj vjershën:

YLLËZA NOTON SI PATË

Këtu në VALLTOS
Zalli shndrit si ar
Prej shumë vendeve të botës
Kanë ardhur për tu larë.

YLLËZA NOTON SI PATË
Mbi të kalon një parashutë
Fluturojnë do çupa-
Motrat e saja:Gëzime e Teutë.

Me litarin e gjatë
I tërheq një varkë
Në plazhin e bukur
Të qytetit PARGË.

Qysh atë ditë Gëzimja dhe Teuta e lexuan disa herë dhe e mësuan për mendsh dhe filluan ta recitojnë,duke më thënë se u pëlqente shumë.

Dielli na perëndoi kur kishim edhe disa shkallë dhe arrinim te shitorja e NËNËS siç i mbeti emri pronares së shitores,që akoma ishte nën ombrellën e diellit. Sa na pa u çua më këmbë dhe tha menjëherë do ta vendonte xhezven e kafes se edhe ajo s'kishte pirë duke na pritur neve. Duke e pirë kafen shkëmbyem shumë mendime,në lami të ndryshme e veçanërisht të politikës. U binda se NANA ishte shumë e revoltuar prej grekëve të tërbuar...

20. 07. 1990
Parga

Kafen gruaja ma solli te krevati,si përherë në shtëpi gati prej kur jemi martuar dhe ajo u punësua në ÇERDHEN E FËMIJËVE në Kërçovë. E pyeta pse aq herët nuk jemi në shtëpi,jemi në pushim ajo qeshi dhe i mori teshat e palara dhe shkoi në banjë për ti njomur. Unë sa lava sytë,kur u ktheva hyra në dhomën e vajzave edhe ata ishin zgjuar tamam në ora gjashtë si në shtëpi. Sa e piva kafen e mora romanin VËLLEZËRIT KARAMAZOV të F. Dostojevskit dhe fillova të lexoj aty ku kisha ngelur ditë më parë. Gëzimja hyri ngadalë në dhomën tonë dhe kërkoi valixhen ku i kishin të venduar librat që do të lexonin gjatë pushimit. E hapi valixhen dhe mori romanin MALËSORJA të Nazmi Rrahmanit dhe prapë ngadalë pa zhurmë shkoi në dhomën e tyre.

Unë lexova disa faqe edhe pse në mendje filloi të më sillet ajo biseda me Nënën aty në afërsi të shitores nën ombrellën e diellit duke pirë kafen plotë shije kombëtare. E lash romanin i mbylla sytë dhe fillova të meditoj për atë që biseduam dhe që pash gjatë rrugës e veçanërisht në Konicë mbiemrin e Faikut tonë të madh. Këto mendime s’mundja ti largoj prej mendje deri atëherë kur nën hijen e lisit plak e shkrova poezinë:

K O N I C A

Konicë-
O qytet i munduar
Ç' ka bërë vallë me ty koha
Të vetmen xhami ta ka dërmuar.

E vetmuar aty në kep
Si fëmija pa nënë
K O N I C Ë-
Grusht të fort të kanë dhënë?!

Edhe emrat i shkruan
Me alfabet grek
Anatemë merr fëmija
Pa lindur në djep.

Pastaj edhe qortime
Para se shkon në shkollë
Hidhe atë që të thonë
Mëndët të jenë më të hollë...?!

Edhe aq më shumë më helmoi në këto ditë pushimi vajza që shiste VAJ ULLIRI,pushuesve të shumtë. Kur u afrua te ne,ajo si me të gjithë filloi të na foli dhe sqarojë të mirat e vajit të ullirit,në gjuhën greke. Teuta vajza e dytë e jona,që edhe pak do të bëhej nxënëse e shkollës së mesme i tha:

-Ti mirë bluan,por ne s'të kuptojmë. Vajza me shishen në dorë u step ndenji pak dhe tha:

-Ju s' më kuptoni,por unë u kuptova. Ia filluam bisedës,por mua në zemër mu shtuan të therurat,nga ajo që dëgjoja. Më tregoi për RRAPIN E POSHTËM dhe RRAPIN E EPËRM,por edhe për KALANË E DJALIT TË ALI PASHË TEPELENËS dhe shumë vende të tjera,ku janë masakruar shqiptarët dhe janë dëbuar nga trojet e veta mijëvjeçare. Për ato informata unë s'dija si ta shpërblej përveç me ujin e ftohtë të restorantit,që e kishim vetëm disa metra larg lisit,dhe kafen që e përgatiti Gëzimja dhe ti dhuroja një libër timin për fëmijë"VALË E GURRËS".E mori në dorë e lexoi titullin e puthi dhe tha:

-Për herë të parë në jetën time kam në dorë libër në gjuhën e nënës dhe dy pika lot iu rrokullisën nëpër faqe. Shikoi rreth e rrotull e mbështolli me një qeskë të najlonit dhe e futi në fund të koshit të vogël,ku i kishte të venduar shishet e vajit të ullirit. U çua për të vazhduar punën e ditës,që të siguronte kafshatën e bukës,por edhe pak dhrahmi për të vazhduar shkollimin në vjeshtë,por më si studente në qytetin e Selanikut.

Unë me gruan dhe tri vajzat filluam të komentonim bisedat,që kishim dëgjuar ato pak ditë në qytetin e bukur të Pargës dhe shqiptarëve të aq vuajtur në shtetin Grek,që ua kalon disa herë me sjelljet aq brutale republikave në Jugosllavinë e TITOS...???!!!

23. 07. 1990
Rrap i Epërm

Edhe dje edhe pardje isha në fshatin RRAP I EPËRM,takova shumë shqiptarë,pasi grek as që kishte,sepse jeta është shumë e vështirë,por infrastruktura është në rregull falënderuar BAZAVE USHTARAKE. Kohën më tepër e

kalova te kafeneja e vëllezërve me mbiemrin LEKA,por njëri e kishte LEKAS,ashtu siç na i kanë venduar edhe neve maqedonasit prapashtesën ‘SKI’ dhe serbët “VIQ”,ashtu grekët shqiptarëve të vet ua kanë venduar prapashtesën ‘AS’. Në bisedë i thash njërit vëlla,që mbante edhe një shitore kolonial dhe në firmën e vet e kishte atë prapashtesë asimiluese,ai mrroli krahët kurse ai që se kishte atë prapashtesë i tha:

-Ose ta heqësh atë siç kanë vepruar shqiptarët e Maqedonisë,unë por edhe ato të Kosovës,ose unë ta... “AS”-in e nënës.

Sot në orët e pas ditës rastësisht në plazh takova dy shqiptar me familjet nga Presheva dhe Shkupi;z. Behxhetin dhe z. Ruzhdiun.

Tërë pas ditën e kaluam së bashku në rërën e ngrohtë të Valtosit,ashtu siç ishte edhe biseda. U tregova për ditët e kaluara dhe vuajtjet e shqiptarëve nga grekërit e fëlliqtë siç i quanin shumë shqiptarë,që kisha takuar deri në ato momente. Për të nesërmen e lamë që nga ora tetë të shkonim të vizitonim kalanë e djalit të Ali pashë Tepelenës,që ndodhet atje lart mbi Rrap të Poshtëm dhe pastaj të shkonim në Rrap të Epërm siç i thërrisnin shqiptarët se grekët i kishin pagëzuar me fjalë të tyre greke,ashtu siç na i kanë ndaluar me ligj neve maqedonasit ti thërrasim qytetet tona në Maqedoni, si p.sh. Kërçovën time Kiçevo, Manastirin Bitolla, Shkupin Skopje, Tetovën Tetovo dhe ashtu me radhë.

24. 07. 1990
Parga

Fiks në ora tetë unë i prisja në afërsi të kishës së qytetit. Ato nuk u vonuan më shumë se tre minuta,që do të thotë se janë adaptuar në saktësinë e perëndimit,pasi disa vite me radhë punojnë në Zvicër.

Z. Bexheti e kishte marrë veturën e vet "OPEL OMEGA",që siç tha e kishte blerë përpara disa muajsh direkt prej fabrike,pasi punojnë burrë e grua dhe shumë harxhime nuk kanë pasur,fëmijë akoma nuk kishin,por ishin shumë më të rinj se unë dhe z. Ruzhdiu,që kishte gjashtë vajza. Kafenë e mëngjesit e pimë jashtë Pargës në një motel mjaftë luksoz. Në realitet për mua ishte kafja e dytë,por s'prishte punë.

Aty nga ora dhjetë ishim në Rrap të Poshtëm,u ndalëm nën hijen e një RRAPI mijëvjeçar,që shumë afër ishin varrezat e fshatit. U afruam te disa varre,por s'kuptonim asnjë fjalë. Unë u afrova edhe te kisha,që ishte e vogël dhe shumë e vjetër.

U nisëm rrugës së asfaltuar,por te shtëpia e fundit,që ndërtohej dhe akoma nuk ishte e mbuluar asfalti mbaronte,por edhe rruga mbyllej. Rruga ishte aq e ngushtë,sa që duhej të hynim në oborrin e shtëpisë që ndërtohej. Dolëm të tre prej veture,që të shikonim terrenin dhe në atë moment prej katit të parë,që ishte i adaptuar për banim doli një burrë zotëri. Unë e përshëndeta në gjuhën shqipe,ai më shikoi dhe mu përgjigj në gjuhën greke se s'kuptonte gjuhën që e flisja unë. Unë e përshëndeta prapë,por shqip,kurse ai për inat na thoshte:

-Ohi katallavene.. Dikur zotëri Bexheti u hidhërua, shahu hipi në veturë dhe me shpejtësi u kthye pas me veturën dhe i ra kazanit,që ishte i mbushur me ujë me siguri për të

mbaruar llaç. Kazani u dëmtua dhe uji filloi të rrjedh,pak u dëmtua edhe vetura. Pronari kur pa si rridhte uji prej kazanit bërtiti:

-Ooo ma dëmtove KAZANIN,që e kam amanet prej babës së babës,por tash në gjuhën e pastër SHQIPE. Atëherë unë i thash:

-Pse zotëri nuk flisje shqip,por fole si u hidhërove për kazanin. Ai me inat tha:

-Ju jeni MUTAT (agjentët e Athinës)?! Unë i thash po, ne jemi agjentët(MUTAT) të Athinës dhe u tërhoqa pak,aty pas shtëpisë pash veturën e pronarit të shtëpisë me targa të Zvicrës. I tregova z. Bexhetit,u afrua afër meje dhe e pa veturën dhe e njehi se prej kujt Kantoni ishte dhe i foli në gjuhën gjermane,por edhe shqiptari i Rrapit të Poshtëm i pa targat e veturës së z. Bexhetit dhe e ndryshoi mendimin u afrua u përshëndetëm,kërkoi edhe falje dhe ashtu ia filluan bisedës, kurse nëpër faqet e tija filluan të rrokullisen djersët,por edhe lot dhe bërtiti:

-Grua sjell ujë të ftohtë(unë thash krio nero)dhe atë shishen e rakisë dhe mu drejtua mua:

-Pash Zotin mos e fol atë gjuhë m...!

Nën hijen e pemës që ndodhej në afërsi të shtëpisë me ujin e ftohtë dhe bisedën e ngrohtë vëllazërore kaluam afër dy orë të tëra. Përpara se ndaheshim na tha:

-Falë terrenit jo të përshtatshëm kemi ngelur në vendin e lindjes,përndryshe do të na derdhnin;edhe andej edhe këndej dhe do të humbnim si kripa në ujë. Në ndarje i shtrënguam dorën njëri tjetrit,kurse unë i dhashë një ABETARE dhe librin tim Valët e Gurrës.

Aty nga ora katërmbëdhjetë ishim në kafenenë e vëllezërve Leka. Duke pirë kafe dhe biseduar me postierin e fshatit,i cili shumë i pezmatuar në shtetin Grek,dëgjuam një melodi klarinete dhe këngë toske. Dikush nga të pranishmit tha:

-Po vjen nusja. Por edhe fëmijët dhe ca plaka që vinin teposhtë rrugës së fshatit thoshin:

-Vjen nusja,vjen nusja. Për disa minuta orkestra arriti përpara restoranti dhe pas tyre edhe krushqit dhe nusja. Dikush na tha mos habiteni se ne e kemi adet,që nusja të zbres,prej veture,apo dikur prej kalit dhe prej në fund të katundit e deri te kisha të eci në këmbë.

Ne u çuam dhe hymë në radhët e krushqive,ku përpara kishim tri vajza të rritura dhe një çupë afër pesë vjeçe e veshur në fustan të bardhe dhe kurorë në kokë. Unë u thash, z.Bexhetit dhe z.Ruzhdiut se do tu flas të shohim a dinë shqip. Iu afrova çupës së vogël dhe i thash:

-Sa nuse e bukur,vajzat kthyen kokat dhe na panë,por ne s'ishim të veshur me kostume për dasmë,por për plazh. Njëra e habitur më tha:

-Edhe ju jeni shqiptar?! Unë i thash po,por jo të Greqisë. Ajo afër saj tha:

-Të Shqipërisë?! Unë i thash,jo jemi të Maqedonisë. Ajo na tha:

-Kemi shumë shoqe e shokë,ne të tria studiojmë në Gjilan të Kosovës dhe jemi të parat që e thyem akullin për të studiuar jashtë Greqisë edhe atë në Kosovë në gjuhën tonë të dashur,dhashë Zoti s'kthehet prapë ajo që kanë vuajtur prindërit tonë. Edhe dhëndëri ka qenë student në Prishtinë,kurse nusja është nga Preveza dhe së bashku me prindërit jeton në Gjermani. Biseda do të vazhdonte,por në atë moment arritëm në oborrin e kishës dhe vajzat shpejtuan të afroheshin sa më afër se ishin të thirrura nga ana e dhëndrit. Ne bisedonim me disa fshatar e dikush nga ato na tha

-Kjo në afërsi të kishës është shkolla e fshatit dhe në këtë katund vetëm popi dhe mësuesit janë grekë,kurse ne të tjerët jemi shqiptar. Me siguri që biseda në mes nesh do të vazhdonte,por në atë moment erdhi njëra nga vajzat dhe mu drejtua mua:

-Zotëri dhëndëri ju thërret të vini në kishë,përndryshe nuk do të kurorëzohet! Ne u habitëm dhe unë i thash;ne me teshat tona nuk jemi të përgatitur për në kishë,dhe ne as që e njohim dhëndrin. Ajo më kapi për dore dhe u nisëm në drejtim të derës së kishës,të pranishmit na hapën rrugën. Unë u afrova afër popit dhe çiftit të rinj,kurse z. Bexheti dhe z. Ruzhdiu u ngjitën shkallëve për në katin e dytë të kishës.

Pas ceremonisë së KURORËZIMIT në oborrin e kishës i cakërruam gotat me dhëndrin,nusen dhe shumë të afërt të tyre,por edhe me një shok të dhëndrit i cili,në Novi Sad të Vojvodinës kishte studiuar lëndën e Historisë,por serbët kur kanë kuptuar se është shqiptar,por i fesë ortodokse kanë filluar ta përbuzin,por edhe me maltretime të lloj-llojit. Dhe prej në vjeshtë do të transferohet në Prishtinë,por kuptohej nëse nuk lindin probleme të tjera,por assesi nuk do të ngeli në duart serbëve. Fundi fundit do të kthehem na tha në Selanik,apo në ndonjë fakultet tjetër të Greqisë. Unë si me tallje i thash:

-Do të thotë se je bindur se kombet e Titos janë më të këqij se grekët. Ai më tha:

-Shumë më të fëlliqtë se grekët tonë.

DASMA E RRAPIT

* * *

Unë me gruan dhe fëmijët deri në orët e vonshme të kësaj dite i kaluam te kumbara e pronares ku banonim. Një plakë shqiptare,që disa ditë me radhë na luste që ta vizitonim dhe të pinim një kafe të pastër shqiptari në Pargën e bukur,që

po ashtu disa herë na ishte ankuar për maltretimet e shumta,të shtetit Grek. Ajo na tha se kanë qenë pesë motra dhe se ajo dinë vetëm për njërën,që jeton në Selanik,kurse për tri të tjerat prej shumë vitesh s'ka dëgjuar asnjë fjalë,as që guxon të pyes. Me lot të përgjakur dhe vaj na tha:

-Hallall krejt,por kurrë nuk mund t'ia fal shtetit Grek,që ma mori vajzën kur kishte njëzetepesë vjet dhe prej atëherë s'kam asnjë lajm,të mirë apo të keq,së paku t'ia dijë shtëpinë apo varrin. E pimë kafen,por na ngeli në fyt,kurse plaka ledhatonte tri vajzat tona dhe qante,duke na u lutur,që ta vizitonim prapë,kurse vitin tjetër po të vinim të banonim te ajo,pa asnjë dhrahmi,por vetëm të llafosnim shqip...

25. 07. 1990
Parga

Kur e pinim kafen e mëngjesit gruaja më tha se dhrahmitë ishin nga fundi,prandaj duke shkuar në plazh të këmbenim pak të holla,por do të ishte mirë të këmbenim prej dinarëve të Markoviçit. I quajmë kështu se ai përpara sezonit turistik përpara kamerave televizive tha:

-Çdo turist i Jugosllavisë i cili mendon të kalojë pushimet verore jashtë vendit nuk ka nevojë të furnizohet me deviza në vendin e vet,pasi dinari jonë më është KONVERTIBIL,që për shumicën e popullatës kjo fjalë ishte e pa kuptuar. Kur u nisëm për në plazh unë i mora të tërë paratë që kisha. Kur u afrova afër këmbimores,ku disa herë kisha këmbyer të holla,hyra në rend i nxora një shumë të hollash,në dinarë KONVERTIBIL të Marko-viçit dhe prita derisa u afrova në rend. Pronari i këmbimores më kishte hetuar se jam shqiptar,me siguri duke biseduar me gruan apo fëmijët. Sa ia lash në tavolinën e sportelit,ai më shikoi dhe shqip më tha:

-Zotëri i nderuar unë atë MUT,pare nuk e fus në kasë. Unë dorën në zemër u befasova dy herë. Të parën herë,që më foli shqip,të dytën pse e tha atë fjalë për paratë e shtetit Jugosllav. Unë e shikova dhe s'dija çka ti them dhe s'di si mu kujtua dhe i thash:

-Zotëri unë tjera para s'kam devizat i harxhova! Ai filloi të numërojë dhrahmi dhe më pyeti

-Sa të duhen zotëri?! Urdhëroni merrni! Unë i habitur,por edhe gruaja me fëmijët që ishin aty afër. I thash:

-Si mi jep kurse s' njihemi,i marr dhe ik dhe s' ti kthej kurrë. Ai shumë serioz tha:

-Zotëri unë thash;se atë MUT para nuk e fus në kasë. Ty s'të thash që të mi kthesh,punë e madhe për kaq para,por ti me familjen tënde të mos mërzitesh dhe të kalosh edhe ca ditë të këndshme në Pargën tonë të bukur. Unë iu falënderova dhe dola prej rendit. U konsultuam më grua dhe fëmijë,që të këmbeja edhe ata deviza,që na tepronin,prej pagesës së banesës dhe rrugës deri në kufi dhe krejtësisht do të bëheshin ditë pushimi në plazhin e bukur të Valtosit dymbëdhjetë,apo trembëdhjetë ditë,kurse ne ishim mësuar me afër njëzet ditë. Pronari si mi numëroi dhrahmitë e devizave tepricë,më tha:

-Zotëri,fjalët që ti thash janë nga zemra dhe serioze. Unë edhe njëherë nga zemra iu falënderova...

Vazhduam rrugën për tu ngjitur në kala e prej aty shkallëve teposhtë për në VALTOS te vendi i caktuar,te lisi plak. Vajzat hynë te shitorja e nanës,kurse ajo sa na pa tha:

-Sa më pihej kafe,por vetë disi nuk më shkonte. Vajzat u nisën për te hija e lisit,kurse ne me gruan u ndalëm të pinim kafe me nanën.

Prej te fillimi i shkallëve kur duhej të lëshoheshim teposhtë,për në plazh,shikova se një njeri me netull në krahë ngjitej lartë fortesës,u ndala dhe fillova ta perceptojë mirë,dhe i thash gruas:

-Edhe ky njeri më duket prej rrudhave në ballë dhe fytyrën e vuajtur se është shqiptar. Gruaja si e shikoi tha:

-Krejt është e mundur...!Kur afrua unë e përshëndeta,por në gjuhën greke e pastaj edhe në gjuhën shqipe. Ai kur kuptoi se jam shqiptar,duke më shtrënguar dorën ia nisi një këngës:"TË NA RROJË SHQIPËRIA..."

Mua tërë kohën në kokë më silleshin e vërtiteshin fjalët e pronarit të këmbimores,por edhe DASMA E RRAPIT,por edhe kënga e pastruesit të fortesës. Sa arritëm te hija e lisit,vajzat u futën në det unë u shtriva në rërën e nxehtë,kurse gruaja filloi të përgatitë ushqimin e mëngjesit,duke u thënë vajzave,të mos largohen shumë. Unë prapë hahesha dhe mbytesha me mendimet e mëparshëm,e kapa lapsin dhe fletoren e shënimeve dhe fillova të shkruaj:

DASMA E RRAPIT

Dikur e sot,e quajmë Rrap
Kurse me dhunë Anthusa
Kanë jetuar bashkë:
Leka,Jorgua,Mikis e Musa...

Ka pasur e ka kishë
Por s'ka më xhami
I kanë festuar bashkë festat
Ka qenë LIGJ në ÇAMËRI.

Kurse sot shqiptarët e Çamërisë
I KURORËZON popi i Greqisë
U dëshiron shëndet e fëmijë plot
Por të mos jenë,siç është baba sot?!

Popi u dëshiron nga zemra
Jetë të lumtur në perëndim
Dhe të mos vuaj për MALET e ÇAMËRISË
Por për gjuhën dhe kishën e Greqisë
DHËNDËRRI QESH SI QESH SHQIPTARI...?!

Si e shkrova poezinë më mirë fillova ta përballoj nxehtësinë e diellit. Hyra pak në ujin e vakët dhe të pastër të detit dhe u largova disa metra nga hija e lisit,ashtu pa lidhje dhe pa ndonjë qëllim. U përshëndeta me z. Bexhetin dhe z. Ruzhdiun,që ishin ndalur pak më larg nesh dhe vazhdova të ec. Nuk vajta as pesëdhjetë metra dëgjova se dikush më

thërriste në emër,në fillim u habita edhe pse atë zë e kisha të njohur. Kur e ktheva kokën i pashë dy vëllezërit Imeri, Zotëri Hasanin,profesor gjeografie dhe zotëri Abdullahun,ekonomist. Me të dy kisha biseduar në një dasmë se këtë vit planifikoj,që pushimet verore ti kaloj në qytetin Parga. Z. Hasani dhe z. Duli siç e thërrasim shkurt u afruan më morën grykë dhe z. Hasani më tha:

-Po ku je z. Beg,dy ditë të kërkojmë se e dinim se ndodhesh në këtë vend,pak prej bisedës në atë dasmën dhe më shumë u bindëm kur na tregoi vëllai yt z. Esati.

Shkuam u ulëm te restoranti në afërsi të lisit dhe ia shtruam bisedës. Z. Duli më pyeti se kur do të kthehem në Kërçovë. U tregova se ç'më kishte ndodhur me pronarin e këmbimores. Atëherë z. Hasani më tha se ato kishin mjaft të holla dhe po të desha ato do të më jepnin,që të rri edhe disa ditë me ato. Unë u pajtova dhe u dhashë dinarë KONVERTIBIL të Marko-viçit ato më dhanë edhe pesëqind marka gjermane dhe ashtu i sigurova gati edhe pesë ditë të tjera pushim në Pargën e bukur.

Edhe pronari i restorantit sillej mirë,por ruhej prej grkërve të fëlliqtë siç u thoshin shumë vendas shqiptarë...

Me vëllezërit Imeri mbrëmjen e kaluam në një atmosferë të pa përshkruar në shtëpinë e mishshitësit,ku ata ishin të vendosur,me gotat dhe pjatat e mbushura plotë e përplot duke parë programin e TELEVIZIONIT SHQIPTAR, por me ton të ulët dhe perdet e lëshuara.

27. 07. 1990
Parga

Sot plazhin e lamë pak më herët,pasi edhe rrezet e diellit shpesh i zinin ca re të zeza,që hamendeshin për të lëshuar ca pika shiu në rërën e përzhitur.

Disa ditë në mbrëmje kishim bërë xhiro nëpër shumë rrugë të qytetit,por andej nga kisha lart s'kishim shkuar dhe parë ç' kishte. U blemë vajzave nga një akullore dhe unë e mora Yllëzën e vogël hopa dhe filluam të ecnim rrugës,por edhe të shikonim reklamat e shumta të shitoreve të furnizuara mirë. Teuta u ndal dhe na tha:

-Ne i hëngrëm akulloret,tash ju duhej të pini kafe. Gëzimja duke qeshur iu përgjigj:

-Mami dhe babi duhej të pinë kafe,apo ti u lodhe dhe dëshiron të ulemi diku. Teuta duke qeshur i tha:

-Edhe njëra edhe tjetra. Unë e lëshova Yllëzën, edhe ajo pak të ecte dhe u thash se do të uleshim te kafeneja e parë.

Nuk ecëm as pesëdhjetë metra dhe vajzat panë ca karrige në një verandë kafeneja dhe pa mos u thënë ata shkuan dhe u ulën. Ne kur arritëm dhe sa të uleshim një burrë bukur në moshë arriti,që të na shërbente. Porosita dy kafe dhe kur i pyeta vajzat çka do të pinin,plaku me habi na tha:

-Shqiptarë jeni?! Unë iu përgjigja se po,por jo të Shqipërisë,por nga Maqedonia. Ai shkoi i porositi kafetë i solli dy lëngje dhe duke kërkuar leje u ul dhe mu drejtua mua:

-Unë dikur ushtrinë e kam bërë në QYTETIN E ALFABETIT. Kam qenë shok i mirë me vëllezërit MANAKI. Prej kurrë digjem për ta vizituar dhe për tu llafosur shqip, në shtëpi kam gruan dhe nusen greke,por prej atyre më të këqijve. U llafosëm afër një orë,por gruaja disa herë afrohej dhe diçka i thoshte,ai nervozohej por s'luante nga vendi,por

edhe gruaja,pas fjalëve të tija i thoshte diçka,por tash me ton të lart. Kur u ndamë në faqet e tij pash ca lot,që rrokulliseshin në drejtim të mjekrës. Duke na thënë :

-Greqia është një SHTET I ROMËVE APO ÇERËGARËVE siç u thoni ju atje. Dorën në zemër unë u habita,por edhe gruaja...?!

Me vëllezërit Imeri u takova te helikopteri i fëmijëve,që pronarja ishte një plakë shqiptare,që sillej shumë mirë me fëmijët dhe për çdo ditë vajzave u jepte nga një zheton gratis,kuptohet pas disa zhetonëve të harxhuar.

30. 07. 1990
Parga

Së bashku më vëllezërit Imeri,z. Bexhetin dhe z.Ruzhdiun aty ka ora dhjetë ishim në hyrje të fshatit Rrap i Poshtëm,ku takuam një plak,me një lopatë në krahë. Z. Ruzhdiu e përshëndeti dhe e pyeti për rrugën që do të na çonte në KALANË e djalit të Ali Pashë Tepelenës. Plaku na shikoi e uli lopatën nga krahu dhe u mbështet te bishti i saj,mori frymë thellë,sikurse është përpara mikrofonit dhe na dëshiroi mirëseardhje në fshatin e tij. Plaku na sqaroi se atje pas kishës,rruga e asfaltuar ju çon në të majtë dhe diku mbaron,që më ne dinim,kurse ajo që është e pa asfaltuar,në të djathtë do tu çojë deri në kala. Por me këmbëngulje insistoi që në shtëpinë e tij të pimë nga një gotë raki,apo ujë të ftohtë të çezmës,që e ka në frigorifer apo të kroit të fshatit. Ne iu falënderuam nga zemra duke i thënë se do ta lejmë për ndonjëherë tjetër,sepse fëmijët i kishim lënë në plazhin e Valtosit. Plaku na tha:

-Herën tjetër të na vini me fëmijët dhe gratë sepse shtëpitë tona janë të mëdha,për vëllezërit tonë nga Shqipëria dhe Kosova,që shpejt serbin e ndytë,vëllain e grekut do ta hekë qafe. Ne vazhduam rrugën,kurse plaku shikonte komben se si gjarpëronte nëpër rrugën e fshatit të tij e pastaj rrugës që çonte për në kala.

Kalanë e kishin mbuluar shkurret dhe ferrat,muret kishin filluar të rrënohen,por gryka e topit me gravurën e vitit,shkabës së bashku me VITOREN,kalanë e ruanin me fanatizëm,duke pritur trimin e vërtetë,që një ditë të kthehet në KALA. Profesor Hasani na mbajti një ligjëratë të shkurtër për Ali pashë Tepelenën.

Duke shikuar antenat e shumta në kufi me Shqipërinë zbritëm,për të vazhduar pas ditën në rërën flori të Valtosit,së bashku me familjet.

2. 08. 1990
Florina

Kur arritën në Janinë,ora ishte tetë e mëngjesit. Z. Ruzhdiu e bëri parkimin e kombes në një vend të sigurt dhe hymë në njërin nga restorantet e shumtë të Janinës që të hanim mëngjesin dhe të pinim kafet e para të asaj dite. Z. Bexheti bëri pagesën dhe dolëm prej restorantit,pasi gratë dhe fëmijët kishin dalë më përpara dhe shikonin nëpër vitrinat e shitoreve.

Kur filluam të ngjitemi shkallëve të SELISË së dikurshme të të madhit ALI PASHË TEPELENËS dielli përcëllonte dhe Yllëza e vogël mu afrua dhe më tha:

-Ose më merr hopa ose unë do të ulem. Bëra ashtu sipas urdhrit dhe vazhduam rrugën pas varganit të shumtë të vizitorëve. Xhaminë e pashait e meremetonin,por sipas asaj që pamë se punët bëheshim me një përtim dha pa ndonjë interes dhe kujdes të veçantë.

Pyetjet që i bënim kustoses e nervozonin dhe në të shumtat nuk përgjigjej,e veçanërisht kur na hetoi se jemi shqiptar,na tha:

-Pashai ka qenë një njeri analfabet,amoral,doras dhe katil. Kurse pashai pa asnjë farë shqetësimi,për fjalët që u folën thithte nargjilenë duke bërë qejfin e vet vite me radhë në portretin e madh e të dashur përpara vizitorëve dhe adhuruesve të vet. Z. Bexheti e pyeti kustosin për Artën,por ajo i tha se Arta disa ditë do të jetë e mbyllur për vizitorët.

Unë me gruan dhe fëmijët ngelëm edhe pak në kala,kurse z. Bexheti dhe z. Ruzhdiu me familjet zbritën,që të blejnë ndonjë send kujtimi dhe të ktheheshin në Pargë,për të vazhduar plazhin.

Kur zbritëm poshtë kalasë u ulëm nën hijen e trashë të blirit plak,ku ishin ulur shumë pleq dhe bisedonin për historinë e kaluar. Në mesin e tyre ishte edhe xha Jorgoja,një shqiptar i Sarandës,që kishte ikur prej regjimit të Enver Hoxhës qysh prej njëzet vitesh dhe ato ditë priste leje për tu kthyer në Sarandën e vet të dashur dhe të shikonte tetë fëmijët e vet më të rritur,por për fat të keq edhe varrin e gruas. Duke ua dhënë vajzave akulloret më tha:

-Janina është e jona,këtu kanë mësuar njerëzit më në zë të shqiptarisë dhe më tepër se gjysma e popullatës jemi shqiptarë,por politika është politikë,por duket se edhe asaj i vjen fundi.

Në ora dhjetë hipëm në autobusin që shkonte për në Konicë. Përpara se të arrinim edhe njëherë e pashë xhaminë e rrënuar nga dhëmbi i kohës,por edhe të njeriut ortodoks. Sa zbritëm prej autobusi dëgjova ca fjalë shqip; “Nënë shpejt se autobusi do të nisej”,iu afrova djalit të vogël dhe e pyeta:

-A dini ju shqip?! Ai mu përgjigj:

-Si të mos di unë shqip,kurse jam shqiptar.

-Ku do të shkoni me autobus?! Ai më tha:

-Ja atje(tregoi me dorë)është fshati im në kufi me Shqipërinë. Unë e pyeta:

-A frikoheni prej grekut?! Djali me guxim tha:

-Po ta luaj grekun e nënës dhe hipi në autobus. Ne si ecëm pak nëpër rrugët e Konicës hymë në restorantin”KONITSA”, për të drekuar dhe për tu freskuar me ujin e ftohtë,që dikur është freskuar edhe i madhi Faik. Edhe kamerieri na tha se aty flitet shqip, por kanë kujdes,se pasojat janë të rënda dhe të papara.

Autobusi i fundit i cili do të shkonte prej Kozani në drejtim të Florinës kishte shkuar,prandaj ne pa humbur kohë e

morëm taksin dhe në ora njëzet arritëm në kufi me Maqedoninë. Te shitorja e furnizuar mirë që ndodhej në afërsi të kufirit i harxhuam dhrahmitë e fundit dhe e thirra vëllain në telefon,që të vinte të na merrte se ashtu më kishte thënë kurse ne me valixhet në dorë kaluam kufirin Greko-Maqedon...

18. 05. 2005
Kërçovë

Gruaja si çdo ditë edhe sot ishte çuar me ndarjen e natës me ditën,apo aty ka ora pesë. Si e kishte pjekur mirë kafen ma kishte sjellë te krevati dhe më tha,që të laja sytë dhe të pinim kafetë. Ajo si përherë ashtu edhe sot kafenë e piu shumë shpejt dhe vazhdoi punët e mëngjesit,që në ora tetë pa çerek të nisej për në punë,që edhe pak ditë i mbush plotë tridhjetë vite stazh pune.

Unë vazhdova me atë shkrimin e lirë,që e kisha nisur aty ka ora një pas mesnatës. I lodhur dhe rraskapitur s'di si çova kokën lartë dhe sytë më vajtën te ora e murit që me tiktaket e saja kishte arritur fiks nëntë e njëzeteshtatë minuta. E memorizova shkrimin e filluar në monitorin e kompjuterit largova filxhanin e kafesë prej tavoline dhe u afrova te shporeti elektrik për të bërë edhe një kafe. Që pak të relaksoja trurin e lodhur. Në atë moment ra zilja e telefonit. U afrova kapa receptorin,prej andej dëgjova një zë fëmije,që shpejt mu kujtua se ishte zëri i mbesës së dashur,dhe pastaj përshëndetjen e Teutës. Bijës tonë që prej dy vitesh jeton në Parisin e bukur,por për ne shumë larg dhe mos të them edhe të shëmtuar. Si biseduam pak,më tha se ishte shumë e mërzitur,pse akoma s'kishin përgjigje prej Ministrisë,në lidhje me vizat tona,dhe se gjatë dorëzimit s'kishin pasur asnjë vërejtje,bile u kishin thënë se çdo gjë është në rregull. Unë i thash që të mos mërzitet,ata i dinë punët e veta dhe se ata

s'nguten siç ngutemi ne. Si e dëgjova edhe një herë zërin e mbesës i thash të përshëndetët Agimin burrin e saj dhe anëtarët tjerë të familjes,që për tu parë sa më shpejt në Paris e mbylla telefonin,që të vazhdoja me pjekjen e kafes dhe të përfundoja mendimin e filluar pak më parë. Kafen e piva, por assesi të vazhdoja me mendimin e filluar,pas bisedës me vajzën time që kur s'kam menduar se pas studimeve të matematikës dhe atëherë kur u punësua në gjimnazin e Kërçovës si profesoreshë do të dojë fati që ajo të martohet për personin që Parisin e bukur e kishte si mëmëdhe të dytë,pasi atje është rritur dhe ka mbaruar studimet për kimi. E shkyça kompjuterin për të vazhduar dikur më vonë,apo...

Aty nga ora dymbëdhjetë i bleva gazetat e ditës dhe u drejtova në drejtim të kafenesë "ELITA",që ndodhet në qendër të Kërçovës,të pijë edhe një kafe e ndoshta takohem me ndonjë mik apo shok që s'jemi takuar prej shumë kohësh. Ashtu edhe ndodhi,pak para se ti afrohem "ELITËS" dikush më thirri në emër. Ishte një shok klase,u ulëm brenda në lokal,pasi përjashta akoma bënte ftohtë e veçanërisht ajo ditë,dorën në zemër këtë e bëmë më shumë për hire të shokut,që prej disa muajsh apo një viti mjekët i kishin thënë se vuan nga kanceri,që si ai ashtu dhe unë dyshonim,në atë hije që i dukej në fyt më së shumti nga ngacmimet e kemikaleve të laboratorit ku punonte si inxhinier se sa në atë që dyshonin mjekët,edhe meqenëse në kohën e fundit është dobësuar si tepër.

Biseduam gjatë kohë,për problemet e jetës. E më së tepërmi për plagën e pa shëruar të kurbetit,që s'ka lënë familje pa prekur. Nuk lamë pa prekur edhe politikën,që prej se kemi lindur na ka hëngër shpirtin. Edhe dikur si nxënës,por edhe sot kur jemi të pensionuar përpara kohe,nga shkatërrimi i shëndetit dhe nga politika e pistë komuniste.

Në shtëpi u ktheva aty nga ora gjashtëmbëdhjetë kur më edhe gruaja ishte kthyer nga puna,dhe e kishte ngrohur

gjellën dhe përgatiste sallatën. Ne sa u ulëm rreth tryezës ra zilja e telefonit. Andej prapë dëgjova zërin e mbesës së vogël e pastaj edhe të Teutës,por tash ishte mjaftë e gëzuar. Ajo më tregoi se aty nga ora katërmbëdhjetë i ishte paraqitur bashkëshorti-Agimi dhe i kishte treguar se i ishte paraqitur inspektori për të huaj në Ministrinë e Punëve të Brendshme të Francës se vizat tona janë gati. Dhe po atë ditë janë dërguar në Ambasadën e Francës në Shkup në Maqedoni. Dhe qysh prej ditës së nesërme ne mundemi të shkojmë që ti marrim,por ndoshta ata nuk punojnë se të nesërmen Franca e ka ditë feste. Ndoshta do të jetë më mirë që të shkonim në Shkup pas vikendit. Duke u përshëndetur me mua dhe nënën e vet e mbyllëm telefonin që sa më parë të takohemi në Parisin e bukur,që qysh si fëmijë ëndërroja që një ditë ta vizitoj.

24. 05. 2005
Kërçovë

Gati tërë natën s'fjeta as unë e as gruaja. Fiks në ora pesë e tridhjetë minuta ishim në rrugën kryesore që lidhë Kërçovën me Gostivarin,për të pritur minibusin që për çdo ditë udhëton në drejtim të Shkupit.

Rrugës kaluam mirë,hëngrëm mëngjesin pimë edhe kafen e dytë të asaj dite dhe aty nga ora dhjetë ishim përpara sportelit të Ambasadës Franceze. I morëm formularët dhe fillova ti mbush pa ndonjë vështirësi,herë i lexoja në gjuhën shqipe herë në gjuhën frënge. Puna shkonte mbar,edhe meqenëse ishte hera e parë që mbushja asi lloj formularësh, për marrjen e vizës për të udhëtuar në një vend të huaj. Puna ngeci kur arrita te numri që kërkohej të shkruaj adresën e personit që na i ka dërguar vizat, por edhe emrin e tij. Ata

vende i lash të zbraztë, pasi me të vërtetë s'dija as adresën e as emrin e saktë të personit, që na i dërgonte vizat.

Aty nga ora njëmbëdhjetë i dorëzova dokumentet në sportelin e Ambasadës,por i punësuari u bëri një vështrim dokumenteve,pastaj shikoi një dokument që kishte përpara me siguri ishin vizat tona dhe me shumë arrogancë dhe sjellje jo njerëzore më tha:

-Nuk mundesh ti marrish vizat,pa mos e plotësuar pyetësorin në tërësi. Unë i thash me shumë sinqeritet se nuk e njohë dhe nuk e dijë adresën e personit,dhe se është hera e parë që do të vizitoj Francën. Por ai edhe më tepër u hutua dhe mi hodhi dokumentet,për ti plotësuar në tërësi. Si unë ashtu edhe gruaja u mërzitëm dhe s'dinim çka të bënim përveç që të paraqiteshim te Teuta në Francë dhe ti tregonim për hallin.

Ambasada e Francës ndodhet në periferi të Shkupit dhe në afërsi të saj nuk ka telefon,por edhe ne nuk kemi celular. Shikova rreth e rrotull,por s' pashë asnjë njeri të njohshëm. Së bashku me gruan dolëm në hyrje të Ambasadës,për të marrë ndonjë taksi,për të shkuar deri te telefoni më i afërt dhe të bisedonim me Teutën,por në atë moment një shqiptar i cili bënte këmbimin e valutave për të paguar taksat e vizave,më pyeti se çfarë halli kisha. I tregova,ai më tha se nuk kishte çka të bënte,por mundej të më ndihmonte të shërbehem me telefonin e rojës së Ambasadës që është i lidhur direkt me Francën,por do të duhej të paguaj. I thash se as që mendoj dikush të më shërbejë falas. Hyri brenda bisedoi me të punësuarin dhe më thirri,që edhe unë të hyja. Ia dhashë numrin dhe shumë shpejt kapi lidhjen. Teutës ia sqarova problemet dhe ajo më tha se do ti tregonte Agimit dhe do të paraqitej për disa minuta. Vërtetë ashtu ndodhi. Por tash u paraqit Agimi dhe më tha se ishte konsultuar me inspektorin dhe ai i kishte thënë se nuk ka nevojë të shkruhet adresa. Dhe nëse nuk ia pranojnë dokumentet le të kërkojë

pranim te Atasheu. I thash Agimit se ne jemi në Maqedoni dhe kush do të më lejojë mua që të takohem me Atasheun e Francës. Ai nguli këmbë që unë të paraqitesha te sporteli dhe ti thosha atë që tha ai.

Ata pak veta që kishin ngelur përpara sportelit më panë dhe më lejuan ti dorëzoja dokumentet,apo të thosha atë që kisha për të thënë. I punësuari prapë me arrogancë më tha:

-Çka bëre?! I thash atë që më tha Agimi,por ai edhe më tepër u egërsua,duke më thënë:

-Kush je ti apo ky që të ka dërguar vizat të bisedoni me Atasheun e Francës. Unë i thash se personin që i ka dërguar vizat nuk e njohë,sa për mua në se donë të dish se kush jam,edhe pse nuk dua, por më shtyni që tu them se për ty jam njeri shumë i madh,dhe për kombin tim,sa i përket Atasheut të Francës ai për këta probleme është i dërguar prej shtetit të vet. Dhe u largova,që të mos u merrja shumë kohë të pranishmëve. U largova për ti treguar dhëndrit për atë që ndodhi,pasi afrohej koha për tu mbyll sporteli.

Ia tregova hallin të punësuarit,dhe ai menjëherë e kapi telefonin,si pak më parë, Agimi u paraqit dhe më tha:

-Unë bisedova prapë me inspektorin. Ai më tha se po të mos ia pranojnë dokumentet le t'ia lejë përpara sportelit dhe le të shkojë. Ai i punësuari i ka krejt të dhënat e nevojshme për tu marrë një vizë. Unë sa desha të bëja pagesën ra telefoni,andej ishte Teuta. Dhe pa asnjë farë nervoze më tha:

-Mos mërziteni babi,se nuk ka probleme që të mos u jepen vizat. Dhe kërkoi të bisedonte me nënën,por unë i thash se s'kemi tash kohë,se sporteli punon vetëm edhe dhjetë minuta,dhe mbyllej do të thirrëm kur të zbresim në qytet. E mbylla telefonin dhe u nisëm me gruan në drejtim të sportelit që prej aty i ka afër njëqind metra largësi. Përpara sportelit kishte edhe vetëm një person,kur unë u afrova ai më ishte gati dhe u largua. I punësuari më shikoi me inat,por unë i thash atë

që më tha Agimi dhe ia hedha dokumentet dhe e pyeta kur të vija për rezultat. Ashtu me inat i mori dhe më tha të nesërmen,por me siguri do të jetë rezultati negativ. I thash se ajo nuk është punë e tij dhe u largova. Se me të vërtetë isha i lodhur dhe disa herë e përdora sprejin kundër astmës duke hipur e zbritur atyre shkallëve prej te hyrja Ambasadës e deri te sporteli,që më ktheu disa herë ai njeri i pandërgjegjshëm,por ndoshta kishte edhe të drejtë...

Me gruan morëm taksin dhe zbritëm në qytet. Pimë nga një kafe me lëng pemësh pushuam pak,dhe dolëm të blejmë dhurata për mbesën e dashur. Por duke komentuar sjelljen e atij personi të punësuar në atë vend me aq përgjegjësi. Dhe duke pritur me një dozë pesëdhjetë me pesëdhjetë për rezultatin e ditës së nesërme.

25. 05. 2005
Kërçovë

Edhe pse rashë shumë vonë,në ora pesë e tridhjetë si një ditë më parë me minibusin e mëngjesit u nisa për në Shkup,por sot pa gruan me droje dhe lodhje,por sidoqoftë gruan e porosita që të bisedonte me drejtorin në lidhje me pushimin vjetor.

Me siguri prej lodhjes,dhe prej atij pak gjumi të natës,shumë shpejt isha kotur dhe kur u zgjova më ishim në afërsi të Shkupit. Shoferi i minibusit pyeti se kush është për te spitali shtetëror le të mos zbres,pasi prej asaj dite paska urdhër që së pari të shkojë te spitali e pastaj te stacioni i autobusëve. Ky relacion më përgjigjej edhe mua,pasi prej te spitali shtetëror Ambasada e Francës nuk është larg dhe po të mos ketë taksi për disa minuta do të jem atje.

Në afërsi të spitalit te një restorant mjaft luksoz hëngra një çorbë viçi,si piva edhe kafen e dytë të asaj dite pak e mora veten dhe aty ka ora nënd ngadalë u nisa në drejtim të Ambasadës Franceze. Pak pas orës dhjetë isha në hyrje të Ambasadës dhe menjëherë më panë ata të punësuarit,që një ditë më parë më kishin shërbyen me telefonin,më përshëndetën por edhe unë i përshëndeta dhe vazhdova rrugën. Duke zbritur shkallëve pashë se përpara sportelit kishte mjaftë njerëz,aty për aty më kapi një frikë e nervozë dhe filluan këmbët të mos shkojnë përpara,që të afrohesha përpara sportelit. Por s'kisha rrugë tjetër të afrohesha dhe të kuptoja për vizat e aq pritura. Ai personi arroganti i djeshëm mi hodhi sytë dhe filloi të shërbejë një person. Me te nuk pat shumë punë dhe prapë mi hodhi sytë dhe më thirri që të afrohesha ti merrja pasaportat. Së pari më uroi rrugë të mbarë për në shtetin e Francës e pastaj mi dha të dy pasaportat. Iu falënderova dhe dola prej rendit,që të kryenin punë edhe të tjerët. I hapa të dy pasaportat dhe pashë se kishim fituar viza edhe atë për tre muaj,edhe atë me shumë hyrje dalje. E hapa çantën i futa pasaportat dhe nxora tri veprat e fundit dhe kërkova leje që të afrohesha te sporteli,për t'ia dhënë ati arrogantit. I mori me shumë kënaqësi duke u falënderuar më tha:

-Prej jush kam lexuar disa vepra dhe shumë punime nëpër gazeta e revista për fëmijë,puna është punë e neve shpejt na merr lumi. Edhe unë iu falënderova që paska harxhuar pak kohë për të lexuar punimet e mija.

Shkallët e shumta tash i mora me shumë lehtësi. Përpara se të dilja prej Ambasadës, takova atë shqiptarin që një ditë më parë më ndihmoi me telefonimin dhe më pyeti se a ishte në rregull,i thash se po dhe hapa çantën edhe atij i dhashë disa prej vepra të mija. Edhe ai i mori me shumë kënaqësi dhe më tha që të prisja pak,kurse vetë hyri te ai i punësuari i ambasadës,me siguri i tregoi,edhe ai më uroi rrugë

të mbarë për në Francë,kurse ai doli më kapi për krahu dhe me tha se edhe ai kishte do punë në qytet dhe u nisëm në drejtim të veturës së tij. Gjatë udhëtimit bisedoi disa herë në celular,dhe shumë pak patëm kohë për të biseduar. Si arritëm në qytet i thash se unë mund të zbres në çdo vend ,vetëm e vetëm të mos e pengoja atë. Ai mu përgjigj se do të më çonte deri aty ku unë dëshiroja,por së pari të pinim nga një kafe,por edhe nëse isha i unët edhe ushqim. Iu falënderova nga zemra. Edhe ai më tha se kishte lexuar shumë punime nga unë dhe i vinte mirë,që sot kishte mundësinë të rrinte pak kohë me mua,por me kusht që të mos më pengonte. I thash me kënaqësi,unë punët e kësaj dite i bëra edhe atë me shumë sukses. Ai voziti edhe pak,e ndali veturën e thirri një shok të vetin që e priste aty në skaj të rrugës dhe vazhdoi rrugën,deri te hotel Grandi dhe aty u ndal. Më tha se aty do të pinim kafe,duke i treguar shokut se kush isha unë,po ashtu i tregoi se i kam dhënë disa vepra. Atëherë ai tha se duhej të hanim edhe drekë,ai iu përgjigj me shumë kënaqësi.

Hymë në hotel, ai prapë më pyeti për të ngrënë i thash jo,se me të vërtetë s'isha i unët. Porositëm kafetë,por për mua porositi edhe lëng pemësh. Biseda ishte shumë e ngrohtë dhe miqësore. Përpara se të ndahemi edhe ati shokut i dhashë dy nga veprat e mija,edhe ai u falënderua nga zemra duke më thënë;papunësia dhe nevojat e jetës i ka shtyrë që ata të dy disa vite me radhë të merren me këmbimin e valutave dhe se njëri prej tyre është për çdo ditë përpara Ambasadës së Francës. Më në fund duke u përshëndetur dhe falënderuar për kafenë,që ndoshta takohemi edhe ndonjëherë tjetër ata vazhduan rrugën për në punën e përditshme,kurse unë u ndala te telefoni aty në afërsi për të marrë sihariqin e vizave,së pari Teutës,pastaj Gëzimes,Yllëzës dhe gruas,por për fat të keq assesi në atë moment të më kujtohej numri i telefonit të gruas në punë,prandaj e pyeta Yllëzën,ajo njëherë qeshi e pastaj tha:

- Ndoshta prej gëzimit babi dhe pastaj më tregoi numrin...

28. 05. 2005
Kërçovë

E tërë pas dita dhe nata gjer vonë na kaloi duke pritur e përcjellë të afërmit,që na sillnin dhurata dhe të fala për Teutën e veçanërisht për Aurelën e vogël,por edhe për të tjerët. Të nesërmen gruaja ishte ngrit përpara orës gjashtë,e kishte përgatitur kafenë dhe ma solli te krevati. I thash pse aq herët,por ajo më tha,të çohem të freskohem dhe të pimë kafen,se ajo tërë natën s'ka mbyllur sytë. Unë duke qeshur i thash frikohesh prej aeroplanit,pasi ishte hera e parë që do të hipte në aeroplan. Ajo nuk foli por i shtrydhi disa pika limoni kafes dhe ma afroi më afër,kurse të vetes ca pika më shumë se në kohën e fundit vuan prej tensionit të lart të gjakut.

Si piu kafen doli në dhomën tjetër e mori një valixhe dhe filloi të paloste teshat që kishin ngelur prej ditës së djeshme. Aty ka fundi mu lut që të mbaja valixhen,që të fuste edhe ato të fundit e pastaj ta mbyllnim. Të kontrollonim edhe njëherë aparatet me korrent elektrik,të mbyllnim dritaret e katit të parë dhe në ora nëntë pa çerek të dilnim në rrugë siç kisha biseduar ditë më parë me taksistin.

Fiks në kohën e caktuar taksisti kishte ardhur kishte hapur dyert dhe na priste. Ne sa mbyllëm derën të tërë gratë e shtëpive për rreth dhe të vëllezërve dolën të na përcillnin,kurse njëra nga kunatat na tha se nëna afër një orë përpara kishte dalë te dera dhe priste,kur do të vinte taksi, t'u tregonte. Kurse njëra nga gratë,që ka udhëtuar disa herë,i tha

gruas të mos frikohet se në aeroplan është më mirë se në autobus.

Aty nga ora njëmbëdhjetë ishim në Tetovë te Yllëza. Gruaja hipi lartë kurse unë i lash valixhet te shitorja nën banesën tonë të blerë një vit më parë. Bleva do ushqime për Yllëzën dhe shoqet e saja që banojnë së bashku dhe desha të hipja lartë,por mu kujtua se gruaja më tha që të blerja edhe dredhëza. Aty nuk kishte,prandaj u detyrova të shkoja në një shitore tjetër aty afër.

Lart me Yllëzën ishin të tëra cimeret. Gruaja ishte shtri në njërin krevat që të pushonte. Unë si i lash dy qese najloni plotë me ushqime duke e porositur Yllëzën,që ti hanin së bashku,piva një lëng që ma solli njëra nga vajzat më duket se quhej Thëllëzë dhe studionte për farmaci. I u falënderova dhe i thash gruas se do të dilja të takojë një shok dhe të rezervoja taksin për në Shkup,por edhe të blejë edhe disa medikamente,që si kishte në Kërçovë,për miken time që më shoqëron mbi dyzet vjet-Astma. Rrugës rezervova taksin,që në ora trembëdhjetë të jetë përpara ndërtesës dhe vazhdova rrugën për te Shtëpia botuese "ORA"ku duhej të takohem me z. Rami Kamberrin dhe z. Ekrem Ajrulin. Me z.Ramiun kisha një bisedë në lidhje me projektin e tij që i kishte kaluar në Ministrinë e Kulturës ku edhe unë përfshihesha me disa faqe. Tua lija veprën time të fundit që po ashtu ishte financim i Minitrisë së Kulturës. Z. Ekremi porositi një lëng dhe kapi telefonin që të thërriste z. Ramiun, pasi koha nuk më premtonte. Ai më tregoi se një ditë më parë z. Kaloshi ia kishte sjellë disa copë të "ZEKTHIT" ku edhe unë isha përfshi me një faqe,me disa poezi,por kur i tregova se udhëtoja për në Paris mi dha pesë copë që ti shpërndaja atje. Duke pirë lëngun më uroi se prej ati numri unë isha anëtar i Redaksisë së "ZEKTHIT". Si futa ekzemplarët në çantë në derë u duk z.Ramiu. U përshëndetëm më uroi rrugë të mbarë për në Paris dhe ia filluam bisedës. Më tha se çdo gjë ishte në

rregull prej anës së tij,por kishte probleme me Shtypshkronjën që ka edhe Shtëpinë Botuese dhe se ajo paska konkurruar me titullin dhe nuk ia jep honorarin dhe se do të jetë i detyruar ta paditi në gjyq. Unë i thash se edhe unë pata të njëjtin problem,por kur desha të bëja padinë mi dhanë të hollat. Dhe u thash se e prishim kontratën e bashkëpunimit të më tutjemë,por njëri nga ata të punësuarit më tha se kanë pasur do mosmarrëveshje në mes veti,dhe të vazhdonim si më parë. Por unë i thash se kjo është vepra e fundit dhe po ashtu paret e fundit që ata i marrin prej meje. Pasi e piva edhe pikën e fundit të lëngut u përshëndeta dhe dola për të vazhduar në drejtim të banesës,ku më kishte ngelur edhe shumë pak kohë për tu nisur në drejtim të Shkupit.

Fiks në ora trembëdhjetë taksi ishte përpara banesës. Yllëza së bashku me shoqet dhe mamanë e vet kishin dalë poshtë dhe më prisnin mua. Unë i morra valixhet prej te shitorja i vendova në veturë u përshëndeta me Yllëzën dhe shoqet e saja,po ashtu edhe gruaja dhe hipëm në taksi për të vazhduar rrugën për në drejtim të Shkupit,që përpara orës pesëmbëdhjetë të ishim në aeroport.

Si bëmë të gjitha procedurat dhe kontrollet e aeroportit pak përpara orës gjashtëmbëdhjetë si bëmë me gruan një foto përpara aeroplanit,por kuptohet si morra lejen nga personi që ishte në afërsi dhe ajo qe fotografia e parë në këtë udhëtim për ne maratonik u ngjitëm shkallëve të aeroplanit Adria të kompanisë sllovene.

NË SHKUP PËRPARA AEROPLANIT

Udhëtimi ishte i rehatshëm dhe gruaja si hera e parë që udhëtonte me aeroplan nuk pati ndonjë problem,bile kënaqej duke parë nëpër dritaren e aeroplanit bukuritë natyrore e veçanërisht kur hymë në territorin slloven.

Pak përpara orës tetëmbëdhjetë,stjuardesa tha që të vendonim rripat se shumë shpejt do të aterronim në aeroportin e Lubjanës,kurse ne në atë moment bënim fotografinë e fundit duke hëngër senduiçin, që pak më parë na i dhanë të punësuarat duke i thënë një plake aty përpara nesh,në gjuhën shqipe se në atë aeroplan kurrë nuk përdoret mishi i derrit dhe

se plaka mundej ta hante lirisht senduiçin. Edhe aterrimin e përballuam mirë.

Në aeroportin e Lubjanës pushuam afër një orë. Gruaja shkoi te një kioskë,që ishte në brendi të aeroportit dhe bleu disa lodra dhurata dhe çokollata për Aurelën e vogël. Po ashtu edhe në aeroportin e Lubjanës i bëmë disa fotografi.

Tash më aeroplani i të njëjtës firme,por më i madh dhe më me shumë pasagjer ishte mbi retë dhe fluturonte në drejtim të Parisit të bukur ku rritej e lumtur princesha e jonë e vogël. Si prej Shkupit po ashtu edhe prej Lubjane gruaja u ul në afërsi të dritares dhe shikonte herë retë,shtëllunga gjigante herë bukuritë e natyrës nënë. Edhe në këtë aeroplan na shërbyen me nga një sendiuç,dhe kush dëshironte kafe e kush lëng. Dhe ne sa e hëngrëm senduçin dhe pimë kafetë stjuardesa tregoi se për disa minuta do të aterronim në aeroportin “CHARL DE GOL”,ku koha është mjaftë e mirë dhe e përshtatshme për aterrim.

Gruaja si shikonte për dritares së aeroplanit,kur u kthye nga unë,vërejta se për faqeve të saja rrokulliseshin një rrëke lotësh. E pyeta ç’ kishte ndodhur,por ajo s’mundej të mbushej me frymë dhe të më përgjigje. Atë e vërejti edhe një udhëtare që ishte përballë nesh. Unë prapë e pyeta dhe i thash që të mos bënte cirk në aeroplan. Se kush e dinë se çka do të mendojnë ata që do ta shikonin në atë gjendje. Ajo dama që ishte përballë nesh në një gjuhë sllave tha:

-Emocione zonjë. Në atë moment gruaja tha:

-Për pak minuta unë gjyshja do ta përqafojë fortë bebushkën time, princeshën, bukuroshen e gjyshes. Atëherë unë duke qeshur,i thash:

-Por Teutën,mamanë e princeshës?! Ajo më shikoi dhe qeshi duke thënë:

-Rrugën e gjatë e kemi marrë për të gjitha,por më së tepërmi për mbesën e dashur- A U R E L Ë N.

Aty nga ora njëzetenjë aeroplani i firmës ADRIA aterroi në aeroportin “CHARL DE GOL” të Parisit.

Aty gruaja,por edhe unë prej afër pamë aeroplanë disa herë më të mëdhenj se ai që kishim udhëtuar ne.

Te shkallët e aeroplanit,prapë mu afrua ai Maqedoni,i cili mu paraqit në aeroportin e Lubjanës dhe më tregoi se në Paris punon në sigurim,dhe po të kisha probleme ai do të më ndihmonte,por unë i thash se unë nuk jam njeri i problemeve. Ai pa mos e pyet më tha se ka udhëtuar për në Maqedoni se ka pasur një rast vdekjeje,dhe se ishte nga Radovishi. Prindërit dhe vëllain tha i humba,por kam edhe një motër dhe se te ajo paska fjetur disa net. Si i morëm valixhet më tha se ia kanë vjedhur portofolin dhe një shumë të hollash. Atëherë unë i thash:

-Paraqitu në punë dhe s’do të kesh probleme. Ai më pyeti:

-Por ti nuk ke pak para të më huazosh? Unë i thash:

-Unë vite prej Maqedonie,prej atij vendi ku s’ka pare. Ai filloi të bisedojë me vetveten:

-Ndoshta të hollat i kam harruar te motra. Atëherë unë i thash:

-S’është ndonjë tragjedi e madhe,edhe ashtu është dashur ti japish pak pare motrës së vetme që të ka ngelur e gjallë. Ne atje kemi nevojë për ju që jeni në vende të pasura siç është Franca. Ai më shikoi,kurse unë shtyja bagazhin duke e shikuar se si në Lubjanë bleu një birrë dhe një pako cigare, duke menduar se ai do të jetë ndonjë kriminel,apo ndonjë lypsar,apo siç u thonë në Francë klosharë.

Ashtu i menduar dhe duke shtyrë bagazhin gruaja më tregoi se e kishte parë Agimin,dhëndrin dhe ja pas tij tha Teuta dhe Aurela e vogël,dhe prapë për faqesh filluan ti rrokulliseshin rrëke lotësh.

Përqafimi ishte i përzemërt,dhe i përmalluar. Bebushi na shikonte me habi dhe herë, herë qeshte,pasi s’na kishte

parë një kohë të gjatë. Unë u përshëndeta edhe me z. Bashkimin vëllain e z. Agimit dhe u drejtuam në drejtim të veturës-kombit,që ishte pronë e z. Bashkimit,dhe me te do të shkonim deri te shtëpia e z. Agimit,që ndodhet në pjesën e Parisit nëntëdhjetetre - NOISY LE GRAND.

Udhëtuam afër një orë,pasi prej aeroportit e gjer te shtëpia e z. Agimit,por më saktë të z. Qamilit babës së Agimit,ka afër tridhjetë kilometra,por trafiku është mjaftë i dendur në atë kohë të ditës. Gjatë rrugës bisedonim tema të ndryshme,kurse Aurelën e zuri gjumi në prehrin e gjyshes.

Në shtëpi na pritnin prindërit e z. Agimit dhe zonja e z. Bashkimit së bashku me të tre fëmijët. Pushuam duke biseduar me z. Qamilin,po ashtu tema të ndryshme për Kërçovën dhe në përgjithësi për çështjen shqiptare në Maqedoninë e pas luftës,pimë edhe kafenë e parë në Parisin e bukur,që unë pesëdhjetë vjet e kam ëndërruar. Aty diku pas mesnate e hëngrëm edhe darkën ose më mirë të them ushqimin e parë në Paris apo Francën e largët,ku gërshetohen kultura të shumta. Si hëngrëm darkën z. Bashkimi kërkoi leje që të shkonte në banesën e vet,pasi ishte shumë vonë dhe fëmijët ia zuri disa herë gjumi. Nuk shkoi shumë kohë dhe u ngjitëm në katin e dytë,ku banonte z. Agimi më Teutën dhe Aurelën e vogël. Për ne kishin përgatitur një dhomë jo shumë të madhe,por të pajisur mjaftë bukur me një krevat dyshe,një orman për teshat dhe një tavolinë pune me dy karrige. Po ashtu kishin përgatitur edhe një dhomë gjumi dhe një dhomë të vogël për Aurelën,kurse kuzhinën,dhomën e ditës dhe sallonin në katin e tretë akoma si kishin rregulluar,pasi shtëpinë e kishin ndërtuar një vit më parë. Por nuk kishin edhe aq nevojë të nguten se gjatë ditës rrinin në katin përdhes,që ishte shumë mirë i pajisur dhe i rregulluar. Z. Agimi kohën e lirë e kalonte lart te salloni ku kishte bërë instalimin e kompjuterit me internetin,ku ishte i lidhur plotë njëzetekatër orë. Por edhe shumë aparate të tjerë.

Ne mbetëm edhe pak me Aurelën e vogël z. Agimin dhe Teutën,dhe si e zuri gjumi Aurelën edhe ne shkuam në dhomën tonë për të pushuar dhe të bënim edhe gjumin e parë në Francë - Parisin e bukur,për të cilin thonë se ka shumë gjumë të lezetshëm dhe të rehatshëm...

29. 05. 2005
Paris

Kur u zgjova dielli më ishte afër zenitit,dhe ngrohte ngadalë qershitë,që diku,diku kishin filluar të merrnin ngjyrën e kuqe. E hapa dritaren duke vërejtur një zog që bënte luftë me një qershi që ishte në majën më të lartë të pemës. Nuk e di a u turpërua nga unë,pse s'mundej ta kapte qershinë me sqepin e tij të vockël,apo u tremb nga aeroplani që në atë moment kaloi mbi ne dhe iku duke u rënë fletëve si me përtim.

Aty nga ora dymbëdhjetë zbrita në katin e parë,ku z. Qamili luante me të mbesat Aurelën e vogël dhe vajzën e z. Bashkimit,që mbrëmë kur shkuan atë e kishte zënë gjumi dhe ngeli të flinte në shtëpinë e babagjyshit. Zonja e shtëpisë gruaja e z. Qamilit ma solli kafenë,kurse Teuta filloi të shtrojë tryezën e ushqimit. Unë dhe gruaja ime hëngrëm ushqimin që e kishte përgatitur zonja e shtëpisë,kurse ata hëngrën byrekun,që ne ua kishim sjellë nga Kërçova,të bërë special nga byrektorja "XHEJ",që ndodhet në afërsi të banesës sonë edhe atë disa me mish e disa me djathë. Unë me gruan u ngopëm mirë se me të vërtetë ushqimi ishte i shijshëm,por nuk di se a u ngopën ata,pasi një pjesë të byrekut,zonja e shtëpisë,ia kishte dhënë zonjës së Bashkimit,kurse një pjesë tjetër ia ruante,djalit të tretë, Aliut që e pritnin të vijë në çdo moment së bashku me gruan dhe vajzën.

Unë dhe z. Qamili dolëm në kopsht,kurse gratë llafoseshin në kuzhinë. Z. Agimi me Teutën dolën në qytet,për të bërë pazarin e javës. Ne sa u ulën nën hije të qershisë gruaja ime na solli kafet dhe nga një gotë lëng pemësh. Duke pirë kafetë z. Qamili më tregonte për kopshtin,që kishte mbjellë prej të gjitha zarzavateve,por farën e kungullit dhe të misrit i kishte sjellë nga Kërçova. Ashtu ne të zhytur në bisedat,që z. Qamili më pyeste për Kërçovën e unë i tregoja,pamë se përpara shtëpisë u parkuan dy vetura,njëra e z. Bashkimit dhe tjetra e z. Likut siç i thonë djalit të tretë. Erdhën në kopsht u përshëndetëm,por tash mua më duhej përkthyes,pasi gruaja e Likut është një franceze,prej një martese të përzier,baba afrikan kurse nëna franceze. Ajo më tha se vajza e ime Teuta shumë shpejt e ka mësuar gjuhën frënge,kurse ajo vetëm disa fjalë të gjuhës shqipe.

Z. Bashkimi dhe z. Liku si pinë kafetë,menjëherë u çuan e morën skarën e pastruan mirë dhe e ndezën atje në skaj të kopshtit. Z. Bashkimi shkoi te vetura dhe solli një shportë të madhe plotë me mish të disa llojeve,kurse z. Liku solli disa qeska najloni me pemë,perime dhe pije të ndryshme.

Aty nga ora gjashtëmbëdhjetë kopshtit i vinte një erë këndshme mishi. Unë sa u bëra gati të afrohem te skara,përpara shtëpisë u ndal edhe një veturë. Para dolën dy djem,që unë nuk i njihja,pastaj edhe një grua,që edhe atë nuk e njoha,i fundit doli një burrë që në fillim nuk e njoha,por si u afrua pak mu kujtua se dikur e kam pasur nxënës, nipi i z. Qamilit. Së pari më përshëndeti gruaja dhe fëmijët,pastaj u afrua edhe z. Qemali që s'ishim parë afër njëzet vite. Ai më tha:

-Mësues,aspak s'jeni plakur. Jeni si dikur,kur hynit në klasë me ditarin në dorë me plotë pedanteri. Akoma më kujtohen eksperimentet nga Bazat e Arsimit Teknik dhe ata të Fizikës. Ne edhe sot jemi me ju,por edhe krenohemi,këtu në perëndim shpesh na vinë veprat e Juaja. I thash të

faleminderit për komplimentet,duke shikuar ndryshimet e tij në trup dhe fytyrën e tij të dikurshme i thash:

- Ajo ka qenë përpara tridhjetë vitesh,tash jam plakur dhe ndihem i lodhur. Po ashtu iu falënderova që interesohen për veprat e mija,se ata janë që më mbajnë të gjallë,në këtë kohë të pa kohë. Ne do të vazhdonim bisedën,por në atë moment z. Bashkimi na solli nga një pjatë me plotë mish të pjekur,kurse z. Agimi na i vuri përpara birrat e ftohta,kurse z. Qamili u ngrit në këmbë dhe duke më uruar mirëseardhje i cakërruam gotat. Haja e drekës vazhdoi deri nga ora njëzet,kur fëmijët e z. Bashkimit e sollën topin dhe të gjithë dolëm,aty pas kopshtit ku ishte fusha e sportit për banorët e lagjes.

Si u freskuam pak me lëvizjet nëpër fushën e sportit,prapë u kthyem te tryeza,pimë nga një birrë dhe herë,herë me pirunët merrnim nga një copë mishi. Kjo vazhdoi deri aty ka ora njëzetedy kur edhe rrezet e fundit të diellit u fshehën diku pas maleve të larta dhe të largët duke na e ftohur pak kohën,por akoma ndihej mermë e mishit të pjekur,që prushi në çdo moment ishte i gatshëm të vazhdonte me punën e vet.

Aty nga ora njëzetekatër Aurelën e vogël në krevatin ku flinim me gruan e zuri gjumi. Erdhi Teuta e mori dhe e çoi te dhoma e saj,ku sipas ligjeve të perëndimit fëmija duhej të flejë në dhomë të vet,pa prindër...?!

30. 05. 2005
Paris

Aty nga ora nëntë e tridhjetë prapë dëgjova zërin e Aurelës,që ishte zgjuar dhe lëshonte ca zëra,me siguri ta dëgjonte nëna e vet,apo dikush tjetër. Ajo kur u bind se

askush s'lëvizte ia tha të qarit. Unë u ngrita dhe shkova në dhomën e saj,por ajo ia tha edhe më tepër. Trokita te dera e Teutës,që ishte gjysmë e hapur,atëherë ajo dëgjoi se qante Aurela,dhe duke fërkuar sytë u lëshua në drejtim të dhomës ku i flinte vajza,duke më thënë se është e rraskapitur,prej ditës së djeshme,bile tha se edhe Agimin se ka dëgjuar kur ka shkuar në punë. Aurela u ndal së qari dhe u mbështet në kraharorin e mëmës së vet.

Poshtë në katin ku banonin prindërit e Agimit s'dëgjohej asnjëfarë zhurme. Teuta së bashku me Aurelën nisën të zbritnin shkallëve kurse unë shikoja qershinë duke pritur të shikoj atë zogun,që bënte luftë me frytin e porsa filluar të skuqej. Gruaja doli prej banje dhe filloi të vishej ,duke më pyetur për Aurelën dhe Teutën. Në atë moment Teuta më tha që të zbrisnim,pasi të gjithë kishin shkuar në punë,dhe kafeja ishte gati. Unë zbrita e mora Aurelën dhe dola në kopsht,ajo më shikonte dhe qeshte. E ngrita lart,që të këpuste ca gjethe dhe u drejtuam në drejtim të kuzhinës,kgruaja dhe Teuta më e kishin pirë kafenë,dhe Teuta e ndezi shporetin elektrik që të përgatiste mëngjesin,kurse unë i thash që të mos bënte gjë,por të ngrohte prej ushqimit të djeshëm,bile s'kishte nevojë të bënte as drekë,se është mëkat të hidhej ajo që kishte ngelur prej ditës së djeshme.

Në atë moment ra telefoni dhe Teuta më tha se ishte për mua. Andej ishte z. Qamili,dhe më pyeti a kam fjetur dhe pushuar mirë,duke kërkuar falje se atë ditë ka pasur disa takime me bashkëpunëtorët e vet,dhe ka qenë e pa mundur që ti anulonte,pasi do të na prishej rendi prej ditës së nesërme,duke qeshur tha se do të kërkonte pushim vjetor,prej drejtorit,z. Bashkimit,djalit të vet.

Aty nga ora shtatëmbëdhjetë prej pune u kthye z. Agimi dhe sa hëngri bukë,së bashku me mua,gruan

time,Teutën dhe Aurelën u nisëm në drejtim të Portës Triumfale.

31. 05. 2005.
Paris

Disi u mësova me kushtet e klimës franceze,por edhe me kohën,edhe pse dielli perëndonte shumë vonë. Sot në mëngjes më doli gjumi shumë herët,edhe meqenëse isha zgjuar disa herë natën. Bile njëherë u zgjova përnjëherë me Aurelën. Ngadalë të mos e zgjoja gruan u ngrita prej krevati e hapa derën dhe u futa në dhomën e Aurelës së vogël. Ajo i kishte hapur syçkat dhe vështronte djathtas,majtas e lart në tavan. Kur më pa mua qeshi,unë e kapa për dore,ia mbulova kokën e vogël dhe i thash:

Fli, gjyshi është këtu, edhe gjyshja është, por ajo fle si qengj se është e lodhur. Duke i folur ngadalë,pëllumbeshën e gjyshit e zuri prapë një gjumë i ëmbël,kurse unë prapë ngadalë u futa në krevat,ku pak më parë më kishte dalë gjumi. Duke menduar,për të zgjuarit e shpeshta të Aurelës,ndoshta ajo nuk dëshiron në një dhomë të flejë e vetmuar,por ndoshta edhe frikohej.

Prej një zhurme të vogël prapë më doli gjumi,por tash më ora ishte shtatë e tridhjetë minuta. U koncentrova në atë zhurmë,por u binda se Aurela e vogël flinte,kurse zhurmën e kishte bërë baba i Aurelës,që përgatitej për të shkuar në punë. Ai për çdo ditë në atë kohë shkon në punë. Edhe meqenëse është profesor kimie,punon në një bankë si mirëmbajtës i kompjuterëve,pasi ka mbaruar edhe disa kurse gjatë studimeve,dhe është bërë specialist i tyre,por edhe rrogën e ka shumë më të madhe se sa të punonte në arsim.

Mua më nuk më merrte gjumi,prandaj e morra ZEKTHIN e Kaloshit dhe fillova ta lexojë prej fillimit. Ashtu duke lexuar nuk di si më vajtën sytë te ora e murit,ku gjatë tërë kohës më shoqëronte me tiktaket e saja,dhe akrepat tregonin plotë orën nëntë. Nuk shkuan as tre a katër minuta dhe alarmoi Aurela,se më ishte koha kur ajo duhej të pinte qumështin e mëngjesit. Nëna e vet shpejt u fut në dhomën e saj,por edhe unë si e lash Zekthin i vendova syzat mbi tavolinë e hapa dritaren dhe u drejtova në drejtim të dhomës së Aurelës. Kur unë hyra brenda ajo më biberonin e mbante me dy doriçkat e vockla. Sa më pa e lëvizi kokën dhe bëri si më të qeshur,por nuk e hoqi biberonin nga goja.

Teuta duke zbritur shkallëve teposhtë kishte parë z. Qamilin në kopsht e kishte përshëndetur,por ai e kishte pyetur,se a jam ngritë unë. Teuta u kthye që të më tregonte,por unë e dëgjova bisedën dhe u nisa në drejtim të shkallëve,që të zbrisja poshtë. Atëherë z.Qamili ishte nën hijen e qershisë. Më përshëndeti dhe më tha se ai një kafe e kishte pirë qysh në ora tetë,dhe mezi priste të pinte të dytën me mua. Teuta hyri në kuzhinë e kishte venduar xhezven dhe doli të na pyeste çfarë kafeje donim. Unë i thash si do qoftë vetëm na e sjellë përjashta,kurse z. Qamili i rregulloi karriget e plastikës dhe mbuloi tavolinën me mbulojën që ishte e palosur aty në skajin e tavolinës,dhe tha se do të shkonte të merrte sakarinën,pasi të dy vuajmë nga Diabeti.

Si i pimë kafetë z. Qamili duke më kërkuar falje tha se do të shkonte të merrte dy fëmijët e z. Bashkimit,pasi edhe disa minuta u mbarojnë orët e mësimit,sepse nëna e tyre ka disa javë që ndjek një kurs të gjuhës frënge.

Aty nga ora pesëmbëdhjetë dolëm prej shtëpisë,që me z. Qamilin të vizitonim,kishën SACRE COUR,dhe do të ishte hera e parë që unë do të udhëtoja me METRO. Me të vërtetë metroja është një mrekulli njerëzore. Si stacion i parë prej ku hipnim ishte Noisy le Grand,kurse ai fundit që zbritëm ishte

Nation,ku ai ishte si qendër,prej ku ne mundeshim të lidhemi me shumë qendra të jetës kulturore. Z. Qamili e njeh mirë Parisin,pasi aty ai është rritur dhe plakur.

Aty nga ora shtatëmbëdhjetë arritëm përpara kishës dhe filluam të ngjitemi shkallëve të kodrës përpjetë. Koha ishte e mirë dhe vizitorët ishin të shumtë. Disa minuta u ndalëm duke parë fasadën e përparme,e pastaj hymë edhe brenda. Aty kishte edhe vizitor,por edhe prej atyre që kishin ardhur të bënin lutjet e ditës. Ne bëmë një rrotullim dhe u ulëm për të parë tavanin e kishës,që ishte shumë i lartë,por edhe i stolisur me shumë piktura dhe freska të Shenjtorëve. Pak më larg nesh një klerik masës përpara tij u tregonte diçka por ne as që ia venduam veshin,dhe as dëgjuam se çfarë u thoshte edhe meqenëse ishte një qetësi apsolute. Aty afër nesh u ndalën disa persona dhe njëri u tregoi diçka,por njëri nga ata të sigurimit u afrua tha u tha se aty nuk bëhej fjalë,por vetëm lutje,se ajo është Shtëpi e Zotit. Ne pasi pushuam pak, u çuam që të shikonim ata bukuri përrallore. Vizita e kishës brenda na mori mbi një ore,pastaj dolëm mbrapa saj ku rrugës ka piktorë të shumtë,që bënin portretet e kalimtarëve të rastit,por disa edhe i shitnin pikturat e tyre,me një çmim të arsyeshëm. Ne u ndalëm të shikonim një piktor mjaftë në moshë, që pikturonte një fëmijë. Nëna e tij ishte një evropiane,por fytyra e fëmijës tregonte një fytyrë kinezi. Baba i fëmijës e pyeti prej kur ka filluar të pikturojë,ai iu përgjigj shkurt:

-Këtu jam rritur dhe filloi të pikturojë duke qeshur,kurse unë me z. Qamilin hymë në restorantin aty përballë,për të shuar etjen dhe urinë.

1.06. 2005
Paris

Duke e pirë kafenë e mëngjesit bënim edhe planin e vizitave të ditës. Për këtë ditë qysh ditën e djeshme z. Qamili tha do të vizitojmë disa lagje të Parisit,që me të vërtetë për mua do të jenë shumë interesante. Deri aty ka ora njëmbëdhjetë e tridhjetë minuta ne kishim hëngër edhe mëngjesin. Unë lozja me Aurelën,kurse z. Qamili ujiste lulet dhe disa rrënjë domatesh,që i mbollëm një ditë më parë.

Unë gruaja dhe Aurela e vogël përpara shtëpisë së z. Qamilit

Sot ishte dita e parë në jetën time,që do të udhëtoja me Aero erin. Si çdo ditë tjera edhe sot,siç tha z. Qamili tollovia nuk mungonte. Ne pas tre apo katër stacioneve zbritëm dhe u drejtuam në drejtim të lagjes,dhe si ecëm disa minuta z. Qamili më tha se tash më jemi në atë lagjen që më kishte folur ditën e djeshme,por edhe në mbrëmje. Unë e pyeta për emrin dhe e nxora bllokun e shënimeve,dhe shkrova fjalën PIGALO,duke e pyetur z.Qamilin,se a e kam shkruar fjalën mirë,kurse ai më tregonte se ajo lagje ishte lagje e argëtimit e veçanërisht gjatë natës,dhe u ndalëm përpara një lokali që të lexonim programin e ditës,por edhe të natës. Atëherë një femër na u afrua dhe na tha se me dhjetë euro mundemi të shikonim një program të bukur,ku në ato dhjetë euro është përfshirë edhe një pije,dhe pastaj sipas qejfit ju do të vendosni vetë. Ne si lexuam programin iu falënderuam asaj për sqarimet dhe vazhduam rrugën,ku pas disa minutash u futëm në një restorant,për të pirë nga një pije freskuese,se ishim lodhur por edhe koha bënte pak nxehtë. Pronari i restorantit ishte një turk,mjaftë në moshë dhe z. Qamili e njihte,pasi dikur ka banuar në atë lagje. Aty vendosëm edhe të drekonim,pasi unë edhe nuk dyshoja në ushqimet e përgatitura,por edhe personeli punues ishin më shumë turq.

Duke pirë lëngjet,por edhe gjatë drekimit hapëm shumë tema,në mesin e tyre z. Qamili më tha se do të jetë mirë,që një ditë të vizitonim piktorin dhe bashkëvendësin e tij,por edhe timin me renome botërore,z. Omer Kaleshin. Më tha se po të vish në Paris dhe nuk e viziton atë,veçanërisht për ne që jemi kërçovarë do të thotë se nuk ke vizituar as Kullën e Afelit,por as Muzeun e Luvrit. Unë u pajtova,por me një rezervë duke i treguar se dikur kemi pasur një polemikë,në Shkup së bashku me avokatin dhe shkrimtarin z. Numan Limanin dhe shkrimtarin z. Kalosh Çelikun për biografinë e tij të shkurtër dhe të shkruar nga ambasadori i Maqedonisë këtu në Francë,që për mendimin tonë është qëllimkeqe.

Biseda u zhvillua në hotel BRISTOL,ku aty e prisnin edhe një grup gazetarësh maqedonas,ku poenta ishte mu për prejardhjen e tij,dhe incizimin e një dokumentari për jetën dhe veprimtarin e piktorit të madh z. Omer Kaleshit. Aty për aty ai i refuzoi gazetarët dhe biseda e jonë vazhdoi gjer vonë në mbrëmje me plotë polemika. Unë vazhdova për në Kërçovë kurse ato kishin vazhduar me bisedën,por edhe të nesërmen z. Numani e kishte shëtitur nëpër vendet turistike të rrethinës së Shkupit dhe veçanërisht kishat dhe manastiret,kurse në mbrëmje kishte pasur disa biseda me gazetarët e "Flakës",por edhe ata të radios dhe televizionit në gjuhën shqipe. Pas disa ditësh u takuam në Kërçovë,por tani më situata kishte ndryshuar dhe bisedat merrnin drejtim tjetër. Por unë i ngacmuar prej asaj biografie e shkrova një poezi "MERIMANGA NË PARIS" dhe e botova në gazetën Flaka,pastaj edhe te vepra ime me poezi "COPËTIM NATE". Në një takim tjetër unë ia dhashë ta lexonte poezinë,ai nuk tha gjë,por e futi në xhep dhe vazhduan me z. Safet Purellkun një kushëri për nga nëna,historian te shtëpia tij ku ishte vendosur. Z. Omeri me siguri që poezinë e kishte lexuar disa herë në dhomën e vet,dhe të nesërmen kur u takuam e vërejta se ishte i prekur. Prej atëherë më s'jemi parë,dhe biseda e para dy muajve kur Ju ia kishit dhëne numrin e telefonit tim në lidhje me z. Safetin nuk zgjati shumë dhe ndoshta nuk do ti bëhej qejfi që ta vizitojmë.

Z.Qamili e ndezi një cigare edhe meqenëse nuk është adhurues i duhanit. U mendua pak dhe më tha:

-Unë do ti paraqitem në telefon,pasi disa muaj që s'jemi takuar dhe dëgjuar, kurse në fillim kur erdhi në Francë jemi takuar shumë shpesh,bile vikendeve shumë herë zonja e ime na ka bërë lakror Kërçove, apo Sërbice që z. Omeri e adhuron së tepërmi. Unë i thash s'ka problem,por të mos insistojë që të takohemi nëse ai vet nuk shpreh vullnet dhe interes.

Gjer vonë ecëm rrugëve të asaj pjese të Parisit. Aty ka ora njëzetedy z. Qamili më tha që të hanim darkë,por unë nuk lejova duke thënë se do të hanim në shtëpi. Dhe u nisëm në drejtim Ero erit.

Sa arritëm në shtëpi z. Qamili e gjeti numrin e piktorit dhe iu paraqit,duke i kërkuar falje që ishte aq vonë,por z. Omeri prej andej i tha se për te koha e trazimeve është herët në mëngjes gjer ka ora njëmbëdhjetë kur ai bënë gjumin më të mirë. Biseda zgjati pak si tepër duke pyet për hallet e njëri tjetrit,por edhe për ndonjë lajm nga vendlindja. Në fund z. Qamili i tha se për vizitë te ai jam unë,dhe sa ia përmendi emrin atij iu kujtova,dhe menjëherë pyeti duke thënë:

-Ai poeti?! Sa mirë paska bërë. Do të më bëhej qejfi,po të më vizitonit,me të vërtetë do të ndihesha i nderuar. Z. Qamili i tha se do të qëndroja një kohë më të gjatë dhe caktuan edhe takimin përpara se të mbylli telefonin.

2. 06. 2005
Paris

Sot aty ka ora dhjetë nën hije të qershisë,pimë kafen e mëngjesit,duke biseduar për ato pak të mbjella që kishte në kopsht. Unë i thash se krejt ishte në rregull,por patatet nuk i kishte mbushur mirë me dhe ashtu siç kanë nevojë dhe me lejen e tij e morra shatin dhe fillova tu hidhja edhe pak dhe,kurse z. Qamili pastronte barërat e këqija nëpër kopsht. Unë sa mbarova punën e filluar,Teuta me Aurelën na sillnin një shishe më lëng pemësh dhe mëngjesin e përgatitur kurse z. Qamili duke i parë patatet si ishin mbushur me dhe,i tha Teutës:

-Babi yt paska qenë edhe një bujk i mirë. Ajo duke qeshur i tha:

-Babit çdo punë i shkon për dore,domatet në kopshtin tonë rriteshin mbi një metër dhe kishin disa kat me fruta. Unë e morra Aurelën dhe e ngrita lart që të këpuste qershia. Ajo duke qeshur i këputi dy qershi dhe i shikonte e habitur,në atë moment arriti edhe gruaja me pjesën tjetër të ushqimit dhe filloi të rregullonte tavolinën,që ndodhej nën hije të qershisë. Pas ushqimit luajtëm shah,por gati të tëra i nxirrnim remi.

Fiks në ora pesëmbëdhjetë e tridhjetë minuta ishim te dera e ndërtesës së z. Omer Kaleshit,për fat dera ishte e hapur,dhe nuk kishte nevojë që z. Qamili të nxirrte notesin që të shikonte kodin për hapjen e derës. Nëpër një korridor dolëm mbrapa ndërtesës ku ndodhej ashensori i montuar,përpara disa vitesh edhe atë vetëm për dy persona,apo një më i plotë. Ndërtesa ishte tetë katesh dhe banorët ishin shumica të moshuar,dhe pa familje.

Me ashensorin arritëm shpejt në katin e tetë atje nën kulm ku ndodhej banesa e piktorit. Sa i ramë ziles dera u hap dhe përpara na doli zotëri Omeri,si përherë me fytyrë të buzëqeshur. I veshur krejt në të zeza. Me flokë të gjata dhe krejt të bardha dëborë dhe të rregulluara për bukuri. Na përshëndeti duke na marrë ngrykë.

Banesa ishte e shndërruar në atelie,e rregulluar prej dorës së vet piktorit,me mindere të shtruara mbi nime,kurse në hyrje ndodhej edhe banja e hapur,prej aty edhe ca shkallë ku i ndodhej krevati,po ashtu i bërë prej dërrasave të trasha prej dorës së vet piktorit,dhe me gjithë këtë vend që e përdorte si dhomë gjumi ishte pesëdhjetë metra katror,përndryshe do të kishte dhjetë më pak. Banesa ishte e dekoruar me elemente të fshatit të vet të lindjes. Si për shembull një karrige me tri këmbë dhe mjaftë e vjetër,një samar,një anxhik disa jastëkë të leshtë,një sofër të vogël me tri këmbë,disa velenxe të vejtura në tullar,disa palë çorape të thurura me një shtizë siç u thonë në vendlindjen e piktorit e shumë gjëra të marra prej fshatit të vet të lindjes,por edhe një elektromotor të vjetër,që ia kujtonte

punësimin e parë buzë Vardarit në Shkup si elektroteknik. Në afërsi të tij edhe një tezgjah zdrukthëtari me plot alete të ndryshëm,që i shërbenin gjatë punimeve të kornizave të pikturave,por edhe të orendive në banesë. Aty në afërsi të vendit që e përdorte si kuzhinë ndodhej edhe mbështetësja të blerë në një treg të Parisit të një mjeshtri të madh të pikturës,që i shërbente për pikturim.

Në tavan,ku prej krevatit s'kishte më shumë se një metër lartësi ndodhej një dritare për ajrosje,por kuptohet se vetëm kur ishte koha e mirë. Në anën e lindjes ndodhej një raft plote e përplot me libra,kurse në afërsi të tij një oxhak i improvizuar me saç, çerep dhe mbi te një telefon mjaft i vjetruar dhe po ashtu një GACË siç i thonë në vendlindjen e piktorit kandilit me vaj guri për ndriçim.

Si u ulëm mbi mindere i bëmë ca llafe dhe mua mu drejtua e pimë nga një,e z. Qamilit do ti bëjë një çaj të Çelvjollcës(mal në afërsi të fshatit të lindjes së piktorit),që e ruaj për miq si z. Qamili. Gjersa z. Omeri i mbushte gotat unë shikoja edhe disa nga të veshurat e rrethit të Kërçovës,që ishin të varura në mur aty mbi oxhak:një palë këmbëza grash,një dizgë,një brez,një struke(setër prej leshi burrash me duar të shkurtra deri në bërryl),një kësulë të bardhë leshi,një palë tirq dhe disa gjëra të tjera.

Si i cakërruam gotat unë prapë i hedha sytë mbi murin përballë,që ishte i dekoruar krejt më elemente shqiptare të rrethit të Kërçovës e veçanërisht të fshatit të vet të lindjes,Sërbicës,kurse ai i KOHËS SË DHIVE në biografinë e shkruar nga dora e vet e paraqiste si maqedon apo si maqedon mysliman por edhe si turk...,kurse në banesën e tij s'kishte asnjë element të atyre. Ata që ishin të varura besoj se s'ishin bërë me dhunë,por me dëshirën dhe vetëdijen e vet piktorit. Gjatë bisedës unë ia dhashë kompletin e veprave të mija,por edhe ai ma dha një katalog të veprave të veta dhe një vepër të madhe të Kadaresë ku për piktorin ishin të shkruara disa faqe

nga vet Kadareja. Ku edhe ai ka bërë disa gabime për piktorin e madh të kombit shqiptar,por nuk e dimë a janë me qëllim,apo të mos dijes,dhe informimit dhe ngulisë në trurin e tij prej atij të kohëve të dhive.

Z.Omeri iu falënderua z. Qamilit që dikur ia kishte dhënë numrin tim të telefonit dhe ashtu nëpërmes meje ra në kontakt me z. Safet Purellkun. Biseda vazhdoi gjer vonë me tema të larmishme,por më tepër për ngjarjet në vendlindje. Disa herë i kapte me dorë veprat e mija dhe më thoshte se kam punuar mjaft,por unë e ndërprisja duke e pyet për shumë piktura që ishin të mbështetura për muri dhe disa të pa mbaruara,por edhe duke bërë disa fotografi,ai më përgjigjej,por disi më tepër i pëlqente biseda,për të kaluarën në fshatin e lindjes dhe ngjarjet e ndodhura në kohën e fundit e veçanërisht pas luftës,së UÇK-ës me forcat ushtarake dhe policore të Maqedonisë.

Duke shtrënguar duart u ndamë përpara ashensorit, duke uruar shëndet njëri tjetrit dhe z. Omeri më tha:

-Të ma përshëndesësh z. Safetin dhe si u afrua më afër më pyeti;çka bënë ai me studimet?!pak sikur i zgjati. Unë i thash se ashtu e ka jeta në vendlindjen tonë me probleme dhe vonesa,kurse ai ka pasur shumë probleme në jetë... U futa në ashensor ashtu i zhytur në mendime se vetmia dhe mos reagimi në kohë,te piktori kishin lënë gjurmë të thella dhembjeje. Ne më z.Qamilin u ndalëm edhe pak nëpër lagjen e piktorëve botëror,por duke komentuar edhe vizitën,e më së shumti për dekoret e banesës atelie të piktorit të madh shqiptar,që për z.Qamilin nuk ishte hera e parë të vizitonte atelien e z.Omerit.

Atë ditë edhe gruaja e ime me Teutën kishin shëtitur nëpër Parisin e bukur dhe kishin vizituar një çerdhe fëmijësh,që të punësuarit e kishin pritur shumë mirë e veçanërisht kur kishin kuptuar se gruaja e ime është e

punësuar në çerdhen e vetme në Kërçovë edhe atë qysh prej themelimit që edhe pak prej aty do të pensionohet.

Gruaja me fëmijët e çerdhes në një lagje të Parisit

Dhe prej aty kishin shkuar në atelienë e z.Qamilit,ku në mbrëmje ishin kthyer bashkë me zonjën e z.Qamilit djalin e tij z. Bashkimin,por edhe z. Agimin që prej punës së vet kishte kaluar andej,kurse Aurelën e vogël e kishin lënë te zonja e Bashkimit,që shumë e donë vajzën e tyre pesëvjeçare,Leonën.

3 . 06 . 2005
Paris

Edhe Aurela e vogël më nuk dëshiron të rri e mbyllur në shtëpi. Ajo cilin shikon të parin,mua apo z. Qamilin e kap për dore dhe niset në drejtim të kopshtit. Dhe sa del prej shtëpie shikon në drejtim të qershive më të skuqura,si i këput një ose dy fillon ti shikojë dhe i drejton në drejtim të gojës,por edhe pret që t'ia lajmë se më i është bërë shprehi duke ia marrë prej dore dhe ia larë te çezma,që ndodhet aty afër qershisë. Sa i fut në gojë i kic me dy dhëmbët tash më të rritur dhe prapë na shikon me habi me siguri prej shijes së lëngut të qershisë.

Sot edhe mëngjesin e hëngrëm pak më vonë,se është ditë e premte dhe z. Qamili për çdo të premteje apo siç thuhet ndër myslimanë xhuma ai shkon të falet e të lutet te xhamia e boshnjakëve. Për sot edhe mua mu lut,që të shkonim së bashku. Unë ç' është e drejta edhe pse jam autor i tri veprave me karakter fetar dhe shumë mirë janë pritur prej kritikës dhe të katërtin e kam gati,dhe jam i vetmi në Ballkan që deri tani ka shkruar asi lloji veprash, kurrë s'jam falur dhe lutur në xhami. Dhe shumica e besimtarëve habiten si mundet të jem autor i atyre veprave,e kurrë s'kam pasur afri me njerëz të fesë.

Unë nuk bëra shumë inat dhe aty nga ora trembëdhjetë pasi kishim hëngër bukë,ishim larë dhe kishim marrë abdes dolëm prej shtëpie,që sa më shpejt të kapnim metronë dhe në kohën e caktuar të ishin në xhaminë e boshnjakëve. Shqiptarët shkojnë atje se te turqit apo arabët nuk kuptojnë gjuhën,kurse xhami të vet akoma nuk kanë.

Xhamia ishte në një lagje të Parisit,që unë as nuk u interesova se si quhej,ajo ishte një ndërtesë disa katesh dhe në katin e parë një dhomë afër gjashtëdhjetë metra katror,që me

siguri ishte e përgatitur për kuzhinë,pasi kishte edhe nishë e pajisur me ujë,ku edhe merrnin lutësit abdesin. Ne kur arritëm xhamia ishte mbushur afër për gjysmë. Edhe hoxha ishte aty,dhe tregonte ndodhi dhe lexonte pjesë nga Kur'ani. Siç më tregoi z. Qamili se ai kishte ardhur nga Bosnja pak javë më parë dhe se ishte shumë i aftë,në vais dhe se ka marrë pjesë në luftën e Bosnjës dhe se është me gradë të lartë ushtarake,prej në ish Jugosllavinë e Titos. Ai edhe pas luftës ka qenë i punësuar në armatën boshnjake,por çfarë e ka shtyre të vinte në Paris të punonte si imam ai nuk dinte,por dinte se shkollën e mesme teologjike e ka kryer dhe pastaj ka vazhduar Akademinë Ushtarake në Beograd.

Hoxha si lexoi edhe disa Ajete,nga Kur'ani na u drejtua me fjalët"VËLLEZËR MYSLIMAN"dhe u çua nga vendi shkoi te televizori ku ndodhej edhe videoja futi një kasetë dhe na sqaroi se ai nga Bosnja ka sjellë shumë kaseta ku do të mundemi të shikojmë masakrat serbe ndaj popullit boshnjak të pafajshëm,veçanërisht ndaj fëmijëve,grave dhe pleqve. Po ashtu na sqaroi se disa javë me radhë do të jepet ky emision një orë përpara se do të falej namazi i xhumasë. Po ashtu dy ditë me radhë televizioni francez pas orës njëzet afër një orë jepte një emision për masakrat serbe në Bosnjë.

Gjatë ligjëratës së Hydbes hoxha foli për Hazreti Nuin dhe bëri një krahasim me barkën e tij dhe xhaminë. Duke thënë:

-Ata që hipën në anije shpëtuan edhe ata që do të vinë në xhami dhe s'do të bëjnë vepra të këqija ndaj njerëzisë do ti shpëtojnë derës së ferrit. Pas mbarimit të namazit të xhumasë imami foli për "VËLLAZËRIM BASHKIMIN" Jugosllav. Ai tha se serbët gjatë njëqind vjetëve të fundit kanë bërë disa masakra ndaj myslimanëve të Bosnjës,por edhe ndaj popujve të tjerë e veçanërisht ndaj Shqiptarëve,në ish trojet jugosllave dhe krejt në emër të atij 'VËLLAZËRIM BASHKIMIT" të nëmur. Ç' është më e keqja edhe tani pas

masakrave me shumë dredhi duan prapë të na kthejnë në atë vëllazërim bashkimin e tyre të pistë. Duke na thënë:

-Vëllezër të dashur mysliman,kjo që ndodhi duhej të harrohet,dhe lënë historisë të mos helmohen boshnjakët e vegjël,me tregime dhe shkrime. Kurse nuk ka natë që pas lajmeve në programet e tyre me orë të tëra tregojnë rrena të montuara,apo ata që i kanë bërë vet ndaj nesh, na i mveshin neve se i kemi bërë ndaj tyre. Këto fjalë mua më erdhën shumë interesante,se edhe në trojet tona shumë herë dëgjohen këto fjalë nga goja e maqedonëve sllavë. Mua mirë më kujtohet kur kam qenë i vogël kurrë s'kemi mundur të rrimë në odën e burrave duke na thënë se nuk duhej të dëgjonim fjalët e tyre. Ata s'kanë ditur të shkruajnë dhe krejt historitë e këtyre trojeve kanë ngelur si ndodhi të sllavëve dhe ata kanë shkruar historinë,krejt në dëm tonin dhe në dobi të tyre. Që do të thotë se ajo ka qenë porosi sllave,kurse populli ynë pa sherr naiv dhe i pa shkolluar u kanë besuar armiqve të vet. Edhe në vendin tim ka disa masakra ndaj popullatës shqiptare të pa fajshme. Siç është bunari Seferit me mbi njëqind burra të vrarë dhe të hedhur,po ashtu edhe bunari Sadetit te gështenjat e Osoit,dëllinjat e Cërvicës e shumë vende të tjera.

Këto hile dhe rrena sllave ndodhën edhe në vitin dymijë e njëshin,dhe si partitë sllavomaqedone,por edhe ata shqiptare na servojnë një ish vëllazërim të Titos. Dhe po ashtu flitet që të harrohet çdo e keqe që ndodhi,por në dëm tonin,kurse ata prapë vazhdojnë me avazin e vjetër. S'ka mbledhje Partallmenti siç i thotë Baca Salë-Kërçova,që maqedonët të mos vjellin kundër UÇK-ës,edhe meqenëse ajo s'ka bërë asnjë dëm masakër ndaj tyre,kurse ata ndaj ushtarëve të UÇK-ës edhe pas luftës,bëjnë atë ma të keqen. Kurse eprorët e tyre të rehatshëm rrinë nëpër kolltukë dhe shikojnë sehir,dhe heshtin edhe kur i thërrasin si SHQIPTARË-MAQEDON...???!!!

4. 06. 2005
Paris

Sot koha është me vranësira,por bënë edhe pak freskët. Me z. Qamilin si i pimë kafetë dolëm në kopsht,ku më mbjelljet përparonin mirë. Dhe prisnin pikat e shiut si fëmija qumështin e nënës. Pikat e shiut i priste edhe bari që z.Qamili e kishte kositur ditë më parë. Ne duke biseduar na u afrua z. Agimi,pasi sot është ditë e shtunë dhe ai nuk punon,prandaj edhe kishte fjetur pak më gjatë. Priti ne të mbaronim bisedën me z. Qamilin në lidhje me domatet dhe duke kërkuar falje mua më tha:

-Unë me Teutën do të shkojmë te një supermarket,që ndodhet pak si larg nga ata dhe po të desha të shkoj edhe unë me ata. Unë pranova me kënaqësi ofertën,por edhe z. Qamili më tha që të shkoja se kam çka të shohë atje. Unë dola në rrugë ku ndodhej vetura,pastaj erdhën Teuta me Agimin dhe gruan time,që në dorë mbante Aurelën e vogël,kurse Teuta një fletë të mbushur,plotë me emra artikujsh për të blerë. Unë e morra Aurelën dhe e hipa mbi veturë,ajo duke parë një mace në oborrin e shtëpisë përballë nesh filloi të qeshte duke shtrirë dorën në drejtim të maces.

Kur u kthyem prej tregut i rregulluam artikujt nëpër vendet e veta dhe u ulëm të pushonim. Z. Qamili me të shoqen kishin shkuar te atelieja,pasi tërë javën kishte shëtitur me mua,dhe disi akoma nuk kishte besim në aftësitë e fëmijëve,për punët në atelieje dhe sjelljen e tyre me klientët. Sot më tepër kishin shkuar për të rregulluar disa kostume të porositura special, se për atë punë z. Qamili është i specializuar.

Në duke biseduar me z. Agimin ra zilja e telefonit. Andej ishte e shoqja e z. Bashkimit. Teuta e kapi receptorin

dhe ajo i tha se fëmijët me padurim presin që ta dërgonim Aurelën e vogël.

Aurela sa e pa Leonën e vogël vajzën e z. Bashkimit,na harroi neve dhe u lëshua në drejtim të saj,por edhe dy djemtë e tij binjakë;Arbënori dhe Antigoni. Zonja e z. Bashkimit na thirri të pinim kafe,por ne e refuzuam duke i thënë se kishim pirë gjer në atë moment nga dy kafe. Unë e putha Aurelën,pastaj edhe gruaja,kurse z. Agimi i tha zonjës së z. Bashkimit se për atë ditë kishim planifikuar shumë vizita.

Si hipëm në veturë z. Agimi më tha se do të merrnim një rrugë që ai mendon se më pak do të kishte tollovi trafiku dhe se shumë shpejt do të arrinim deri te Kulla e Afelit,por do të ishte mirë sikur të kishim fat të gjenim edhe një vend parkim aty në afërsi.

Rendi ishte shumë i gjatë dhe unë nuk pajtohesha të humbim aq kohë për të hipur lartë në Kullë dhe se nuk do të mundja të rri aq gjatë në këmbë. Mendimin tim e refuzoi gruaja,por z. Agimi tha që të bënim një udhëtim me anije nëpër lumin Senë,dhe kur do të ktheheshim po të mos kishte shumë rend do të prisnim që të hipnim lart në Kullë. Me këtë mendim u pajtuam të gjithë.Si premë biletat pritëm afër njëzet minuta,tamam sa pimë edhe kafe aty afër ku ndalej anija. Udhëtimi ishte sa i këndshëm aq edhe interesant,por edhe më tepër tërheqës e bënte udhëheqësi i lundrimit,që tregonte dhe sqaronte se ku ndodhemi dhe çfarë historie ka ai vend. Më interesant ishte kur arritëm përpara Muzeut të Luvrit. Udhëheqësi tha se gjatësia e tij është gjashtëmbëdhjetë kilometra dhe po të vizitohej ashtu siç duhet një vizitori i duhen afër katër muaj.

Përpara kullës së Ajfelit

Udhëtimi zgjati afër një orë,kur u kthyem te Kulla e Afelit rendi ishte edhe më i gjatë. Gruaja u nervozua,por unë për të ia tërhequr vëmendjen i thash se u harxhua edhe filmi i tretë në aparatin tonë,por edhe më shumë kishim bërë fotografi te aparati i z. Agimit,pasi ai është digjital.

Pa humbur kohë vendosëm të vizitonim Trokaderon e pastaj Portën Triumfale.

Edhe te Porta Triumfale kishte rend,por jo siç kishte te Kulla e Afelit. Për disa minuta filluam të ngjiteshim shkallëve përpjetë,por duke pushuar dhe dikur arritëm lartë. Vërtetë ishte një mrekulli vetë Porta Triumfale,por edhe shikimi i tërë Parisit. Z. Agimi më tregonte për pjesët e Parisit dhe historitë e tyre. Gjatë tërë kohës blicet s'pushuan si ai i joni po ashtu edhe të tjerëve.

Aty nga ora njëzetenjë shkuam të hanim darkë te një restorant kinez,që ndodhet në afërsi të punës së z. Agimit dhe pronari i tij është një fis i një shoku të z. Agimit që e ka pasur gjatë studimeve. Prej Teutës dhe z. Agimin është shumë herë i vizituar. Dhe ja tash edhe ne ti shijonim specialitetet kineze dhe ishte hera e parë në jetën tonë që hynim në një restorant kinez.

Na sollën pirunë por edhe prej atyre shkopinjve të tyre që shërbejnë për ushqim, po ashtu na sollën edhe një palë për në shtëpi,të pa hapur.

Ushqimi ishte mjaftë i shijshëm,por me një erë të rëndë dhe gruaja për pakë do të vjellte,dhe hëngri vetëm prej sallatës së përzier,kurse ushqimin e hëngrën Teuta dhe z. Agimi. Në fund prej shtëpisë na sollën një pije speciale kineze.

Kur dolëm prej restorantit z. Agimi na tha që të shikonim në drejtim të Kullës së Aefelit që e zbukuronin dritat e shumta, prandaj edhe quhet qyteti i dritave. Ecëm edhe pak nëpër atë pjesë të Parisit dhe u drejtuam në drejtim

të shtëpisë. Arritëm aty nga ora njëzetekatër,ku na priste duke luajtur z. Qamili me Aurelën dhe Leonën. Aurela më e mërzitur për Teutën,sa e pa filloi të qajë,ajo e mori e mbështeti në kraharor dhe atë shumë shpejt e mori gjumi. Ne mbetëm edhe pak duke biseduar për Versajën.

5.06.2005
Versajë

Edhe pse sot u çuam shumë më herët se ditët tjera, ushqimi i mëngjesi ishte gati edhe atë petulla me kos si në Kërçovën tonë të dashur,të cilat i kishte përgatitur zonja e shtëpisë.

Pas buke pimë edhe kafe duke u tallur me të thënën e atij hoxhës,përherë kur e pyetnin se a do të pijë kafe ai thoshte;po, por pas buke më ka më shumë shije. Ne me z. Qamilin ishim gati,prandaj edhe dolëm në kopsht,kurse gratë përgatiteshin,që sa më parë të niseshim në rrugë,për në Versajë. Ne me z. Qamilin shikonim një fik të komshisë,që më i kishte rritur frytet,por tek tuk kishte edhe ndonjë të pjekur. Në atë moment në bahçe doli z. Agimi me Aurelën e vogël duke na thënë:

-Unë dhe Aurela jemi gati dhe shikoni sa bukur jemi veshur,mami i vet i ka bërë edhe kordele,kurse ajo mbante kokën lart në drejtim të qershive të skuqura. Unë u afrova e mora hopa,kurse ajo më kapi për veshi duke qeshur.

Edhe pse trafiku ishte shumë i dendur,ne aty nga ora dymbëdhjetë ishim në hyrje të Pallatit Mbretëror. Dhe shikonim djathtas e majtas të takoheshim me Teutën dhe z. Agimin,që udhëtuan me veturën e vete,kurse ne me veturën e z. Qamilit. Nuk shkoi shumë kohë edhe ata arritën përpara hyrjes,por Aurelën e vogël e kishte zënë gjumi. Ne kishim

bërë disa fotografi. Z. Agimin dikush e thirri në emër dhe ai u largua pak prej nesh që të bisedonte me te,kurse z. Qamili i tha të mos vonohet ose ai të shkonte të merrte biletat,por z. Agimi i tha mos u mërzit shpejt do të kthehem. Ashtu edhe ndodhi,pas disa minutash z. Agimi u kthye,por me biletat në dorë.

Siç thotë populli, se dita shihej qysh në mëngjes,ashtu edhe këtu shihej se ai vend qysh në fillim është një MREKULLI njerëzore, apo një vend PARAJSË,e kësaj bote. Përpara nesh shtrihej një hapësirë e pa fund,shikonim një park të gjatë dhe të gjerë,me tre liqenet njëri pas tjetrit. Ne u lëshuam parkut teposhtë me plotë rrugica dhe labirinte,shkurret të krasitura për bukuri dhe të një madhësie. Përafërsisht në çdo pesëdhjetë metra kishte nga një përmendore të personaliteteve të kohës civile apo ushtarake,të shtetit të Francës apo botëror,po ashtu ndodheshin edhe karrige për pushim të vizitorëve të shumtë.

Në Versaj unë, gruaja ime, z. Qamili gruaja e tij, Agimi, Teuta dhe Aurela e vogël.

Unë me z. Qamilin shikonim disa përmendore që ishin në varg,bashkëshortet u ulën të pushonin,kurse Teuta me Agimin u ndalën Aurelës të ia ndërronin pelenat,por edhe ta ushqenin. Sa mbaronte vargu i përmendoreve,aty në mes të disa drunjtëve,një park i rregulluar për mrekulli ndodhej edhe restoranti,që unë me z. Qamilin u ndalëm të pinim kafe,por edhe nga një lëng pa sheqer,të dy vuajmë nga diabeti,dhe ti

prisnim. Sa arritën z. Agimi na bëri nga një foto,pastaj u ulën edhe ata të shuanin etjen. Si bënë porosinë dhe kamerieri i solli,gruaja e ime tha që të bënim një foto të gjithë. Z. Agimi luti një nga kalimtarët e rastit,por një zezake që ishte me ta vullnetarisht e mori aparatin prej dorës së z. Agimit u afrua te Aurela e përkëdheli,e puthi në të dyja faqet dhe mori largësinë e nevojshme dhe na bëri dy fotografi,prej pozitave të ndryshme,që unë u binda se ajo ishte një eksperte e fotografimit.

Ajo rrugë vazhdonte ndoshta edhe disa kilometra,por neve s'na premtonte koha,prandaj morën anën e majtë,ku në drejtim tonin vinte një karrocë me dy kuaj të zinj,që shëtiste dy çifte të rinjsh si dikur oborrtarët mbretëror. Edhe përpara karrocës bëmë disa fotografi,dhe vazhduam rrugën. Nuk kaluam as njëqind metra,përpara na doli një grua e veshur bukur dhe iu afrua z. Agimit duke i thënë:

-Vini te ne,z. Agimi tha duke qeshur:

- Po zonjë. Ajo duke iu falënderuar tregoi me dorë se teatri i tyre në qiellin e hapur ndodhet prej aty afër pesëdhjetë metra në anën e djathtë,dhe se pas pak minutash do të fillojë një dramë e Molierit të madh. Ne vazhduam në drejtim të teatrit ku një grumbull vizitorësh pritnin në rend,kurse disa ishin ulur nëpër karriget e teatrin gjysmë rrethi me binën në mes,për çdo njërin vizitor artistët ishin afër,dhe çdo fjalë e tyre dëgjohej shumë qartë. Ne u ndalëm disa minuta,por jo deri në fund të shfaqjes,pasi s'na premtonte koha dhe unë desha sa më tepër të shikoja. Ashtu vazhduam nëpër parkun me plot bukuri deri sa arritëm te parku botanik,që ndodhet përpara daljes në anën e majtë të Pallatit Mbretëror. Aty kishte të mbjella nëpër vazo;pemë,dru dhe bimë prej tërë rruzullit tokësor.

TEATRI I HAPUR I VERSAJËS

Sa mbaronte parku botanik fillonte sheshi përpara Pallatit pa dru,pemë dhe shkurre,por me lule të llojllojshme. Aty u ulëm pushuam pak duke komentuar me z. Qamilin dhe z. Agimin,që për ata nuk ishte ndoshta aq interesant se ata kanë qenë edhe shumë herë më parë e veçanërisht për z. Agimin,që disa herë e ka vizituar si student, por për mua dhe gruan time vërtetë ishte një ndër vizitat më me vlerë dhe interesante në jetën tonë.

Në të dalë prej Pallatit,na pritnin shumë shitës të çikërrimave të ndryshme,dhe më shumë ishin zezakë. Teuta s'di pse thirri:

-Mami prit pak,dhe njëri nga ata zezakët,po ashtu thirri mami prit pak,me duart e zëna me plotë çikërrima. Unë ktheva kokën,por ai prapë thirri të njëjta fjalë,unë u afrova e kapa për krahu dhe e thirra z. Agimin të na bënte një fotografi duke i thënë në gjuhën shqipe se shumë bukur i shqiptoi fjalët,në atë moment arriti edhe gruaja dhe bëmë një fotografi me zezakun që foli shqip,përpara Pallatit Mbretëror të Versajës.

Rrugës kaluam mirë dhe aty nga ora nëntëmbëdhjetë ishim në shtëpi. Zonja e z. Qamilit na bëri kafe na luti që diçka të hanim,por ne s'deshëm,pasi kishim hëngër në një restorant të Versajës,dhe duhej sa më parë të niseshim në darkë te një kushëri i jemi,që banonte në Parisin nëntëdhjetetre dhe është i martuar me një marokene.

Pas dyzet minutash udhëtimi arritëm përpara shtëpisë të kushëririt,z. Rexhep Limanit. Për mua dhe gruan time ishte hera e parë që i vizitonim. Aty na pritnin gruaja e z. Rexhepit me fëmijët dhe gruaja e z. Nexhbudinit,të vëllait të z. Rexhepit,kurse z. Rexhepi ishte te shtëpia,që e kishte blerë pak kohë më parë dhe bënte disa renovime. Unë me z. Agimin nuk hymë brenda,e parkuam veturën përpara shtëpisë dhe shkuam drejt te z. Rexhepi. Ai në atë moment ua paguante mëditjen disa shqiptarëve të Shqipërisë,që disa muaj janë në atë lagje dhe punojnë punë ndërtimtarie. Si e shëtitëm shtëpinë kat më kat,shkuam te kafeneja që ishte aty afër. Mua më porositi një pije që se kisha pirë kurrë në jetën time,që ishte përafërsisht si Uzoja greke,kurse z. Agimi mori një birrë,z. Rexhepi një lëng pemësh duke na thënë se ka afër tre muaj që s'ka futur alkool në gojë,prej atëherë kur me mua kishim pirë në Kërçovë te restorant "ELITA'.

Aty nga ora njëzetenjë u shtrua darka,por me një vërejtje të gruas së z. Rexhepit,që se kishim marrë edhe z. Qamilin dhe zonjën e tij. Unë u arsyetova se ai ndihej shumë i lodhur,që ishte edhe e vërtetë. Ajo me ato pak fjalë që i ka mësuar shqip duke ardhur në Kërçovë më tha :

-Do ta paguani shtrenjtë,edhe ti edhe z. Qamili. Unë duke qeshur i thash se do ta paguaj kur do të vijë në Kërçovë,edhe atë te Picerija "Roma". Ajo tha se edhe dy vajzave edhe djalit shumë u pëlqen vendlindja e babit,dhe se shumë e duan Haxhi Babën,apo si thoni JU Babagjyshin.

Darka ishte shumë e shijshme dhe e bollshme,hëngrëm ngadalë afër një orë. Dhoma ishte e vogël, dhe filloi të bënte nxehtë, prandaj dolëm në oborr ku na sollën fryte të llojllojshëm,por edhe pije freskuese,ku vazhduam deri në ora njëzetetre,duke u premtuar se gjatë kohës që do të ishim në Paris do ti vizitonim edhe njëherë tjetër.

6. 06. 2005
Paris

Edhe pse qershor moti këtë bënë shumë ftohtë,shiu që ra tërë natës dhe vazhdon të bie është mjaftë i ftohtë si breshër dhe mjaftë i furishëm. Unë disa herë e hapja dritaren,që të dëgjoja atë zërin e atij zogut të zi,që tërë natës netëve të tjera hante qershia dhe këndonte për qejf të vet,dhe aspak s'mërzitej se unë shqetësohesha në pikë të natës.

Z. Qamili ishte çuar si çdo ditë kur gruaja e tij dhe z. Bashkimi shkojnë në atelie. Të fillojnë me punën e re ose të mbarojnë atë që e kanë lënë në mbrëmje vonë. Ai si çdo ditë një kafe e pinë ose me gruan e vet,ose si shkon ajo në punë. Edhe sot kishte dalë në bahçe të shikojë të mbjellurat,por siç më tha se ishte kthyer menjëherë jo vetëm prej shiut të furishëm,por edhe prej të ftohtit.

Sot unë pak përpara se Aurela e vogël të jepte shenjë se ishte e zgjuar,kisha marrë “Zekthin” e Kaloshit dhe lexoja aty kah mesi,faqen që në fillin shkruante “AGOLLÇE”. Ajo sa dha zërin,unë u çova dhe u futa në dhomën e saj,ajo më shikoi dhe e shtriri doriçëkën me siguri më tregoi se i kishte mërdhi,prej shiut aq të ftohtë. Unë i thash se tash do të shkojmë poshtë, te babagjyshat do të pimë kafe,kurse ajo së bashku me ne qumështin e mëngjesit. Ne duke biseduar në dhomë hyri Teuta duke qeshur me bisedën time dhe të Aurelës. Ajo na tha se z. Qamili na priste poshtë,dhe se lexon librin e Luan Ramës,që ia përkushton piktorit z. Omer Kaleshit. Unë morra hopa Aurelën dhe hymë në dhomën e gjyshes dhe ia vendova mbi kokë të saj,duke i thënë:

-Çohu,se vetëm ti fle në këtë shtëpi,ne prej kur jemi zgjuar. Teuta duke qeshur e mori,prej te koka e nënës së vet,duke më thënë se është e lagur duhej t’ia ndërronte pelenat. Unë kur dola prej banje Aurela me doriçkat e vogla mbante biberonin në gojë duke mos hekur as frymë që sa më parë të shuante urinë. E lash ta pinte rehat qumështin, unë zbrita shkallëve duke parë qershitë e lagura,prej shiut aq të ftohtë. Sa hyra në kuzhinë z. Qamili e la librin dhe më pyeti si kam fjetur,nata ka qenë e ftohtë tha. Unë si i thash se kam fjetur mirë,e pyeta për librin,që kishte filluar ta lexojë. Ai më tha se është shumë interesant,por se kam pasur të drejtë që dikur e kam shkruar poezinë “MERIMANGA NË PARIS”.

MERIMANGA NË PARIS
-Omer Kaleshit-

Harqet e Urës së Gurit
Ia dërmonin trurin
Si elektromotori në punë
Ai zhurmën e kthente
Në spektër ngjyrash
Si lulet e bukura të
-CHAMP ELIZES-
Ku atelieja e priste
Artistin Kapuç Bardhë
Në atarin e Vejushës së Zezë
Ku nënën se kalb Toka e Hënës me yll
Duke ju lutur Zotit të Senës
Për birin e urtë,duke mallkuar
Merimangën e Zezë për shpifjet
E shekullit njëzet dhe pluhurin
Që i hedhet botës së prishur
ARTISTI QESH E QANË SHQIPTARÇE...

Unë thash se do ta lexoj kur do të shkoj në Kërçovë. Ai u çua që të vinte kafen,por unë nuk e lash duke i thënë se tash do të vinë Teuta dhe gruaja e ime,ai më tha se një kafe e ka pirë si përherë,por për mua. Dhe më pyeti për sot çfarë plani kam,ku do të shkojmë,pasi bënë ftohtë dhe bie shi. Unë i thash ku të dojë ai dhe mendon se për mua do të jetë interesant. Atëherë tha do të vizitojmë Qendrën Tregtare të Parisit,tha janë disa kate dhe në katin e fundit ka restorante të

bukur,ku prej atje duket i tërë Parisi. Tamam sikur kemi hipur te Kulla e Afelit,dhe ka disa teleskopë të vegjël.

Aty nga ora pesëmbëdhjetë shikonim orët e shtrenjta të Zvicrës të florinjta dhe të dekoruara shumë bukur.

Dalëngadalë arritëm në katin e fundit u ulëm në njërin nga restorantet dhe duke pirë kafetë shikonim pjesë të Parisit dhe shiun që binte me një mërzi dhe pendohej që pengonte vizitorët e largët që kishin ardhur të shikonin kulturat e shumta në Metropolin Evropian. Unë u afrova afër një teleskopi futa një euro dhe fillova të shikoj ata pjesë që me syrin tim s'mundesha.

Aty nga ora tetëmbëdhjetë ishim duke ngrënë në një restorant turk. Dhe bisedonim për tema të ndryshme,bisedën e ndërpreu zilja e telefonit të z. Qamilit. Andej ishte z. Bashkimi,pasi pyeti ku ndodhemi,i tha se na presin në atelie.

Me Metro udhëtuam afër gjysmë ore, dhe në ora njëzet ishim në atelie. Ata kishin ndërprerë punët dhe pastronin makinat. Z. Qamilit zonja e vet iu afrua dhe i tha:

-Jemi të shqetësuar dhe të mërzitur,ai u drejtua dhe i habitur e pyeti:

-Pse çka ndodhur?!Ajo i tha se nuk ka ndodhur gjë,por punëtorja e tyre një kineze mjaftë e re dhe punëtore e shkathtë,prej disa ditësh s'është ndier mirë,dhe se atë ditë ka qenë te mjeku. Pasi ka bërë disa analiza të gjakut dhe të tjera mjeku i paska thënë:

-Ty zonjushë të kanë ngelur edhe disa ditë jete,ti je e sëmurë,prej kancerit,dhe është faza e fundit,ku ke qenë deri tani,ne më s'kemi ç'të bëjmë. Kinezja tërë pas ditën kishte qarë aty në atelie,pasi në banesë s'ka njeri,të krejt familjen i ka në Kinë. Dy herë ka biseduar në telefon me të afërmit dhe kur i ka treguar nënës,asaj i ka rënë të fikur,edhe vëllezërit janë mërzitur shumë,ata janë shumë të varfër. Dorën në zemër edhe neve na erdhi shumë keq. Është shumë e re dhe mjaftë e bukur,me shkathtësitë e veta ka fituar mirë,dhe është kujdesur

për familjen... Brenda kohës telefoni ra dy herë. Teuta me z. Agimin dhe gruan time na prisnin në shtëpi,që të hanim darkë së bashku.

Aty nga ora njëzetenjë unë pasi e putha Ayrelën ia dhashë z. Qamilit,gruaja e ime bënte sallatën e freskët,kurse Teuta dhe zonja e z. Qamilit përgatitnin tryezën.

7. 06. 2005
Paris

Kur e pash orën, ishte dhjetë e tridhjetepesë minuta,kishim edhe dy stacione dhe do të arrin në atë të fundit,që quhej Nation. Prej aty do të merrnim drejtimin për në Notër Damë.

Duke ecur ndërruam mendimin,që së pari të vizitonim Sorbonën. Dhe aty ka ora dymbëdhjetë ishim përpara rojës me uniformë të Universitetit. Z. Qamili i foli në gjuhën frënge dhe i tha do fjalë duke më shikuar mua, roja na shikoi dhe e lëshoi derën duke na thënë urdhëroni. Ne hymë në oborrin e Universitetit të Sorbonës,ku në atë moment aty ishin një grup njerëzish mjaftë të moshuar,dhe bisedonin,përpara një dere. Z. Qamili e pyeti rojën kush janë ata njerëz, ai qeshi duke na thënë:

-Ata janë një grup profesorësh nga shumë shtete të botës dhe disa të vetë Universitetit, por prej atyre që janë më në zë, që presin pranim te Rektori. Më tepër nuk guxonim të rrinim brenda,prandaj ecëm edhe disa minuta rreth e rrotull dhe dolëm në anën tjetër ku ndodhet PANTEONI.

Edhe Panteoni është një mrekulli e veçanërisht për ne të Ballkanit. Në brendi të tij shikon mrekullitë e dorës njerëzore.Vizitorët e shumtë në grupe apo individuale,lëviznin me një qetësi të them absolute. Për ti përshkruar krejt ato mrekulli me siguri do të më duhen me ditë të tëra dhe faqe të

letrës pa fund,por porosia e ime do të jetë,ai që ka pak mundësi për këto që shkruaja pak më lart le shkojë ti vizitoj vetë.

Tash më ishim lodhur,ishim uritur,por edhe etur shumë. Z. Qamili më tha që të durojmë edhe ca minuta se aty në afërsi ka një restorant Pakistanez është shumë modern, ushqimet janë të kualitetit të mirë dhe shërbimi është mjaft në nivel.

Si hëngrëm drekën pushuam pak,dhe u lëshuam në drejtim të rrugës që të çonte në drejtim të xhamisë kryesore të Parisit. Ajo ishte e vetmja xhami me minare dhe shtrihej në disa mijëra metra katror. Si hymë brenda z. Qamili tha të shkonim te faltorja kryesore,por sa ecëm disa metra dolëm në një derë,pamë se ajo ishte prishur,dhe kishin filluar një objekt të rinj, dhe shumë më të madh,që me siguri do të përshtatej për lutje-falje,por me kushte shumë më të mira se si kanë qenë përpara. Prej aty u drejtuam një korridori që na çoi drejt e te një faltore. Brenda kishte shumë njerëz që kryenin sipas mendimit dhe dijeve të tyre lutje-faljet. Z. Qamili u largua pak që edhe ai të falte një pjesë të namazit të drekës,apo siç tha dy rekatë. Unë u afrova te një grup që këndonte në kor,ishin njerëz të moshave të ndryshme,por edhe të ngjyrave. E pyeta njërin që ishte afër dëgjonte dhe shikonte me vëmendje. Më tha se këndojnë MEVLUD,që edhe mua ma mori mendja,por në cilën gjuhë unë s'arrita ta kuptoj. Këndimi zgjati afër tridhjetë minuta,prej kur dëgjoja edhe unë. Një i ri që ndodhej në mes të turmës,shumë herë çohej në këmbë bërtiste më shumë dhe çonte duart lart. Z. Qa mili e pyeti atë personin që unë e pyeta pak më parë se kush do të ishte ai dhe ç' thoshte,ai iu përgjigj:

-Është një Palestinez,që ka marrë pjesë në luftë kundër izraelitëve,por në kohën e fundit s'është mirë me shëndetin. Si mbaruan të kënduarit sollën një ushqim të bollshëm me mish e me pije,që e venduan në dysheme të faltores dhe në grupe

filluan të hanin,por me traditën e tyre,pa lugë dhe piru. Me ta u ul edhe palestinezi,siç na thanë se ai tërë kohën e kalon në xhami,duke u lutur dhe falur për Palestinën e vet të shenjtë.

Vizituam edhe restorantin e xhamisë,në të cilin pimë nga një çaj të ngrohtë,deshëm të vizitonim edhe Muzeun,por në atë moment ishte i mbyllur. Ne do të vazhdonim të vizitonim edhe disa vende të tjera,por në telefon na u paraqit Teuta,duke i thënë z. Qamilit:

-U paraqit Agimi,dhe më tha se në mbrëmje do të vizitojmë Diznilendin.

Darkën e hëngrëm të tërë në shtëpi dhe aty nga ora njëzet,unë gruaja e ime Teuta dhe z. Agimi u nisëm për të vizituar Diznilendin. Prej shtëpisë së tyre ai ndodhe larg plotë tetëmbëdhjetë kilometra, rrugës nuk kishte shumë tollovi,prandaj edhe arritëm shumë shpejt.

Veturën e parkuam aty afër daljes për te treni më i shpejt në botë,dhe në atë moment ishte i parkuar dhe pas disa minutash do të nisej,prandaj edhe disa minuta ecëm nëpër stacion,gjersa edhe treni u nis.

Përpara hyrjes kishte një grup njerëzish që pritnin rend për të hyrë. Edhe ne u rreshtuam në atë rend,dhe për disa minuta ishim përpara hyrjes,ku bëhej një kontroll,mjaft rigoroz. Unë si i qita krejt sendet prej xhepi,dhe pas meje nuk kishte shumë njerëz që pritnin e futa dorën në xhep dhe nuk e nxirrja,njëri prej tyre më tha shpejto,unë qesha dhe i thash:

-Jo se kam bombë,z. Agimi filloi të qeshi dhe ju foli në gjuhën frënge,në atë moment unë nxora Ventolinën një aparat,kundër astmës për frymëmarrje. Njëri prej rojeve qeshi dhe u tha atyre dhe z. Agimit:

-Kolegë i imi,dhe e nxori prej xhepi të njëjtin aparat,mua më dha dorë,nuk më pagoi biletë,por na tha:

-Mirë se na erdhët,në Diznilendin tonë,shëndet dhe jetë të gjatë,ani se vuajmë nga Astma.

Për mirëseardhje shkruante edhe në shumë vende dhe në shumë gjuhë të botës. Së pari aty në hyrje vizituam Krokodilin e improvizuar,pastaj edhe shitoren me shumë çudira,por më interesant ishte kur prishej moti me shumë bubullima,vetëtima dhe kafshë, tamam si kur je në xhungël. Aty bëmë edhe disa fotografi,por me aparatin që e blemë aty në një shitore vetëm për një përdorim,pasi edhe ne edhe Teuta me z. Agimin e kishin harruar në shtëpi aparatin e tyre.

Edhe në katin përdhes të restorantit "BILLY BOB'S" kishte vende të lira por ne hipëm në kat për të parë më mirë orkestrën dhe valltarët e shumtë,tamam si nëpër filmat e kaubojve të Teksasit. Unë porosita një TEKILË,pije meksikane,që ishte hera e parë të pijë atë pije,si i ri atë fjalë e dëgjoja shpesh kur shikonim filma kaubojsh. Z. Agimi porositi një birrë,kurse Teuta me mëmën e vet nga një lëng pemësh. Në Diznilendin e bukur vizituam edhe shumë lokale duke bërë edhe fotografi,gjersa mbaroi filmi,dhe aty nga ora njëzetekatër u nisëm në drejtim të shtëpisë.

8. 06. 2005
Paris

Qysh një ditë më parë,por edhe në bisedën e mbrëmshme këtë ditë e rezervuam për të vizituar Muzeun e famshëm "LUVRIN". Z. Qamili ishte zgjuar si përditë,kur gruaja dhe djali i tyre z. Bashkimi shkojnë në atelienë,që prej aty është goxha larg. Ai kishte pirë kafe,bile kishte hëngër edhe bukë dhe kishte pirë edhe hapat e diabetit. Dhe unë kur zbrita,prej katit të dytë ai lexonte librin e z. Ramës,që e ka shkruar për z. Omerin. Edhe z. Qamili sa më tepër thellohej në libër aq më tepër inatosej për prejardhjen e Omerit,piktorit

tonë me famë botërore. Po ashtu z. Qamili atë natë deri vonë paska lexuar edhe veprën e z. Kadaresë,Vëllimin e njëmbëdhjetë,ku ashtu ara-mara pa asnjëfarë përgjegjësie dhe dijenie bënë gabim, shkruan për atë që se dinë fare. Që e njëjta e kishte prekur edhe z. Omerin,prandaj edhe na tha:

-"EDHE KADAREJA BËNË GABIME". Ne s'habitemi prej shtetit Maqedon,ai është i sëmur për të përvetësuar njerëz të mëdhenj. Nënë Tereza me dorën e vet shkruan:

"Unë gjithmonë e kam në zemër popullin tem Shqiptar"... Në Oslo më dt. 10.12.79,por çfarë i shtyn Kadarenë e Ramën... Z. Qamili edhe njëherë më tha se z. Omeri duhej sa është gjallë të reagojë, sa për turk nuk habitem,se deri vonë por ndoshta edhe tash ndonjë plak apo plakë shqiptare në rrethin tonë bënë be:"NË JE TURK".

Ne duke biseduar gruaja dhe Teuta me Aurelën e vogël zbritën dhe Teuta menjëherë vendoi xhezven për të pjekur kafen. Aurela sa e pa z. Qamilin u lëshua në drejtim të tij,ai e mori por më tha se na donë të dyve një lloj... Gruaja ime filloi të rregullonte tryezën që të hanim mëngjesin do krofne,që i kishte përgatitur zonja e z. Qamilit. Në atë moment ra zilja e telefonit andej ishte zonja e z. Bashkimit,e cila donte të dije se a do ta çojmë Aurelën te ajo. Teuta na pyeti se a ka ndonjë ndryshim për ditën e sotme,por z. Qamili i tha se jo. Sa të hamë mëngjesin do të nisemi për të vizituar "LUVRIN". Teuta i tha se do ta çonim,por tani bëhemi gati të hamë mëngjesin,dhe nëse nuk keni ngrënë do tu sjellim krofne që ka bërë vjehrra e jonë.

Aurela gjatë rrugës vetëm kthente kokën sa dëgjonte zhurmën e veturave,por më interesant i vinin kur shikonte ndonjë qen,mace apo ndonjë zog duke fluturuar.

Para orës dymbëdhjetë ishim në hyrje të “LUVRIT”,i premë biletat,por u ndalëm pak të shikojmë një grup studentësh të,arkitekturës, me profesorët e tyre ishin shtrirë përpara “LUVRIT” në çimento dhe bënin grevë,kundër Ministrisë së Arsimit. Siç dëgjuam në lidhje me rrogat e profesorëve dhe disa mjete materiale për vizitat e shumta që duhej të bënin studentët...

Përpara Luvrit demonstratat e studentve te arqitekturës

Në hyrje pamë disa statujë personalitetesh të vendosura në oborr dhe disa nëpër do dhoma të vogla. Aty u ndalëm ti shikonim,por edhe analizonim planin që na e dhanë kur premë biletat,në cilën anë do të fillonim vizitën. Qysh në fillim plani tregonte se portreti i Mona Lizës nuk ndodhet në vendin e më parshëm,edhe atë për shkaqe sigurie.

Në katin e parë ngelëm deri në ora katërmbëdhjetë. U ulëm në një restorant pushuam pak dhe u freskuam me kafe dhe lëng pemësh,po ashtu aty harxhuam edhe pozën e fundit të filmit,që më tepër i kishte harxhuar gruaja ime,dhe Teuta i vendoi një film të ri.

Prej aty filluam të hipim në katin e dytë ku ndodhen mobilet,kultura Franceze dhe e kaluara e Napoleonit. Vizituam edhe Kulturën Islame. Pasta u drejtuam në drejtim të sallës ku ndodhej "MONA LIZA" e famshme. Për të arritur atje së pari duhej të vizitonim një sallë ku ruheshin stoli me vlerë të pa çmueshme. Aty lejohej të bëhen fotografi si më parë,por këtu dallohej se aty nuk guxoje të përdorsh blicin,që na treguan në fillim të hyrjes. Një grua vizitore ruse prej mos dijenisë,apo për diçka tjetër e përdori blicin,që pat vërejtje,por ajo e përdori edhe herën e dytë. Iu afrua roja dhe ia mori aparatin dhe i bërtiti përpara të pranishmeve. Rojës iu afrua udhëheqësja e grupit,por ai nuk deshi të dëgjojë bile edhe më tepër filloi të bërtas,e kapi për krahu dhe e nxori prej salle.

Përpara sallës ku ndodhej "MONA LIZA"ishte vërtetë një rrëmujë e pa parë,dhe nuk ishte e ndaluar të përdorej blici. Ne duke pritur në rend,dy persona bisedonin në lidhje me mos lënien e blicit në sallën e stolive. Prej njërit dëgjuam se shkaku ishte se prej çdo drite të blicit paskan dëm stolit e shumta dhe humbin prej vlerës...

Përpara M o n a L i z ës

Edhe ne arritëm në afërsi të “MONA LIZËS”i bëmë disa fotografi dhe ua lëshuam vendin vizitorëve,që me të vërtetë ishin shumë të disiplinuar. Aty ka ora shtatëmbëdhjetë na telefonoi z. Agimi dhe i tha z. Qamilit se në ora tetëmbëdhjetë e tridhjetë minuta do të jetë përpara LUVRIT. Ne sa dolëm prej sallës së Mona Lizës u ulëm në bufenë e parë që të pushonim dhe të freskoheshim aty i bëmë edhe disa fotografi,por prapë më shumë gruaja.

Tamam në kohën e caktuar z. Agimi ishte përpara PIRAMIDËS,por edhe ne zbritnim shkallëve të Muzeut. Përpara Muzeut bëmë edhe disa fotografi,por tash me ne ishte edhe z. Agimi.

Z. Agimi na tregoi se edhe te ai ishte paraqitur,z. Nexhbudini kushëriri im dhe gruaja e tij dhe aty nga ora njëzetenjë na presin në darkë,në një piceri apo restorant të Parisit.

Zonja e z. Qamilit e kishte marrë Aurelën,prej të shtëpia e z. Bashkimit dhe na priste me Aurelën,që sa më parë të kthehemi. Aurela sa na pa u gëzua shumë dhe s’dinte se ku të shkonte përpara,por shpejt vendosi,që të hidhet në krahët e nënës së vet Teutës. Ajo prej mërzisë siç tha zonja e z. Qamilit shumë pak kishte hëngër,prandaj Teuta u ul së bashku me Aurelën,aty ku ishte ushqimi i saj dhe filloi ta ushqejë,që Aurelës së vogël iu kthye oreksi.

Para orës njëzetenjë u nisëm unë,zonja e ime, Teuta dhe z. Agim,që të takoheshim,me z. Nexhin dhe zonjën e tij,për darkën e caktuar. Ne duke udhëtuar në telefon u paraqit zonja e z. Nexhit duke i treguar z. Agimit se në cilin restorant të takohemi dhe nëse nuk na pëlqen do ta ndërronim. Po ashtu ajo i tregoi se është aty afër kurse i shoqi i saj z. Nexhi do të vonohet pak,në atelie për shkak se pak më parë i paskan ardhur do klientë për do porosi.

Ne arritën të parit dhe porositëm pijet,unë dhe z. Agimi nga një birrë,kurse Teuta dhe gruaja e ime nga një lëng pemësh. Nuk shkuan as dhjetë minuta arriti edhe zonja e z. Nexhit,ajo sa u ul,ra telefoni,zotëri Nexhi u paraqit se kishte dalë prej atelie dhe varej,sa do ti bëhej udhëtimi prej tollovisë së trafikut. Restoranti për z. Agimin ishte i njohur,bile disa herë me delegacione të punës kanë ngrënë në të njëjtin,por edhe me shumë shokë të tjerë,por aty në afërsi të tij është hapur shpejt një restorant,që është edhe më luksoz se ky ku ndodhemi tani. Zonja e z. Nexhit e thirri kamerierin që të bënte pagesën,por z. Agimi nuk e lejoi dhe e bëri ai. Duke i thënë dakordoheni,që të nisemi,ne i dhamë shenjë se po. Ai e pyeti zonjën e z. Nexhit se a do të gjendet ai dhe të vijë atje. Ajo i tha se do ti paraqitej në telefon dhe ai i dinë të gjithë restorantet dhe birat e Parisit,se çdo ditë është me klientët nëpër kafene.

Restoranti vërtetë ishte i klasit të parë,për fatin tonë kamerierja që do të na shërbente ishte një zezake me një ngjyrë çokollate,e re dhe shumë simpatike,por e donte edhe humorin. Si bëmë porositë unë i thash se a mundet të bënim një foto ajo u afrua dhe hyri në mes meje dhe gruas sime e thirri kolegen e vete ia dha aparatin dhe ajo mori pozitën që aparati të na zinte të tërëve. Unë,z Agimi dhe z. Nexhi,porositëm birra me krikëll,kurse gratë si përherë lëngje. Picat dhe specialitete të tjera të mishit vinin njëra pas tjetrës,që dekoret të çelnin dhe shtonin oreksin. Darka zgjati deri në ora njëzetekatër,duke i cakërruar gotat,u falënderova për darkën e shijshme dhe respektin,që më bënë si kushëri,edhe ata u falënderuan për pranimin e ofertës.

Kur arritëm në shtëpi Aurela e vogël flinte,kurse z. Qamili me zonjën na pritnin,duke parë një film të vjetër shqiptar.

9. 06. 2005
Paris

Përherë gjërat e vjetra janë më interesante,por nuk duhej lënë anësh edhe ato të kohës së sodit. Prandaj ne me z. Qamilin vendosëm që ditën e sotme ta kalojmë në pjesën e re të Parisit. Ku tërë ndërtesat janë të ndërtuara sipas arkitekturës më moderne,dhe me një lartësi të konsiderueshme.

Aty nga ora njëmbëdhjetë ishim të hipur në metro dhe udhëtonim në drejtim të lagjes që e kishim planifikuar një ditë më parë. Në vagonin ku hipëm s'kishte asnjë vend të lirë. Siç ishim në këmbë,një i rinj me një mjekër të verdhë dhe jo aq të pastër disa herë mi hedhi sytë dhe mi hedhi çelësat që i mbante në dorë përpara këmbëve. Pastaj u kërrus,por me shumë mjeshtri më preku te xhepi i këmishës,ku i kisha ca euro. Edhe kur u çua e bëri të njëjtën,por spati sukses që të nxirrte te hollat. Në atë moment u ndal metroja dhe u hap dera,ai si vetëtima zbriti. Z. Qamili më pyeti a më mori diçka?! Kësi rastesh ka shumë herë nëpër metrotë. Ne pas dy stacionesh,zbritëm në afërsi të stacionit të trenit,që quhej "LE GARE DE LION". Sa u afruam z. Qamili tha se aty ka zbritur përherë të parë kur ka udhëtuar nga ish Jugosllavia,për në Francë. Dhe përpara disa vitesh në të njëjtin stacion,ka pritur një mik,piktor të madh nga Shqipëria,me emër Sadik KACELI, kurse mua mu kujtua piktura e varur në murin e kuzhinës së z. Qamilit, që dikur përafërsisht dyzet vjet ka studjuar në Paris pikturën dhe prej atëherë,gjer në atë moment kurrë nuk paska shkelur këmba e tij,prej regjimit të Enver Hoxhës. Ai sa ka zbritur,ka thënë:

-Si ka qenë atëherë stacioni është edhe sot ,pa asnjë ndryshim. Ne nëpër stacion u ndalëm afër një orë,aty pimë edhe kafe,por bëmë edhe disa fotografi. Pastaj vazhduam për në Qytetin e Ri,ku me të vërtetë ishte i ndërtuar sipas kohës. Prej larg shikohej një Kullë,që ishte e lartë përafërsisht njëqind metra,dhe ashensorët ishin të montuar në pjesën e jashtme të murit të objektit. Për tu afruar gjer te Kulla duhej të ecish nëpër një shesh të rregulluar bukur,pastaj të ngjitesh nëpër shumë shkallë. Z. Qamili u afrua,të merrte bileta,por unë nuk e lash duke i thënë,se më interesant më vjen të ecim lart e poshtë se sa të harxhojmë kohën nëpër ashensorë. Anës tjetër prapë duhej të zbritnim po aq shkallë sa edhe hipëm. Dhe prej në fund të shkallëve shtrihej një urë e ngushtë dhe mjaftë e lartë. Në anën e djathtë ndodheshin varreza mjaftë bukur të rregulluara,kurse në anën e majtë,ndërtesa të larta për shtresën më të pasur të Parisit. Ura ishte e gjatë mbi pesëqind metra dhe në skaj ishte e thurur mirë,që do të thotë se s'kishte dalje,medoemos të ktheheshim prapë nga kishim shkuar,që me siguri ajo dikur do të vazhdohej.

Si vizituam edhe SHESHIN E FITORES,edhe andej bëmë disa fotografi dhe u futëm në një restorant për t'u freskuar dhe pas një kohe edhe drekuam.

Duke hëngër ra zilja e telefonit të z. Qamilit,andej ishte z. Bashkimi,që na thërriste të shkonim në atelie,dhe të tërë do të shkonim në shtëpi. Thirrjen e bëri pasi i ishte paraqitur,z. Agimi dhe për darkë na thërriste të tërë të shkonim në një restorant familjar.

Rrugës për në shtëpi kishte shumë tollovi,prandaj edhe u vonuam shumë,bile dy herë na telefonoi z. Agimi,mos na kishte ndodhur ndonjë e pa pritur. Ne sa arritëm z. Agimi na tha se ata janë gati me Teutën dhe Aurelën e vogël,prandaj ne nuk pushuam as dhjetë minuta dhe u nisëm me komben e z. Bashkimit në drejtim të restorantit familjar.

Vozitës kishim z. Agimin dhe në afërsi të tij në karriget e para të kombes ishim unë dhe z. Qamili,kurse gratë dhe Aurela e vogël ishin pas nesh. Duke vozitur z. Agimi mua më dha shenjë me sy,dhe u drejtua nga z. Qamili,dhe i tha:

-Unë sonte paguaj,por vetëm për ata që do të hanë GUACA deti,këta fjalë i tha që ta nervozonte z. Qamilin,pasi ai dikur është gërditur dhe prej atëherë kurrë më s'ka futur guaca në gojë,por ç' është e drejta edhe unë me gruan time kurrë në jetën tonë s'kemi ngrënë guaca,pasi ne në vendlindjen tonë detin e kemi shumë larg. Z. Qamili me një nervozë i tha:

-Ne do të hamë atë që na do shpirti e zemra,dhe unë kurrë s'kam pasur nevojë që të më paguash ti. Prandaj unë dhe miku,vjehrri yt kemi punuar nga dyzet vjet,që të mos kemi nevojë për ju,dhe të na digjet zemra për një lëng goje. Por kije mendjen te timoni, mos ma prish mbrëmjen. Z. Agimi duke qeshur tha:

-Shikuat sa shpejt mundem ta nervozoj babulin tim të dashur.

Për disa minuta arritëm përpara restorantit,që me germa të mëdha shkruante: MIRË SE NA VINI dhe po ashtu me germa të mëdha lexuam edhe emrin e restorantit:"LEON DE BRUXELES". Si e parkuam komben u afruam afër derës së hyrjes,por një person që kujdesej për klientët na tha se momentalisht s'ka asnjë vend të lirë. Z. Qamili u nervozua edhe më shumë se pak më parë,por z. Agimi i tha personit që të lajmëronte një nga të punësuarit që me siguri do të ishte njëri nga përgjegjësit,kurse z. Qamili filloi të ecte aty afër nesh por me shumë nervozë. Nuk shkuan as pesë minuta,ai personi doli dhe kur e pa z. Agimin e përshëndeti dhe i tha se vendi jonë është i rezervuar dhe mundeshim të hynim brenda në restorant. Z. Qamili mua më kapi për krahu dhe më tha:

-Ky dhëndri yt,shpesh më nervozon por punët i bënë me shumë kujdes dhe me shumë përpikëri.

Restoranti ishte shumë i rregulluar i pastër dhe shërbimi në nivel. Për Aurelën e vogël një i punësuar na solli një karrige të lartë më plotë lodra,pas tij erdhi edhe kamerieri tjetër që të bënim porosinë.

Z. Agimi dhe Teuta vërtetë porositën guaca deti,kurse unë me z. Qamilin dhe gratë porositëm mish viçi një nga specialitet e restorantit. Na sollën sallata dhe pijet. Atmosfera ishte shumë e këndshme,por edhe Aurela e vogël,në fillim lunte dhe argëtohej mirë me lodrat e karriges. Mishi ishte shumë mirë i pjekur dhe me shije shumë të këndshme,por edhe pamja me dekorin ta shtonte oreksin. Ne duke hëngër porosia u erdhi Teutës dhe z. Agimit. Guacat ishin në dy tenxhere mjaftë të mëdhaja,që avullonin z. Qamili e kthehu kokën në anën tjetër,kurse unë i mora nja tri a katër sa për ti shijuar,sa të them se edhe unë në jetën time kam hëngër guaca deti,qoftë edhe për tu lavdëruar. I thash të provonte edhe gruas sime por ajo s'deshi. Guacat ishin të shijshme,por ne s'kemi traditë për ushqime deti. Vëmendjen e ushqimit na e prishi Aurela e vogël,kur menjëherë filloi të qajë,me siguri iu mërzit në atë karrige të lartë,e mori Teuta në prehër,por Aurela e nervozuar i lëvizte këmbët dhe ia derdhi lëngun që kishte përpara,atëherë z. Qamili duke qeshur tha:

-Mirë ia bëre edhe këta të dinë se si rriten fëmijët,por pse nuk qave pak më parë dhe t'ua derdhe ata kërmijtë të zinj. Z. Agimi deshi të thotë diçka,por në atë moment kamerieri na solli ëmbëlsirat,që dekorimi i tyre na e tërhoqi të tërëve vëmendjen.

Pagesën e bëri z. Agimi aty ka ora njëzetetre dolëm mjaftë të kënaqur prej restorantit aq modern dhe me një mikpritje shembullore.

10. 06. 2005
Paris

Mbrëmjen e ditës së kaluar z. Qamili më luti që lutjen e ditës së premte apo xhumasë siç thuhet ndër myslimanë ta falnim së bashku,pasi ajo ishte xhumaja e fundit e imja në Paris gjatë kësaj vizite,por ndoshta edhe vizita e fundit që i bëja Parisit në jetën time.

Ora ishte nëntë kur u afrova afër dritares dhe sodisja bukuritë e natyrës,e veçanërisht bukuritë e qershisë që me degët dhe frutat e veta arrinte deri te dritarja ku flija unë dhe gruaja e ime. Zogjtë e shumtë vinin me shpejtësi merrnin hisen e tyre të mëngjesit dhe iknin për ti shijuar aty në afërsi. Unë i humbur nëpër ato bukuri dhe mendime në Parisin e largët,dëgjova zërin e mbesës sime Aurelës,që edhe ajo me siguri ishte zgjuar më parë,por ishte mërzitur që asnjëri nga ne s'kishte hyrë në dhomën e saj,ajo ia tha të qarit,sepse edhe asaj si zogjve i kishte ardhur koha të merrte hisen e mëngjesit dhe të shuante urinë e natës.

Teuta hyri te Aurela,kurse unë fillova të zbres shkallëve dhe në atë moment përpara meje ra një qershi all e kuqe që me siguri i ra nga sqepi ndonjë zogu. Duke zbritur e pash z. Qamilin në kopsht aty afër domateve duke punuar diçka me shat. U afrova i thash mirëmëngjesi por edhe puna e mbarë ai u drejtua në këmbë më përshëndeti dhe më pyeti a kisha fjetur mirë,dhe doli në anën tjetër ku kungujt kishin lëshuar lëndë dhe njëri kishte filluar edhe fruta. Ma tregoi me gisht frytin dhe më tha se unë isha ekspert për bahçe se përpara disa ditësh i kisha thënë mu ajo rrënjë do të fillojë e para fryt. Unë qesha dhe i thash se unë nuk jam ekspert,por më ka treguar një kojshi i cili ka qenë dikur i burgosur se

kungulli ka nevojë për më shumë dhe rreth rrënjës,por edhe kur të zgjatet pak lënda duhej edhe një apo dy herë të mbushet me dhe,që të ushqehet sa më shumë e ajo lëndë ka pasur më shumë dhe rreth rrënjës dhe prandaj unë ashtu i kam thënë.

Ne do të vazhdonim bisedën për kungujt,domatet,patatet,por edhe biseda të tjera,por Teuta u afrua na përshëndeti dhe na pyeti se ku do ti pinim kafetë,edhe se mëngjesi ishte gati. I thamë se do ti pinim në kuzhinë dhe do të hanim mëngjesin, ashtu duke këputur qershia u futëm në kuzhinë ku na pritnin gruaja ime dhe Aurela e vogël.

Sa u afruam rreth tavolinës Aurela u largua nga gjyshja e vet dhe erdhi te ne që ta ulnim në karrigen e tavolinës,pasi në kohën e fundit ka shumë dëshirë të ulet me ne rreth tavolinës dhe me shumë apetit e hanë ushqimin.

Fiks në ora dymbëdhjetë u nisëm në drejtim të xhamisë për të falur namazin e drekës. Atje arritëm afër gjysmë ore përpara se fillonte falja e namazit. Në xhami kishte një grup besimtarësh që shikonin filmin për masakrat serbe ndaj myslimanëve të Bosnjës,e veçanërisht atyre të Srebrenicës. Shumica nga të pranishmit qanin,për atë që shikonin,por disa nga ata të masakruarit i kishin edhe familje.

Z. Qamili shpejt e shpejt fali dy rekatë namaz,kurse unë iu bashkëngjita atyre që shikonin filmin që e kishte sjellë hoxha nga Bosnja me plotë dhembje. Z. Qamili sa u ul aty afër meje njëri u çua dhe filloi të thirri Ezanin e xhumasë,që na thërriste të renditeshim në safë për tu falur.

Në mes të faljes hoxha si ligjëratë të Hudbes vazhdoi atë të javës së kaluar,prej aty ku kishte ngelur për Anijen e profetit Nuh. Imami prapë me një dhembje tha:

-Myslimanët e Bosnjës gjatë njëqind vjetëve të fundit,prej serbëve kanë përjetuar tri masakra të tmerrshme,por kjo e fundit ka qenë edhe më e tmerrshme se dy të parat. Serbët s’kanë qenë, s’janë dhe kurrë s’do të jenë për bashkëjetesë me myslimanët,pa marrë parasysh

përkatësinë e tyre kombëtare. Atë vëllezër mysliman e pamë edhe me luftën e Kosovës. Serbët janë një krijesë kanibalë,pa komb fe dhe ndjenja njerëzore,me fjalë shumë njerëzor,por në vepër bisha të tërbuara.

Kurse mua në kokë më silleshin vitet e fëmijërisë kur pleqtë sipas porosive sllave s'na linin të dëgjojmë bisedat e burrave,që masakrat sllave përsëriteshin brez pas brezi,në trojet tona. Kurse serbët dhe maqedonët përveç që kanë shkruar histori të rrejshme ata gjeneratave u linin dhe u lejnë amanet urrejtjen ndaj myslimanëve.

Si falëm edhe pjesën tjetër të namazit të xhumasë,kuptohej pas ligjëratës u përshëndetëm me hoxhën dhe shumë të tjerë,por për në fund e lash xha Enverin e fshatit tim Zhubrinë,që në Francë jeton prej afër dyzet vjetësh.

Me z. Qamilin udhëtuam afër njëzet minuta dhe u ndalëm te një restorant turku mjaft modern që të hanim drekë. Duke hëngër komentonim edhe bisedën e hoxhës,atë na e ndërpreu cingërima e telefonit të z. Qamilit,që e thirri z. Selim Selimi një shok i z. Qamilit,kreator mode edha ai është njëri nga të parët që ka ardhur me z. Qamilin në Francë,për të siguruar kafshatën e gojës për vete dhe familjen e tij,që na priste për kafe në shtëpinë e vet.

Në shtëpinë e tij pashë shumë fotografi shqiptarësh të aktiviteteve të ndryshëm;si për hapjen e shkollës shqipe në Paris,demonstratave për Kosovën,për Festën e Flamurit dhe fotografi nxënësish me aktivitete të llojllojshëm. Z. Selimi na luti që të rrinim për darkë,por ne e kishim të rezervuar atë mbrëmje,për të shkuar te z. Rexhep Limani një kushëri i imi,por jo në shtëpi te ai por në një nga restorantet më të mirë të Parisit.

Kur arritëm në shtëpi Teuta më tha se përpara orës njëzetenjë duhej të takoheshim me z. Rexhepin në një restorant në afërsi të OPERËS,dhe pastaj do të shkonim atje ku ai e ka rezervuar darkën. Ne duke biseduar me Teutën ra

zilja e telefonit tim,që ishte hera e parë të bisedoj gjate një muaji,që isha në Francë. Andej ishte shoku im i shkollës inzh. Shukri Saliu,që prej një kohe s'ishte mirë me shëndet dhe mjekët i thoshin se vuan nga kanceri në fyt,kurse si ai po ashtu edhe unë dyshonim nga hemikalet e laboratorit të KOMBINATIT të Osllomes. Analizat që i kishin ardhur prej një laboratori të perëndimit kishin dalë në rregull,por interesoheshin për vendin e punës dhe ndotjen e ambientit,shoku im ishte shumë i disponuar nga ai lajm aq i mirë.

Aurelën e vogël e lamë në shtëpi me gjyshin dhe gjyshen,kurse unë me gruan dhe z. Agimi me Teutën u nisën në drejtim të OPERËS,që arritëm pak përpara kohës së caktuar. Ne duke ecur andej z. Rexhepi na telefonoi se kishte kaluar andej me veturën dhe na kishte parë,dhe do arrinte sa të bënte parkimin e saj,dhe ne të mos largoheshim shumë nga ai vend ku ishim.

Z. Rexhepi ishte me gruan dhe djalin e vetëm pas tri vajzave. Në realitet ai në Francë ka djalin dhe dy vajza,por edhe një ka në Kërçovë me gruan e parë,që shumë herë e përmend,dhe se ka parë afër njëzet vjet. Ai shumë herë kur vjen në Kërçovë dëshiron ta shoi por ajo s'pranon,e veçanërisht tash kur i ka vdekur nëna,dhe më është rritur dhe ka mbaruar fakultetin dhe është përpara martesës.

Si u takuam me z. Rexhepin shpejt e shpejt pimë nga një kafe te restoranti"CAFE DE LA PAIX" dhe dolëm të vizitonim hotelin e dashnorit të Dajanës dhe hotelin ku AVNI RRUSTEMI e kishte vrarë Esat Pashë Toptani. Duke ecur z. Rexhepi ma bëri me dije se pse e kishte blerë pjesën e dyqanit të vëllait të vet,dhe në të ardhmen mendonte ti blejë edhe dy pjesët tjera të vëllezërve të vet dhe t'ia dhurojë vajzës,me gruan e parë-TIXHES(HATIXHE),dhe i shpëtuan lotët,duke kërkuar edhe mendimin tim për ti blerë edhe një banesë në Tetovë,edhe meqenëse tash për tash ai nuk e njehë,por edhe

ajo nuk dëshiron ta takojë,pasi ia ka përzënë të amën. Unë i thash se atë që ka planifikuar është një ide shumë e mirë,dhe humane.

Restorantin të cilin e kishte zgjedhur z. Rexhepi ishte shumë luksoz dhe shërbimi në nivel. Ne sa u ulëm në karriget tepët luksoze kamerieret e bukura i sollën menytë dhe ne filluam të bënim zgjedhjet e ushqimeve si mysliman të Ballkanit. Unë zgjodha një ushqim me mish të përzier,që lejohet në menynë tonë,por z. Rexhepi i kishte thënë kamerieres që të jetë i dyfishuar, po ashtu për z. Agimin dhe vetveten. Ne duke cakërruar fundin e gotave të aperitivit kamerieret filluan të sillnin edhe pije të tjera,dhe më në fund edhe ushqimet e shijshëm. Gjatë kohës së pijeve ne bëmë disa fotografi familjare, por edhe me personelin e restorantit,veçanërisht me djalin e z. Rexhepit,Ibrahim-Albanin e vogël. Kur filluan të sillnin ëmbëlsirat akrepat e orës së madhe ishin njëri mbi tjetrin te numri dymbëdhjetë. Ne do të vazhdonim akoma në atë atmosferë të bukur,por z. Agimi veturën ia kishte dhënë të vëllait,që do të udhëtonte diku larg Parisit,prandaj ne duhej të ktheheshim me metro,dhe pas orës njëzetekatër janë shumë të rrallë.

Si dolëm prej restorantit u përshëndetëm me të gjithë,por kur erdhi radha të përshëndetem unë me zonjën e z. Rexhepit dhe z. Rexhepin ata s' më jepnin dorë dhe s' dëshironin të përshëndeten,duke më thënë se do të përshëndeten atëherë kur do të hamë edhe një darkë në shtëpinë e tyre. Unë arsyetohesha se s' na premtojnë ditët e pushimit të gruas,por edhe dita e biletës kthyese,zonja e z. Rexhepit tha se penalet e biletës i paguan ajo po të jetë nevoja. Po ashtu na tha se të vijmë deri në Paris dhe të mos hamë një specialitet të vendlindjes së saj Tunizit,s'është e mundur. Duke u premtuar se edhe njëherë do të takoheshim në shtëpinë e tyre,u nisëm në drejtim të metrosë.

Pritëm afër njëzet minuta,dhe aty z. Agimi më tregoi se gjatë studimeve ka punuar me ndërrime në një postë,që ndodhet aty në afërsi dhe shumë herë ka udhëtuar në atë kohë të natës dhe përherë e kanë pritur vëllezërit ose babai,pasi udhëtimi i asaj kohe ka shumë rreziqe.

11. 06. 2005.
Paris

Sot fjetëm pak më gjatë,dhe z. Qamili do ta shfrytëzojë si ditë pushimi. Z. Agimi ditën e shtunë nuk punon dhe në vend të z. Qamilit ai së bashku me Teutën do të na bëjë shoqëri.

Mëngjesin e kaluam duke blerë zahire për tërë javën. Por në të njëjtin shitore ato ditë kishin pruar edhe disa pajisje,që do të shërbenin për pushimet verore,që z. Agimi me Teutën dhe Aurelën e vogël,prej përpara disa ditësh kishin parapaguar këstin e parë në një hotel në bregdetin kroat,dhe prej atje ditët tjera do ti kalojnë në vendlindje. Po ashtu ata planifikonin që të bënin një vizitë te familja e nënës së nënës në rrethinën e Kikindës. Z. Agimi dikur si fëmijë paska qenë,por shumë pak i kujtohej ajo vizitë,siç thuhet si nëpër ëndërr.

Kjo farefisni është lidhur atëherë kur babë daja i z. Agimit paska shërbyer ushtrinë në atë vend dhe njoftohej me nënën e nënës të z. Agimit dhe mbaron me martesën e tyre.

Në atë shitore blemë edhe disa lodra për Aurelën,që i do shumë kukullat e veshura me fustane të kuq,po ashtu ne blemë edhe një kukull për vajzën e z. Bashkimit, Leonën e vogël.

Në ora trembëdhjetë Aurelën e çuam te nusja e z. Bashkimit,kurse ne do të vazhdonim për të vizituar kishën

NOTËR DAMË. Aurela sa e pa Leonën si i mbante me duart e saja të vockla të dyja kukullat u lëshua në drejtim të saj,duke lëshuar disa zëra dhe ia lëshoi në dorë,ajo e puthi dhe deshi ta merrte hopa,por s'mundi se Aurela ishte e veshur pak si trash. Teuta filloi t'ia hiqte teshat e tepërta,por Aurela filloi ta kapte për flokësh,veshësh dhe ta puthi,që mua mu duk se dëshironte ti thotë;shkoni unë tash kam shoqëri.

Zonja e z. Bashkimit e vendoi xhezven,ne reaguam se kishim pirë,por ajo s'deshi të dëgjonte duke na thënë se edhe herën tjetër s'deshëm të pinim kafe në shtëpinë e saj,dhe filloi të mbushte gotat me lëng pemësh. Z. Bashkimi u ul me ne dhe na pyeti për z. Qamilin. Unë i thash se e lamë në kopsht me detyrë që të prashitë domatet dhe të bënte edhe disa punë të tjera në kopsht. Ai filloi të qeshi dhe ma afroi gotën e mbushur me uiski,por pa mos më pyetur,unë e kapa dhe duke qeshur i thash: çin,çin...

Te kisha NOTËR DAMË bëmë disa fotografi,dhe e vizituam për herë të dytë vetëm e vetëm pse nuk kishte qenë me mua dhe z. Qamilin gruaja e ime. Po ashtu vizituam për hatër të saj edhe PANTEONIN dhe SORBONËN. Aty nga ora shtatëmbëdhjetë hëngrëm drekën te një restorant maroken,u freskuam dhe si pushuam mirë u nisëm për te KULLA E AIFELIT. Atë e kishim vizituar disa herë,bile njëherë me Aurelën e vogël,që kënaqej pas pëllumbave të shumtë,që ecin nëpër turmat e njerëzve,po ashtu edhe aty bëmë disa fotografi,që iniciatori ishte gruaja e ime. Ajo po ashtu nguli këmbë që të prisnim rend që të hipnim lart te kulla,por unë nuk pranoja se rendi ishte shumë i gjatë,si disa herë të tjera. Teuta dhe z. Agimi nuk thoshin as jo e as po,me siguri që të mos hidhëronin njërin nga ne. Më në fund vendosëm që të vinim ndonjë ditë më herët dhe si bëmë edhe një fotografi u nisëm që të dilnim në anën tjetër të Senës. Atje në restorantin e parë u ulëm të pinim kafe,pasi vërtetë ishim të lodhur.

Si i pimë kafetë u afruam te një turmë njerëzish koreanë që bënin demonstrata kundër Shteteve të Bashkuara të Amerikës,dhe po ashtu shpërndanin afishe në disa gjuhë të botës. Aty nuk u ndalëm shumë,pasi filloi të rigonte një shi i hollë,por edhe i ftohtë. Prandaj edhe u futëm në një restorant,ku unë dhe z. Agimi porositëm nga një krikëll birrë,kurse Teuta me nënën e vet nga një lëng pemësh. Unë i thash z. Agimit se po të binte shi edhe në atë pjesë ku ata e kishin shtëpinë do të gëzohej z. Qamili se do të ujitej kopshti dhe ai nuk kishte nevojë të mbante ujë me kova,z. Agimi duke qeshur tha:

-Ju me babulin tim doni të hani me shumë lugë,unë Ju them mos e lodhni trupin tani në pleqëri.

Si u ndal shiu u drejtuam në drejtim të veturës,ku z. Agimi më tha se do të bënim disa vizita nëpër disa pjesë të Parisit. Kur arritëm në një vend më tha se aty ka bërë edhe një pjesë të praktikës si student,dhe se aty bëhej riciklimi i bërllokut. Diku aty në afërsi ishte edhe Biblioteka e Fransua Miteranit,që francezët i bëjnë shumë kritika për harxhime të tepërta,që për mua është qesharake të thonë dhe të mendojnë ashtu francezët për ndërtimin e një biblioteke.

12. 06. 2005
Paris

Z. Qamili përpara disa ditësh kishte biseduar në telefon me zonjën Kllara Budën,redaktore e Radio Francës emisioni në gjuhën shqipe dhe i kishte treguar për mua se jam mysafir te ai në Paris. Ajo e kishte përshëndetur vizitën time dhe për sot në ora nëntë kishte caktuar një takim në Redaksinë e Radio Francës.

Në ora shtatë zbrita në kuzhinë,z. Qamili ishte bërë gati,kurse gruaja e tij e kishte zier qumështin,por edhe kafja ishte gati. Prandaj unë sa u ula zonja na i solli kafetë dhe i vendoi në një stol të vogël. Ne duke i pirë kafet ajo e përgatiti edhe ushqimin,sa për të pirë hapat e mëngjesit,pasi vuajmë të dy nga e njëjta sëmundje,Diabeti.

Në fillim morëm Aero Erinë,pastaj edhe Metron për të shkuan në pjesën e Parisit,që quhej Pasi ku ndodhej kompleksi i Radio Francës. Në ora nëntë pa pesë minuta ishim përpara sportelit të informacionit. Ia dhamë emrin dhe mbiemrin e Kllara Budës,por i punësuari na tha se nuk e njeh pasi ka shumë të punësuar,por do ta shikojë atë emër a është i regjistruar në kompjuterin e Radio Francës dhe do të na thërriste,duke na treguar karrigen ku do të mundeshim të ulemi. Nuk shkuan as pesë minuta na thirri,por unë nuk lëviza nga karrigia,kurse z. Qamili u afrua,pasi ai e njeh mirë gjuhën frënge. I punësuari i tha se është në rregull emri i saj është në kompjuter dhe se është Redaktore e Radio Francës emisioni në gjuhën shqipe. Z. Qamili pohoi me kokë dhe ia dha një kartele të identifikimit,kurse mua ma kërkoi pasaportën. Si i pa mirë i punësuari i rrotulloi numrat e telefonit,dhe

menjëherë na tha se shpejt do të zbriste personi i kërkuar për ne.

Zonja Kllara me z. Qamilin ishin takuar disa herë në tubime të shqiptarëve që jetojnë në Francë,por edhe ajo si z. Qamili dhe shumë të tjerë janë të interesuar,që sërish të hapet një paralele me mësim në gjuhën shqipe. Ashtu siç ka ekzistuar në ish Jugosllavinë e Titos. Në atë paralele ka mësuar edhe z. Agimi dhe vëllezërit e tij,prandaj edhe aq bukur e flasin gjuhën shqipe,por edhe shumë shqiptarë të tjerë. Në kohën e Titos në Paris ka ekzistuar edhe Shoqëria Artistike “ TREPÇA”.

Zonja Kllara sa e pa z. Qamilin e njohu dhe u përshëndetën si miq të vjetër e z. Qamili më prezantojë mua dhe i tregoi se unë jam mysafiri i tij nga Maqedonia,kurse ajo duke qeshur më tha i vjehërri i z. Agimit,unë pohova me kokë. Hipëm shkallëve në katin ku ndodhej selia e redaksisë.

Redaktorja e Radio Franca emisioni në gjuhën shqipë, z. Klara Buda dhe z. Begzat Rahmani

Ishte një dhomë bukur e madhe me disa karrige dhe tavolina për të punësuarit dhe mbi secilën nga një kompjuter. Ne duke biseduar ra telefoni unë dorën në zemër prita të bisedohej në gjuhën frënge dhe unë s' do të kuptoja asnjë fjalë, por fjala e parë e zonjës Kllara qe:

-Hë zemër u çove,si fjete dhe pastaj i tregoi diçka në lidhje me muzikën,që unë s'kam asnjëfarë dijenie. Pasi mbaroi bisedën na tregoi se ishte djali i saj dhjetë vjeçar dhe se krahas shkollës ndjek edhe shkollën e muzikës. Po ashtu më tha se ata mësojnë dhe punojnë në ambient frëng,por flasin dhe këndojnë shqip. Dhe pyeti z. Qamilin çfarë u bë me iniciativën për rihapjen e paraleles në gjuhën shqipe,dhe se ajo mezi pret që ta regjistrojë edhe djalin e vet,por se ka edhe

shumë shqiptarë të tjerë të interesuar. Unë u kyça në bisedë duke thënë:

-Kemi vizituar shumë familje,por jam i prekur se shumica edhe në shtëpi flitnin frëngjisht. Edhe zonja Kllara pohoi me kokë se edhe ajo atë e kishte vërejt. Unë thash se edhe vajza ime Teuta më ka thënë se i paska thënë mjeku:

-Ju me vajzën e juaj Aurelën,që akoma si ka dy vjet duhej të komunikoni sa më shumë në gjuhën frënge. Për mua kjo është një budallaki dhe francezët qenkan më të zi se sllavët tonë. Atëherë z. Qamili tregoi se dy djemtë binjakë të z. Bashkimit në shkollë i paskan ndarë në dy paralele,që sa më pak të kenë kontakt njëri me tjetrin. Atëherë unë prapë u kyça në bisedë,duke thënë; se nuk është e rastit që serbët janë miq tradicional me francezët. Dhe në emër të "VËLLAZËRIM BASHKIMIT" na shtynin të hiqnim dorë nga gjuha e jonë amtare.

Në këtë takim duhej të ishte edhe z. Omer Kaleshi,piktori Kërçovar që jeton dhe vepron në Paris. Siç na tha zonja Kllara,kishte biseduar një ditë më parë me zotin Kaleshi,por kjo kohë për atë është e pa përshtatshme,pasi ai tërë natën pikturon dhe në këtë kohë akoma është në gjumë.

Ajo sa mbaroi bisedën erdhi një person dhe e thirri që të shkonte në studio. Ajo na thirri edhe neve që të shkonim me te,se priste një bisedë-intervistë telefonike me z. Albin Kurtin nga Kosova,në lidhje me statusin e Kosovës. Atë bisedë e kishte caktuar për në ora tetë e tridhjetë minuta,por linja ka qenë e zënë. Prandaj edhe kërkoi falje që do të prisnim pak. Unë i thash:

-Ne erdhëm vetëm që unë të dorëzoj veprat e mija,dhe ne e kryem detyrën,por ajo tha se dëshironte edhe me mua të bënte një intervistë,e veçanërisht kur i pa se unë jam autor i pesëmbëdhjetë veprave,dhe tha se me kënaqësi do ta lexonte romanin "ANIJA KOZMIKE",por edhe të tjerat.

Në linjë telefonike nga Kosova ishte personi i opozitës që,këmbëngulte se bisedimet me Serbinë për statusin e Kosovës janë të panevojshme dhe të dëmshëm,që edhe unë pajtohem plotësisht me atë person. Edhe ai edhe unë jemi të një mendimi se s'ka serb,maqedon, malazez,por edhe rus,që për këtë kohë që do të thotë fjalën PAVARËSI për Kosovën. Vallë shqiptarët e Kosovës mos duhej serbëve tu thonë faleminderit për DËBIMET, MASAKRAT,DJEGËJET dhe SHKATËRRIMET e Kosovës???!!! Biseda zgjati afër gjysmë ore,që në studio u bë mjaftë vapë,prandaj dolëm,u freskuam me nga një lëng dhe kafe dhe hymë në studio për të vazhduar intervistën me mua. Intervista zgjati afër pesëmbëdhjetë minuta,por për në radio do të jepet vetëm tre minuta dhe disa minuta për krijimtarinë time do të foli zonja Kllara. Pas intervistës dolëm në zyrën e saj ku i bëmë disa fotografi,dhe pastaj ajo na thirri të pinim nga një kafe,por në restorantin jashtë kompleksit të Radio Francës,se me intervistën time asaj i mbaroi edhe orari i punës. Duke zbritur shkallëve na tha se kafenë do ta pinim në restorantin ku ajo për çdo ditë hanë mëngjesin,apo ndonjëherë edhe drekën.

Restoranti ishte afër kompleksit të radios,por mjaft luksoz dhe i shtrenjtë. Aty vazhduam bisedën një orë e dhjetë minuta. Gjatë bisedës na tregoi se në zgjedhjet Parlamentare të Maqedonisë ka qenë atje dhe i ka bërë një intervistë zotit Ali Ahmeti. Dhe në të njëjtën kohë në Ohër ka organizuar një trajnim në gjuhën shqipe për Redaktorët e radio Kërçovës,Strugës,Gostivarit,Tetovës,Dibrës,Shkupit,Kumano vës,Ohërit,por edhe të disa radiostacioneve lokale të Maqedonisë. Për redaktorin e radio "GURRËSË" në Kërçovë z. Driton Dikenën më dha disa fotografi,që ai do t'ua shpërndante kolegëve të vet. Gjatë asaj kohe në restorant ra biseda edhe për serbët. Unë thash atë që kam menduar dhe mendoj:

-Sllavët në përgjithësi,por veçanërisht ata që kufizohen me Kosovën dhe Shqipërinë,duke përfshirë edhe Maqedoninë e Gligorovit një antishqiptar i përbetuar janë: KOMUNISTA TË PIST, PARAZITË, TERRORISTA, FASHISTA, KANIBALISTA dhe EGËRSIRA, por të TËRBUARA,dhe te ATA SUNDON FUNDAMENTALIZMI ORTODOKS, veçanërisht SERBËT janë një KOMB,nëse mundet tu thuhet KOMB,janë të RETARDUAR NË KOKË. Unë për serbët kam edhe një mendim timin:gratë serbe pjellin fëmijë kriminelë,kurse meshkujt rrena dhe trillime,kur ua mëson një rrenë ato pjellin dhjetë të tjera. I pranon në shtëpi,ato ditën e parë,ndoshta rrinë urtë,të dytën,hulumtojnë terrenin të tretën dije se të bëhen HISETAR,kah fundi i vitit mundohen të të nxjerrin krejtësisht prej shtëpie,siç është rasti me Kosovën. Me krejt këta që thash më është bindur edhe bota perëndimore prandaj edhe njëri tjetrit kanë filluar ti vendojnë kufijtë,siç vepron Mali i Zi sepse zullumi tash bëhet në mes tyre,sepse të tjerët janë larg. Zonja Kllara bisedën e ndiqte me shumë kujdes,dhe në fund të bisedës sime në fund tha; se edhe në Shqipëri komunizmit ia kanë parë sherrin. Z. Qamili e thirri kamerierin që të bënte pagesën,por zonja Kllara i tha prerazi që paratë ti fuste në xhep,kurse kamerierit i tha se do ta thërriste ajo kur të duhej. Aty bëmë edhe disa fotografi të tjera. Biseduam edhe për jetën private dhe na tregoi se disa herë në vit viziton Shqipërinë,së bashku me djalin dhe të shoqin,që në Shqipëri bënë disa projekte për Francën me ekspertë shqiptarë,pasi edhe fitimi është më i madh.

Në ora njëmbëdhjetë e tridhjetë minuta u përshëndetëm,por për tu takuar edhe njëherë tjetër. Unë me z. Qamilin u nisëm për në drejtim të Metrosë,që do të na çonte në Noisi le Grande.

Kur arritëm në shtëpi z. Bashkimi e kishte ndezur skarën dhe e kishte mbushur një pjatë plotë me mish të pjekur të llojeve të ndryshëm. Në atë moment arriti edhe z. Agimi me pijet që i kishte porositur z. Qamili,por edhe drekën e bënte ai dhe në çdo moment pritnim të arrinin kushërinjtë e mijë;z. Nexhbudini me të shoqen,z. Rexhepi me të shoqen dhe z. Limani. Ne duke pirë me z. Qamilin u afrua Teuta dhe më tha se aty nga ora dhjetë ishte paraqitur gruaja e z. Nexhit dhe i kishte thënë se ata dhe z. Limani nuk do të vinë,se mbrëmë nga ora njëzetekatër z. Limani paska pasur ndonjë atak dhe momentalisht ndodhet në një nga spitalet e Parisit. Prej mbrëmë edhe z. Nexhi ndodhet atje dhe se ajo s'dinë gjë për gjendjen e z. Limanit.

Fiks në ora katërmbëdhjetë u paraqit z. Rexhepi se vinte së bashku me familjen e vet dhe një teze të gruas,dhe se ishte aty afër,por nuk i kujtohej mirë se ku ndodhej shtëpia,prandaj e thirrëm z. Agimin që ti jepte sqarime. Për afër njëzet minuta z. Rexhepi ishte përpara shtëpisë së z. Qamilit. Unë menjëherë e pyeta për z. Limanin por ai më tha se nuk dinte gjë. Ne sa u ulëm z. Bashkimi na solli një pjatë plotë me mishra të pjekur,që akoma avullonte. Por edhe z. Agimi na solli birra dhe lëngje të ftohta.

Si u përshëndetëm me të gjitha dhe u stabilizua gjendja,në telefon e morëm z. Nexhin,ai na tha se momentalisht është i shtrirë në spital dhe se këmba djathtë i është e pa lëvizshme. Mjekët i kishin thënë se nuk duhej të shqetësohen,por duhej të bëhen disa analiza më të përpikta. Prej fjalëve të z. Nexhit pak u rehatuam dhe me drekën vazhduam gjer aty nga ora tetëmbëdhjetë,në një atmosferë mjaftë festive. Z. Rexhepi por edhe gruaja dhe tezja e saj u falënderuan,por edhe këtu thanë se s'do përshëndeteshin,por do ta linin për në shtëpinë e tyre ku për darkë do të hanim KUS-KUSIN.

Me propozim të z. Bashkimit të tërë me komben e tij të shkonim në parkun e qytetit,që prej shtëpisë së tyre është afër njëzet kilometra. Propozimi ishte me vend dhe të tërë u pajtuam. Pa humbur kohë në kombe i ngarkuan edhe katër biçikletat që i mbajnë në garazhin e z. Qamilit,por z. Bashkimi shkoi në banesën e vet që të merrte biçikletat e fëmijëve dhe sa më parë të niseshim.

Atje sa arritëm z. Qamili e mori njërën nga biçikletat ma dha mua dhe një mori për vete dhe u nisëm nëpër pistën e parkut pa fund. Duke vozitur shikoja mrekullitë e natyrës por edhe të njeriut perëndimor. Kënaqësia vazhdoi gjer aty nga ora njëzetedy kur dielli u fut pas maleve,dhe terri pa mëshirë filloi të mi rrëmbente bukuritë e parkut prej përpara syve.

13. 06. 2005
Paris

Prej asaj dite që z. Omeri na i dha librat e Luan Ramës dhe të Ismail Kadaresë,ku përshkruajnë autobiografinë e z. Omerit,z. Qamili çohet herët dhe lexon nga disa faqe,e pastaj ne komentojmë sa është reale për atë që shkruajnë ata,pasi ne jetën e familjes së z. Omerit e njohim mirë,pasi jemi të një vendi.

Edhe sot biseduam gjatë për familjen Kaleshi,bile e përsëritëm atë që e kishim biseduar ditë më parë. Edhe sot e thamë atë,pse z. Omeri si njeri dhe intelektual i rrallë lejon që dikush të luaj me prejardhjen e familjes dhe prejardhjen e tij. Në një vend z. Kadare shkruan:z. Kaleshi sa ndihet shqiptar aq ndihet turk dhe po aq maqedon...???!!!

Me të vërtetë diçka absurde dhe mendim i pa pjekur. Për babën e z. Omerit dihet se është shqiptar atë topi se luan,për nënën po ashtu,po le të jetë maqedone myslimane

nga nëna e nënës siç kanë qejf z. Kadare, z. Rama dhe shumë të tjerë ta paraqesin,dhe z. Omeri le të ndihet sa maqedon aq edhe shqiptar,por si mundet të ndihet edhe turk?! Kur as nënë e as babë,s'kanë lidhje me turkun. Nëse mendon z. Kadare se z. Omeri ka jetuar dhe ka mbaruar fakultetin e artit në Turqi,pse nuk thotë se edhe ai edhe z. Omeri janë edhe francez,pasi z. Omeri mbi dyzet vjet jeton në Francë,por edhe z. Kadare u bënë shumë vjet që jeton në atë vend. Ose z. Kadare kur ia dhanë një çmim bukur të madh në Londër,gazeta Le Figaro e datës:07. 06. 2005 shkroi:Ismail Kadare është shkrimtar shqiptar,kuptohet në gjuhën frënge,as njëri nuk pyeti se çfarë e ka pasur babën,nënën apo...do të thotë se z. Kadare nuk lejon të luhet me prejardhjen e tij...???!!! Por sipas mendimit tim Kadareja xhelozon në njerëz të rangut të tij. Dhe ndoshta një ditë do të thotë:

-Po z. Omeri është njeri i madh i rangut tim,por ai s'është shqiptar si unë i "PASTËR",lexoni çfarë shkruhet për nënën e nënës së tij. Dikur më kujtohet se vet z. Kadareja ka shkruar një artikull se Shqiptarët e Maqedonisë më së tepërmi ka gjase të kenë qenë të fesë ORTODOKSE,por që të mos SLLAVIZOHEN kanë pranuar nga turqit ISLAMIN. Unë jam i bindur se jam rritur dhe plakur me maqedonët dhe e di mirë mentalitetin e tyre. Dhe po të kishte qenë nëna e nënës së z. Omerit maqedone ata assesi nuk do ta linin që ajo vajzë të rritet në një familje tjetër që si përket fesë dhe kombit të tyre...

U lodhëm mjaftë me këta biseda dhe mendime,që të relaksoheshim pak e morëm Aurelën e vogël dhe dolëm në kopsht. Unë përherë të dytë i mbusha disa rrënjë kungulli siç më kishte thënë dikur një i burgosur,kurse z. Qamili me Aurelën këpuste qershia,si e mbushi një enë i lanë te çezma dhe më thirrën të uleshim nën hijen e qershisë se edhe Teuta do ta sillte kafenë.

Sa na erdhi kafja ra telefoni z. Qamilit,andej ishte z. Qemali një nip i z. Qamilit, që na kishte thirrur për darkë,por tash na thirri që ta vizitonim në atelienë e tij,të pinim një kafe dhe...Z. Qamili më pyeti mua a jem dakord,unë i thash me gjithë qejf.

Si hëngrëm bukë u nisëm me veturën e z. Qamilit,së pari të shkonim te atelie e tij,pasi në afërsi të saj ka një barnatore,prej ku z. Qamili furnizohej me barna. Në atelie takova një të njohur që dikur i kisha dhënë disa nga veprat e mija dhe prej atëherë s'ishim takuar. Ai më tha se i kishte lexuar me vëmendje veprat dhe përafërsisht më tha fjalët që dikur në Ohër mi kishte thënë Dr. Dielli një kirurg,por sipas fjalëve të tija më së tepërmi i pëlqen humori dhe satira,por edhe ai më tha se kur e ka lexuar poezinë për Aurelën e vogël,i janë mbushur sytë me lot. Kurse unë i thash se prej atëherë kur e kam shkruar atë poezi dhe i kam parë se si qanin tri vajzat e mija,s'mundem ta stabilizoj tensionin e gjakut. Dhe shumë miq e shokë më janë paraqitur me telefon,që të më pyesin mos kam pasur ndonjë tragjedi.

Aty në atelie pimë vetëm nga një lëng pa sheqer dhe u nisëm për në atelien e z. Qemalit,që prej aty s'do të ishte më shumë se pesë kilometra. Atje na priste ortaku i z. Qemalit,pasi ai kishte shkuar të merrte një porosi,dhe në çdo moment duhej të kthehej. Ne duke pirë kafet z. Qemali erdhi u përshëndetëm ua shpërndau punëtorëve punën dhe dolëm në restorantin që ishte në afërsi të atelies. Aty na u paraqit z. Agimi dhe na tha që të mos shkonim në shtëpi,sepse ai do të vinte te atelija me Teutën,Aurelën dhe gruan time,dhe prej aty do të vazhdonim për te z. Qemali dhe se ka një befasi për mua.

Në ora nëntëmbëdhjetë në veturën e z. Agimit hipa edhe unë dhe u nisëm për te z. Qemali. Si udhëtuam afër pesëmbëdhjetë minuta e ndali veturën dhe më tha,që të zbritnim,dhe e mori foto aparatin,por i tha edhe gruas time që

edhe ajo të vinte me ne,dhe po të deshi edhe Teuta,por ajo u kujtua se ku ishim. Ecëm afër pesëdhjetë metra dhe në një pllakë të madhe shkruante: “PLAC DE SKENDERBEC”,që përfshinte një sipërfaqe bukur të madhe. Aty bëmë disa fotografi dhe z. Agimit iu falënderova nga zemra.

Sheshi i Skenderbegut në Paris

Kur arritëm te z. Qemali,z. Qamili me gruan dhe z. Bashkimi po ashtu me gruan dhe fëmijët kishin mbërri dhe pinin nga një lëng,kurse kafenë pritnin ta pinim së bashku. Sa hymë brenda z. Qamili më pyeti çfarë ishte befasia,unë i tregova dhe ai duke u çuar në këmbë i tha të lumtë z. Agimit,sepse atij si kishte ra ndër mend,për ta vizituar" SHESHIN SKENDERBEK".Ne sa u përshëndetëm dhe u ulëm arriti kafja,që e kishte përgatitur zonja e shtëpisë,por na e solli zonja e z. Bashkimit. Duke pirë kafetë,z. Qemali solli dy lloje të uiskit,dhe z. Qamili tha:

-Mbushi nga një,për Agimin që i është kujtuar të shkojë asaj rruge ku ndodhet sheshi i Skënderbeut. Të gjithë u çuam në këmbë dhe i cakërruam gotat. Bisedat ishin të ngrohta,por edhe darka e bollshme. Aty nga ora njëzetedy ra telefoni i z. Qemalit. Ai pasi bisedoi pak i tha se po janë te unë në darkë. Andej ishte një person që për grua ka një mbesë timen,por jo aq të afërt dhe na thërriste në drekë,apo darkë si të na konvenonte neve. Unë iu falënderova për njëherë tjetër,pasi është shumë larg nga Parisi dhe ditët u afruan për tu kthyer.

Aty nga ora një pasmesnate ramë të rraskapitur,por dorën në zemër unë isha edhe pak qejfli,se me z. Qemalin ish nxënësin tim dhe z. Qamilin ndoshta e tepruam me Uiskin e ftohtë,herë herë na shoqëronte edhe djali i z. Qemalit një student solid i informatikës,por se linin mangët edhe z. Agimi dhe z. Bashkimi,por jo sa ne se ata do të vozitnin. Për fat tonin rruga nuk ishte shumë e ngarkuar dhe udhëtuam pa probleme.

14. 06. 2005
Paris

Lodhjen e djeshme,por edhe të tërë javës e ndjeva natën,por edhe sot në mëngjes,trupin e kisha të dërmuar dhe të rraskapitur. Atë lodhje e ndien disa ditë edhe z. Qamili,pasi ai është më në moshë se unë.

Kafen e mëngjesit e pimë nën hije të qershisë,që akoma ka fruta në majë,por tash janë me ngjyrë,më tepër të zezë se sa të kuqe,por edhe më të ëmbla,dhe për çudi asnjëra s'është e krimbur. Aurela shpesh shikon në drejtim të qiellit,dhe me siguri u lutet zogjve ti hedhin ndonjë kokërr qershie. Nën hijen e qershisë e hëngrëm edhe mëngjesin,duke bërë planin se çka do të vizitonim atë ditë.

Së pari vendosëm të vizitonim oborrin e muzeut të Luvrit,pastaj të vazhdonim nëpër parkun dhe të dilnim në rrugën me emrin"MUFTAR"ku ndodhej kafeneja"NJË PIJE PREJ NË KËMBË" që vite me radhë e viziton z. Omer Kaleshi. Ai aty takohet me shokët dhe kolegët e tij,por edhe me të madhin Kadare.

Nëpër park ecëm afër dy orë dhe aty nga ora pesëmbëdhjetë filluam të ecim nëpër rrugën Myftar dhe me kujdes shikonim të gjenim kafenenë e lart përmendur. Rruga ishte e vjetër e ngushtë dhe e shtruar me kalldrëm,në të dy anët shitore për ushqime,por edhe pijetore. Unë prej larg nëpër xhamat e një lokali pashë shumë piktura dhe i thash z. Qamilit; duket se e gjetëm atë që kërkojmë u afruam te dera dhe hymë brenda. Ishte një lokal i ngushtë dhe i gjatë. Në anën jugore,prej te dera fillonte banaku,kurse në anën veriore muri ishte i mbushur me piktura,dhe disa tavolina me nga tri karrige. Unë shkova deri në fund të lokalit,ku ndodhej piktura

e z. Omer Kaleshit,dhe ishte më e madhe se të tjerat. U ulëm në njërën nga tavolinat,bëmë porosinë dhe kur na i solli kamerieri z. Qamili e pyeti a e njihte z. Omerin. Ai qeshi dhe tha:

Me z. Omerin njihemi prej shumë vitesh,pasi jemi edhe kolegë. Për çdo ditë këtu e hanë nga një ushqim dhe takohemi me kolegët tonë piktor,por edhe me të tjerë. Edhe sot ishte dhe s'ka as gjysmë ore që shkoi. Z. Qamili i tha se jemi të një vendi,ai na tha nga Sërbica,unë i thash,jo unë jam nga një fshat aty afër ZHUBRINË. Ai qeshi dhe na tha:

-Nga Zhubrina z. Omerit i ka ngelur në kokë koha e luftës,kur janë fshehur te "BIRAT e DHELPRAVE",prandaj edhe i vizaton kokat. Z. Qamili e kërkoi numrin e telefonit,por e kishte harruar në shtëpi. E luti pronarin e restorantit,që po ta kishte numrin e telefonit të z. Omerit të na e jepte. Ai qeshi dhe filloi të rrotullojë numrat e telefonit. Z. Omeri sa kishte mbërri në banesën e vet. Ai bisedoi pak dhe ia dha telefonin z. Qamilit,sa u përshëndetën dhe z. Qamili tha :

-Të faleminderit do të presim këtu. Z.Qamili mu drejtua mua dhe më tha:

-Shumë i është bërë qejfi,që do të takohemi mu në këtë kafene,dhe do të vijë shumë shpejt. Vërtetë ashtu ndodhi,nuk shkuan dhjetë apo pesëmbëdhjete minuta z. Omeri arriti,i veshur si përherë krejt në të zeza u përshëndetëm,por ai iu falënderua pronarit për shërbimin e telefonit. Si u konsultuan,pronari i mori pijet tona dhe dolën në pjesën e fundit të kafenesë te një tavolinë dërrasë e trashë,por edhe karriget ishin prej të njëjtit materiali, ku përherë rrinë me miqtë z. Omeri. Unë nuk kuptova kur z. Omeri kishte porositur nga një birrë krikëll. I cakërruam gotat për shëndetin e piktorit,dhe ia shtruam bisedës dhe herë pas here unë fotografoja. Aty na tregoi z. Omeri se për aq kohë të gjatë sa është në Paris,për Parisin dhe Francën s'ka bërë asnjë pikturë,dhe me siguri që s'do të bënte,por për fat të mirë ai një

ditë duke ecur nëpër Bulevard kishte parë ca dru të prerë nga një sëmundje të pa njohur tash për tash dhe ashtu i kishte lindur ideja të pikturonte disa piktura që akoma si kishte mbaruar.

Ai na tha se po të dëshironim të shëtitnim nëpër Bulevardin"ARAGO"do të shikonim se si natyra apo Zoti ka rritur një Çinar dhe në te një femër cullake,dhe se atë e ka vërejtur prej kohësh z. Omeri. Sa i pimë pijet dolëm dhe u drejtuam në drejtim të çinarit,edhe pse rigonte një shi imët. Kur arritëm te çinari mua më shkuan sytë te flokët e bardha të z. Omerit,që shiu kishte bërë ca sumbulla. Aty u ndalëm afër dhjetë minuta duke analizuar çinarin që me të vërtetë në trupin e tij kishte rritur dhe e ruante me fanatizëm trupin cullak të asaj femre. Edhe aty përpara çinarit i bëmë disa fotografi. Shiu rigonte me të njëjtin intensitet,ne me z. Qamilin thamë që të uleshim aty afër në restorant,por z. Omeri tha se do të pimë kafe atje ku ai me shumë miq,shokë dhe kolegë të penës e brushës ka pirë kafe,por shumë herë edhe me të madhin PIKASO. E sa për shiun mos mërziteni se më kujton ditët e rinisë ne fshatin tim të dashur Sërbicën.

Sa u futëm në restorant njëri nga kamerierët na përshëndeti dhe na çoi në pjesën ku z. Omeri shumë herë është ulur dhe ka biseduar me Pikason. Në sallë e përshëndetën edhe shumë të tjerë ashtu siç e përshëndetnin edhe gjatë rrugës. Një i moshuar u çua prej një tavoline dhe erdhi të përshëndetet me z. Omerin,por kur i tregoi se ne jemi prej vendlindjes së tij ai u përshëndet edhe me ne. Z. Omeri i tregoi se unë jam nga fshati Zhubrinë ai duke qeshur tha:

-Nga birat e dhelprave! Z. Omeri i tha se jam edhe autor i shumë veprave.

Kur porositëm pijet e dyta,kamerieri na tha se z. Omeri kur nuk ka ndej aq gjatë në kafene,sa ditën e sotme!

Me siguri se nuk do të jeni parë shumë kohë,kurse ne vazhduam me bisedën,por dikur mua mu kujtuan fjalët e

kamerierit dhe thash që të ngriheshim,por z. Omeri prapë më tha se ai nuk kishte ndonjë angazhim që duhej të shkonte,dhe ia nisi një bisede në lidhje me krijimtarinë time,duke më thënë,se kam bërë shumë vepra,por edhe të mira. Sa e mbaroi bisedën me mua,ia nisi një bisede me z. Qamilin për fshatin e lindjes,në lidhje me një hakmarrje,që kishte ndodhur më tepër se dyzet vjet. Shumë herë edhe emocionohej.

Kur dolëm prej kafenesë Bulevardi Arago shndriste prej dritave të shumta të neonit. Duke shtrënguar duart dhe thamë natën e mirë gjer ditën e nesërme,ne u nisëm në drejtim të Metros,kurse z. Omeri të njëjtës rruge nga erdhëm,që me siguri do të ndalej pak te çinari,që të shikonte se si shkonin currilat e shiut nëpër trupin cullak të asaj femre, që prej lindjes së vet e mbante në vetvete. Gjatë rrugës z. Qamili më tha:

-Si sot kur se ka parë kaq të shqetësuar dhe të emocionuar z. Kaleshin.

Begzat Rahmani, piktori Omer Kaleshi dhe Qamil Selimi Kafeneja "Një pije prej në këmbë", në rrugën " Muftar", ku piktori Omer Kaleshi takohet me meqtë e shumtë: të penës, brushës dhe profesioneve të ndryshëm.

15. 06. 2005
Paris

Para ditën e kaluam duke ecur nëpër rrugët e Parisit. Nëpër ato vende,kur dikur por edhe sot shqiptarët presin për të gjetur punë,por tash janë më të shumtë,pasi shqiptarëve të ish Jugosllavisë iu janë bashkangjitur edhe ata të Shqipërisë. Tek tuk gjen edhe të reja shqiptare,që presin ditë më të mira për jetën e tyre të shthurur.

Aty nga ora pesëmbëdhjetë u nisëm në drejtim të banesës,së z. Omer Kaleshit,për ti parë pikturat e fundit,që ende janë të pa mbaruara. Kohën e kemi të kufizuar,z. Kaleshi në ora nëntëmbëdhjetë ka një takim me Ministrin e Kulturës të Francës dhe disa Ambasador të vendeve të botës,në lidhje me hapjen e një ekspozite. Fiks në ora gjashtëmbëdhjetë ishim përpara derës së hyrjes të ndërtesës,për fat edhe ashensori ishte në katin e parë dhe menjëherë u ngjitëm në katin ku banon z. Kaleshi.

Sa i ramë ziles dera u hap dhe me një buzëqeshje të ëmbël na priti piktori. U ulëm po në atë vend ku ishim ulur disa ditë më parë,krejt në ambient shqiptar,por të rrethit të Kërçovës. Mua më shkuan sytë te anxhiku dhe një furkë e vjetër me shtëllungë leshi së bashku me një bosht,që ishte i mbështjellë me penj,por për vjetërsinë e tyre unë s'mundem të them asnjë fjalë,ndoshta ishin më të vjetër se mosha ime?! Unë sa soditja reliktet në murin përballë z. Omeri i kishte sjellë dy gota dhe disa shishe alkooli,dhe më tha:

-Prej kujt do të kënaqemi sot?!për z. Qamilin e vendova ujin për çaj Bukojçi. Unë duke i marrë erë një balloni me raki shtëpie i thash :

-Prej këtij më duket se është më i mbushur,z. Omeri duke qeshur i mbushi,por pak si tepër. Si cakërruam

gotat,bëmë disa fotografi. Z. Omeri u çua dhe e vendoi një pikturë mbi mbështetëse prej atyre të fundit dhe deri në atë moment ata si kishte parë tjetër person, pritnin të lyhen me lak dhe të finalizohen për jetë të amshuar. Na i tregoi të njëzetekatërtat piktura,koka që dilnin prej drunjëve të prerë nga sëmundja e pa zbuluar gjer në atë moment dhe secila në mënyrë të vet më interesante prej te e para deri te ajo e fundit.

Z. Omeri na i tregon pikturat e pa mbaruara

Me këta piktura z. Kaleshi ka fundi i vitit do të hapte një ekspozitë në lagjen ku jeton prej vitesh nën patronazhin dhe mbikëqyrjen e kryetarit të po asaj komune. Për çdo pikturë,z. Kaleshi bënte sqarim,por kërkonte edhe mendimin

dhe kritikën tonë,që z. Qamili shpesh ia qëllonte dhe mendimi përputhej me atë të z. Kaleshi. Ky sqarim zgjati afër një orë e njëzet minuta dhe si e pimë edhe nga një gotë aty nga ora tetëmbëdhjetë u përshëndetëm me z. Omerin ashtu siç përshëndetet shqiptari me shqiptarin,që të takoheshim në VENDLINDJEN TONË TË DASHUR,KËRÇOVËN DHE SËRBICËN E PIKTORIT,por nëse na mban koha të vizitonim edhe birat e dhelprave,edhe unë ka disa vjet që si kam vizituar,që me të vërtetë janë një mrekulli e rrallë.

Unë dhe z. Qamili menjëherë morëm Metronë,pasi kishim caktuar për në ora njëzet darkën te kushëriri im z. Rexhep Limani. Kur arritëm në shtëpi z. Agimi me Teutën dhe zonja e z. Qamilit ishin gati dhe pa humbur kohë u nisëm. Udhëtimi na zgjati afër tridhjetë minuta. Z. Rexhepin nuk e gjetëm në shtëpi,por ai i kishte treguar të shoqes,që ne të shkonim te atelie e z. Rasim Jagodinit,ku ndodhej edhe z. Rexhepi.

Aty u takuam edhe me disa kërçovarë të tjerë,por edhe disa shqiptarë të Shqipërisë. Aty i zbrazëm nga një gotë uiski dhe tërë kohën na shoqëronte Xhaksi,qeni i z. Rasimit,mjaftë i madh i pastër dhe qime zi korb.

Darka te z. Rexhepi ishte e bollshme,por më shumë përshtypje na la ai specialiteti Arabo-Tunizian me emrin”KUS-KUS”,të cilin e kishte përgatitur zonja e shtëpisë,por edhe vajza e tij një studente e shkëlqyer. Si darka po ashtu edhe koha tjetër na kaloi shumë shpejt në atë atmosferë festive. Aty nga ora njëzetetre e diçka z. Qamili kërkoi leje që të niseshim,por unë duke qeshur thash:

-Unë tash nuk përshëndetem,biletat i vazhduam edhe për një javë ne do të rrimë këtë kohë në shtëpinë e z. Rexhepit,si mysafirë të pa ftuar,në realitet të ftuar vetëm për një darkë,dhe këputa disa qershi që piqeshin më vonë se ajo e z. Qamilit. Gruaja e ime iu drejtua gruas së z. Rexhepit,që ia përkthente fjalët në gjuhën frënge zonja e z. Qamilit:

-Ky burri im ia pa hairin kësaj dynjaje përveç gazetës dhe shkrimeve kurrë s'ka bërë punë tjetër. Teuta kur ishte e vogël,kush e pyeste çka bënë babi,ajo përgjigjej:

-Babi,han,pinë,lexon gazetë,mbush fjalë kryq dhe na bënë zhurmë me makinën e shkrimit. Më në fund u përshëndetëm për tu takuar në Kërçovë,zonja e z. Rexhepit tha:

-Sa të mbarojnë vajzat me shkollën do të vijmë ...

16. 06. 2005
Paris

Kjo ditë është e parafundit të qëndrimit një mujor në Parisin e bukur me kulturë dhe civilizim shekuj me radhë. Qysh në mbrëmje me z. Qamilin biseduam që këtë ditë ta kalojmë në atë pjesë të Parisit ku shqiptarët dhe të tjerë hallexhinj të botës sigurojnë kafshatën e bukës. Ç' është e drejta në këtë pjesë ne kemi qenë dhe kaluar disa herë,por sot do të rrimë pak më gjatë,dhe ndoshta takoj ndonjë shok fëmijërie. Në këtë pjesë të Parisit punë gjejnë edhe ata që merren me zanatin më të vjetër,për sigurimin e kafshatës së bukës.

Ecëm afër tri orë të tëra,ç' është e drejta z. Qamili disa herë më luti dhe më thoshte të uleshim,por mua disi sot nuk më merrte etja dhe uria. Duke ecur z. Qamili më tha:

-Këtu afër ka një xhami a do të pengojë sikur unë të fal dy rekatë namaz. Unë iu përgjigja se mua aspak s' më pengon,bile do të hy edhe unë,që të shikoj dhe të pasurohem edhe me pak dijeni të kulturës fetare Islame,pasi qenka një xhami ku falen;indian,kinez, maroken,tunizian dhe...

Xhamia ishte përplot me njerëz të ngjyrave të ndryshme. Bënin lutjet ashtu siç dinin dhe shkonin,vendin ua

lironin të tjerëve. Hyrje daljet s'u ndalën sa ndeja në xhami,afër tridhjetë minuta,edhe meqenëse s'ishte asnjë kohë për falje.

Drekën vendosëm ta hanim në një restorant indian. Ishte mjaft i pastër,luksoz dhe ushqimi me mjaftë shije. Kafen e pas bukës vendosëm ta pinim në një vend tjetër,që mua sot më ishte shtuar oreksi për të parë dhe vizitua sa më tepër lokale të popujve të ndryshëm që jetonin në shtetin Francez. Ecëm afër njëzet minuta dhe z. Qamili më tha që të hynim në lokalin që kishim përballë,sepse atë e vizitojnë shumë njerëz të vendit tonë,por edhe shqiptarë të viseve të tjera.

Ne duke pirë kafenë z. Qamili nëpërmes të dritares e pa një shqiptar të Kosovës,por edhe ai na kishte parë,hyri në lokal dhe erdhi u ul në tavolinën tonë. Ishin njohur vite me radhë,bile kishin shkuar edhe familjarisht te njëri tjetri,prandaj edhe pyetën njëri tjetrin për njerëzit,që kishin në Francë,por edhe në vendlindje. Pasi u shterën pyetjet dhe përgjigjet ai pyeti për mua dhe z. Qamili i tregoi se unë jam i vjehërri i z. Agimit. Atëherë ai u çua në këmbë dhe ma shtriri dorën,duke më thënë:

-Kam lexuar nga ju disa libra,që mi ka dhënë z. Qamili. Unë iu falënderova,kurse ai më tha se quhej;Hasan Osmani,kurse z. Qamili tha:

-Veteran i U. Ç. K-ës. Z. Osmani u ul dhe prej çante nxori një libër mjaft voluminoz,kopertina të trasha të ndritshme me HARTËN E KOSOVËS dhe me titull:KOSOVA DHE USHTRIA ÇLIRIMTARE të autorit, GJENERAL KUDUSI LAMA.

Biseda do vazhdonte me z. Hasanin,por në atë moment për dritares së restorantit na kishte parë një bashkëvendës i z. Qamilit,por edhe unë e njihja,pasi dikur kishim mësuar në një shkollë të fillores. Ai hyri në restorant dhe u drejtua në drejtim tonin. Mu afrua mua dhe më dëshiroi mirëseardhje në Parisin e tyre. Më pyeti edhe për shëndetin,por unë nuk iu

përgjigja,se në atë moment erdhi kamerieri dhe e pyeti ç'do të pinte. Ai na shikoi të tërëve dhe në fytyrë mori një pamje të kuqe. Si nëpër dhëmbë tha një kafe,dhe si u largua kamerieri na pyeti neve ç'do të pinim,por z. Qamili i tha se ne kemi pirë tërë ditën,dhe që ta freskonte pak prej temperaturës së fytyrës e pyeti kur do ta merrte pushimin. Ai iu përgjigj se ndodhej në pushim,prej disa ditësh,por...Z. Qamili i tha ndoshta do të shkosh në Kërçovë,ai me një ton të ulët i tha:

-Jo,nuk do të vete kurrkund dhe...Unë pash se diçka nuk ishte në rregull me te dhe e pyeta:

-Rastësisht mos dini ku punon një kushëri i imi,ai pa mos e përmendur unë emrin më tha, se e dinte,por nuk dinë se a është në punë se s'është mirë me shëndet,por e dijë tha banesën e tij. Kurse atelia e vëllait të tij ndodhet aty afër,dhe se deri përpara disa ditësh ka punuar te ai,por...Unë e shikova z. Qamilin dhe thash:

-Po të doni të shkojmë që të takohem,nesër do të ik për në Kërçovë. Z. Hasani e thirri kamerierin që të paguante,por z. Qamili i tha që paratë ti fuste në xhep. Kurse ai shoku,uli kokën, të shikonte këpucët e vjetra,jo siç e mban lart kur takohemi rrugëve të vendlindjes i veshur shik.

Ecëm disa minuta dhe hymë nëpër një tunel të një ndërtese disa kate,që vinte një erë lagështie,sikur nuk ndodhesh në metropolin botëror,vatër e kulturës dhe civilizimit. U ngjitëm nja katër pesë shkallë,i ramë ziles,por dera nuk u hap. Shoku tha se ndoshta kushëriri e ka mbyllur punëtorinë,ose janë punëtorët,por nuk e hapin derën se ka disa që punojnë në të zezë. Rrugën e vazhduan nëpër ata ndërtese të vjetra që kundërmonte erë vdekjeje,dhe prapë u futëm në një tunel dhe dolëm ku shtrihej një barakë druri e vjetër.

Ndoshta më tepër se vitet e mija dhe të shokut të shkollës,por ndoshta sa edhe vet Parisi. Trokitëm në njërën derë,unë isha i bindur se nuk mundet të jetë aty brenda kushëriri im,por për fat të keq dera nuk kishte atë vrimën

spiune,u hap dhe doli një plak,që na përshëndeti në gjuhën serbe apo boshnjake unë nuk kuptova...?! I tha shokut tim të shkollës,që të hynim brenda. Mua mu rrotulluan mëndët nga era e mykur vdekjeprurëse,por më tepër, kur pash se kushëriri im ishte i shtrirë në një krevat,prej kohës së Napoleonit. Me dritë të ndezur dhe një dritare e mbuluar me kartonë. Kushëriri u prek,unë u ula te krevati dhe e pyeta për shëndetin,kurse të tjerët rrinin në këmbë. Ai boshnjaku tha të na bënte nga një kafe,por z. Qamili i tha jo se shpejtojmë,kemi të caktua një termin. Por edhe ai shoku i shkollës,që në vendlindje e shikojmë të veshur shik tha se shpejtonte të shkonte te"SINDIKI",për të bërë do fotokopje pa pagesë,kurse mua mu kujtua viti 1974 kur kam vizituar ca shokë të fëmijërisë që punonin në Vjenë të Austrisë dhe ishin duke banuar në grup në një barakë druri në kushte të mesjetës,apo diku në Afrikë,apo sot në Parisin e kulturës botërore ku gjaku im mpikset nga hallet dhe mos besimi i syve,në atë pjesë të Parisit ku mbillej vdekja për njerëzit e gjakut tim. Dolëm duke i uruar shëndet...?!

17. 06. 2005
Paris

Edhe pse ndenjëm shumë vonë,në ora shtatë e tridhjetë minuta ishim të zgjuar. Gruaja u çua e hapi dritaren dhe filloi të pakonte teshat e fjetjes. Unë u ktheva në anën tjetër,por ajo më tha,që edhe unë të çohesha,koha kalonte. Në atë moment Teuta trokiti në derë,duke na përshëndetur na tha:

-Kafja është gati,po ashtu në atë çast edhe Aurela e vogël dha zë unë u ngrita dhe hyra në dhomën e saj duke menduar se si do të ndihemi ditët e para pa të. Ndoshta edhe ajo,që u zgjua aq herët vetëm këtë ditë për një muaj që jemi në Francë është e brengosur për largimin tonë. Kur unë hyra në dhomën e saj,ajo ishte çuar në këmbë dhe mbahej për parmakëve të krevatit. Sa më pa filloi të qeshi dhe dha disa zëra prej fëmije. E mora hopçe si themi ne në Kërçovë dhe hymë në dhomën e gjyshes. Aty ndejtëm pak dhe e mora prapë,që të zbritnim në kuzhinë,ku na priste z. Qamili,baba plak i Aurelës. Duke zbritur shkallëve Aurela kapi një degë të qershisë dhe e çoi kokën lart ku në majë të saj kishte akoma qershia të kuqe all. Në atë moment edhe ai zogu i zi që tërë natën këndonte këngën e vet dhe kënaqej me ëmbëlsitë e frutave të pjekur për së tepërmi,fluturoi siç për pak kohë do të fluturojmë edhe ne me aeroplan. Zogu Aurelës ia tërhoqi vëmendjen dhe e lëshoi degën e qershisë,por në dorë i ngeli një gjeth,që ajo e shikonte me habi,ndoshta pse në doriçkën e saj s’kishte qershia.

Kur hymë brenda në kuzhinë Aurela u lëshua në drejtim të z.Qamilit,unë i përshëndeta atë,zonjën e tij dhe z. Agimin,dhe ia dhashë Aurelën,kurse ajo menjëherë filloi ta tërhiqte për veshi dhe hunde duke i thënë diçka në gjuhën e vet prej fëmije.

Si pimë kafen Teuta dhe zonja e z. Qamilit filluan të shtronin ushqimin e mëngjesit. Si hëngrëm unë dhe z. Qamili dolën në kopsht, ku dielli kishte filluar ti ngrohi; domatet,kungujt dhe misrin që përparonin shumë mirë. Z. Qamili u afrua te dredhëzat dhe i këputi ata të fundit dhe nisi të mi japi, por unë mora vetëm tri duke i thënë:

-Tri hani ju e të tjerat do të ia çojmë Aurelës. Z. Qamili qeshi...dhe u nisëm në drejtim të kuzhinës. Z. Agimi u nis në drejtim të portës që ta hapte,pasi aty ishte z. Bashkimi me të shoqen dhe fëmijët. Unë më nuk u ula,por me z. Qamilin dolëm dhe pritja që të dilte edhe gruaja,kurse z. Agimi dhe z. Bashkimi i nxirrnin valixhet dhe i vendonin në golfin e z. Agimit. Unë i thash z. Bashkimit:

-Sa erdhët dhe u kapët për pune,ai qeshi duke më thënë:

-Për ne nuk është shumë interesant,ne tri katër herë në vit bëjmë këtë punë. Fiks në ora nëntë,u përshëndeta me familjen e z. Bashkimit,pastaj edhe me z. Qamilin dhe zonjën e tij dhe u futa në veturë,që më punonte dhe priste të nisej në drejtim të Aeroportit Charl de Gol.

Teuta më tha:

-Babi shpejt shkoi një muaj dhe nëpër faqet e saj rrokulliseshin ca pika loti. Aurela shikonte herë përjashta me siguri drunjtë dhe veturat e shumta herë neve në veturë. Teuta vazhdonte me porositë e përshëndetjeve,për Gëzimen dhe Yllëzën e vogël edhe meqenëse ajo më është rritur dhe është studente.

Gjatë rrugës më kujtoheshin fjalët e z. Qamilit kur te xhami i veturës më tha:

-Z. Beg shpejt do të takohemi në Kërçovë,rrugë të mbarë dhe mi përshëndet shokët,por më së shumti Kërçovën,që më mungon shumë.

Fiks në ora dhjetë ishim përpara sportelit të doganës dhe i bëmë të tëra kontrollet. U përshëndeta me z. Agimin pastaj edhe me Teutën,që lotët akoma i rrokulliseshin,por tash më lehtë se i kishin trasuar rrugët gruaja përkëdhelte Aurelën dhe fshinte lotët,kurse ajo flinte në gjumin më të ëmbël në afërsi të gjyshes dhe gjyshit,unë e putha dhe u rendita në rendin e gjatë së bashku me gruan duke mallkuar fatin tonë të kurbetit. Ne akoma pa hyrë në derën e zonës së aeroportit,u afrua z. Agimi dhe më tha:

-Erdhi edhe z. Enver Tafallari do të keni shoqëri rrugës.

AEROPORTI CHARL DE GOL

ZËRI NGA QIELLI

O njeri i humbur
Në çdo skaj të botës
Por edhe në mes të Parisit
Në se shikon një barakë
Nga dërrasa druri
Ose llamarinë të ndryshkur
Por edhe shtëpi plotë plehra
Kthe se aty do të gjesh
Njerëz të gjakut t'im...???!!!

Në ora njëmbëdhjetë u mbyllën dyert e aeroplanit “ADRIA”. U nis por me një shpejtësi të vogël dhe udhëtuam afër pesë minuta dhe u ndal. Aty ndejtëm afër njëzet minuta dhe dëgjoja komente të ndryshëm,por ne me gruan shikonim nëpër xhama aeroplanët që ngriheshin dhe aterronin prej drejtimeve të ndryshëm,që kurrë s’kishim parë në jetën tonë.

Në Lubjanë arritëm aty kah ara trembëdhjetë. Xha Enveri tërë rrugës më tregonte për udhëtimet e shumta,që ka bërë për afër dyzet vjet jetë prej kurbetçiu në Francën largët,që kurrë se kishte ëndërruar si fëmijë e ku se do të jetonte kohën më të bukur të jetës së vet,ku do ti lindnin me radhë disa vajza e më në fund edhe djali hasretit,që për francezët ka qenë shumë interesante jeta e tij dhe dëshira për të pasur një djalë.

Unë po ashtu kënaqesha me bukuritë e Alpeve të larta ku në shumë vende bora ishte e pa shkrirë,por edhe me mjegullat e shumta që bënin reliefë të çuditshëm ashtu si edhe vetë jeta ime...???!!!

P.S. Përzemërsisht i falenderohem vrimës së murit të ahurit dhe VITORES që gati katër dekada u kujdesën dhe i ruajtën me fanatizëm,shumë fletë dhe fletore të shkruajtuara të këtij DITARI dhe shumë shkrime të tjera...

Autori

Fund

Libri botohet me ndihmën e Ministrisë për kulturë të R . M

Tirazhi: 500 copë